



Glosar për Integrimin European, Institucionet dhe Politikat e Bashkimit European



Ministria e Integritit European

Botim i:	Ministrisë së Integritit Europian
Përgatitur për botim nga:	Spektori i Përkthimit, Drejtoria e Përafrimit të Legjislacionit
Përpunimi grafik:	MOB_Design & Printing support
Shtypi:	Pegi



Deutsche Gesellschaft für
Technische Zusammenarbeit (GTZ) GmbH

Ky botim u mundësua me mbështetjen financiare të Ministrisë Federale Gjermane për Bashkëpunimin Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) në kuadër të Projektit të GTZ-së "Mbështetje për Integrimin Europian".

Për GLOSARIN

Glosari i mëposhtëm përmban 250 terma në lidhje me integrimin evropian, institucionet dhe veprimtaritë e Bashkimit Evropian. Ky glosar përditësohet rregullisht dhe përmban ndryshimet më të fundit.

Përkuftizimet shpjegojnë se si kanë evoluar terma të veçantë dhe, kur është e nevojshme iu referohen Traktateve. Informacioni historik, përgjigjet e pyetjeve si punojnë institucionet, çfarë procedurash ndiqen, cilat fusha mbulohen nga politika e Komunitetit - si dhe shumë të tjera mund të gjenden në këtë glosar.

Vertical line on the left side of the page.

Vertical line on the right side of the page.

Përmbajtja

A.....13

Abstenim konstruktiv (abstenim pozitiv)
Acquis communautaire
Aderimi i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin European
Adoptimi i *acquis communautaire*
Agjencitë e Bashkimit European
Arkitektura e Europës
Arsimi, Formimi profesional dhe Rinia
Avokati i popullit (Ombudsman)
Afhenda 2000
Afhenda politike e Bashkimit European

B.....19

Banka Europiane e Investimeve
Banka Qendrore Europiane
Bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështjet penale
Bashkëpunim më i ngushtë
Bashkëpunim Politik European
Bashkim Doganor
Bashkimi Ekonomik dhe Monetar
Bashkimi European Perëndimor
Bërthama (Kocka e fortë)
Burime vetjake
Buxheti

C.....26

Coreper (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm)
COREU (Korrespondenca Europiane)

D.....27

Debat mbi të ardhmen e Bashkimit European
Deficit demokratik
Deklarata (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Deklarata e Laeken-it
Detyrat e Petersbergut
Dialogu social

Dispozita fiskale
Drejtësia dhe punët e brendshme

E.....31

E drejta e iniciativës
E drejta komunitare
e-Europe
Ekuilibër institucional
Energjia
Eurocorps (Trupat europiane)
EUROFOR/EUROMARFOR
Europa "à la carte"
Europë me "gjeometri të ndryshueshme"
Europa me "ritëm të shpejtë"
Europol (Zyra Europiane e Policisë)

F.....36

Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit

G.....38

Globalizim i ekonomisë

GJ.....39

Gjykata Europiane e Llogarive
Gjykata e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane
Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian

H.....41

Hierarkia e akteve komunitare (hierarkia e normave)

I.....42

Identiteti Europian i mbrojtjes dhe sigurisë
Instrumentet ligjore komunitare

K.....43

Karta e të Drejtave Themelore
Karta sociale

Kërkim dhe zhvillim
Këshilli European
Këshilli i Bashkimit European
Klasifikim i shpenzimeve
Klauzola e mospjesëmarrjes (Opting out)
Klauzola e pezullimit
Kodifikimi i legjislacionit (formal/zyrtar)
Kohezioni ekonomik dhe social
Komisioni European
Komisione parlamentare
Komitetet dhe grupet e punës
Komiteti European Ekonomik dhe Social
Komiteti i Pajtimit
Komiteti i Punësimit
Komiteti i Rajoneve (KR)
Komiteti Politik dhe i Sigurisë
Komitologji
Kompetenca dytësore
Kompetencat e Komunitetit
Kompromisi i Janinës
Kompromisi i Luksemburgut
Komunitarizëm
Konferenca Ndërqeveritare dypalëshe (Bashkim European-Vend aplikant)
Konferenca European
Konferenca Ndërqeveritare (KNQ)
Konfirmimi i Komisionit European
Konkurrenca
Konkurrueshmëria
Konsolidim i legjislacionit –informal/deklarues
Kontroll paraprak
Konventa (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)
Konventa European
Konventa European e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)
Kriteret e konvergencës
Kritere të pranimit (Kriteret e Kopenhagenit)
Kudër i vetëm institucional
Kufizim i kompetencave
Kultura

L.....63

Lëvizja e lirë e personave (politika e vizave, azilit, emigracionit dhe të tjera)

Libri i Bardhë

Libri i Gjelbër

Lufta kundër drogës

Lufta kundër krimit të organizuar

Lufta kundër mashtrimit

Lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë

Lufta kundër terrorizmit

M.....69

Marrëveshja e Europës

Marrëveshja e Politikës Sociale

Masa për të luftuar pastrimin e parave

Mbrojtja e konsumatorit

Mbrojtja kolektive

Metoda komunitare dhe ndërqeveritare

Mirëqenia e kafshëve

Mjedisi

Monitorimi i zbatimit të së drejtës komunitare

Mundësi të barabarta

N.....74

NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)

NATO "e rinovuar"

Ndihma para-aderimi

Ndihma humanitare

Ndihma Shtetërore

Ndihma për zhvillim

Negociatat për aderim

Neni 36 i Traktatit të Bashkimit European

NJ.....78

Njësia e Planifikimit dhe Paralajmërimeve

O.....79

Objektivat 1, 2 dhe 3

Organizata të përbashkëta të tregjeve bujqësore

Organizma gjenetikisht të modifikuara (OMGJ)

P.....81

Pakti i para aderimit mbi krimin e organizuar

Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike

Parimi i mosdiskriminimit

Parimi parandalues

Parlamentet kombëtare

Parlamenti European

Partnerë socialë

Partneritet për aderim

Personaliteti juridik i Bashkimit

Perspektiva financiare 2000-2006

Peshimi i votave në Këshill

Peticionet

Përbërja e Komisionit European

Përfaqësues i lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë

Përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit European

Përqendrimi

Politika ekonomike

Politika e Përbashkët Bujqësore

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë

Politika e Përbashkët e Transportit

Politika e Përbashkët Tregtare

Politika Europiane e Mbrojtjes dhe Sigurisë

Politika monetare

Politika për ndërmarrjet

Politika Sociale

Presidenca e Bashkimit European (rotacioni i Presidencës)

Presidenti i Komisionit European

Procedura e bashkëpunimit

Procedura e vendimmarrjes së përbashkët

Procedura e këshillimit

Procedura e pëlqimit

Procedura standarde zgjedhore, Statuti për deputetët e Parlamentit European dhe partitë politike europiane

Programi i ndihmës komunitare për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (Phare)

Pronësi intelektuale

Protokolli i Kiotos

Punësimi

Q.....102

Qartësia e Traktateve (thjeshtimi i Traktateve)

Qeverisja

Qëndrim i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)

Qëndrim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)

Qytetaria e Bashkimit European

R.....104

Rajonet më të largëta

Riformulimi i legjislacionit

Rishikimi i Traktateve

RR.....105

Rrathë bashkëqendrorë

Rrjetet Trans-Europiane

Rrjeti gjyqësor european për çështjet penale

S.....107

Siguria ushqimore

Strategji para-aderimi

Strategji e Përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)

Strategjia Europiane për Punësimin

Statuti i shërbimit publik

Subsidiaritet

SH.....111

Shengen (Marrëveshja dhe Konventa)

Shëndeti publik

Shërbimet audiovizive

Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm

Shërbime me interes të përgjithshëm

Shërbimi publik

Shërbimi universal

Shoqëria e informacionit

Shtyllat e Bashkimit European
Shumica e cilësuar
Shumica e cilësuar e përforcuar
Shumicë e dyfishtë

T..... 118

Telekomunikacioni
Televizioni pa kufij
Të drejtat e njeriut
Titulli V i Traktatit të Bashkimit European (PPJS)
Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European
Trajtimi i barabartë i burrave dhe grave
Traktati i Amsterdami
Traktati i Nisës
Transparenca (e drejta për përdorim të dokumentave)
Transparenca e seancave të Këshillit
Troika

TH..... 123

Thellimi
Thjeshtimi i legjislacionit

U..... 124

Unanimiteti
"Ura" komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)
Urdhër arresti european

V..... 125

Vendet aplikante
Vendimi dhe vendimi kuadër (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European)
Veprim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë)
Veprim i përbashkët (drejtësia dhe punët e brendshme)

Z..... 127

Zgjerimi
Zona Europiane e Kërkimeve
Zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë

Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF)

Zyra e Shkëmbimit të Informacionit për Ndhmën Teknike (TAIEX)

ZH.....130

Zhvillim i qëndrueshëm

Zhvillim rural

SHTOJCË.....132

Termet e glosarit sipas rendit alfabetik në anglisht

- A -

Abstenim konstruktiv (abstenim pozitiv). Një Shtet Anëtar lejohet të abstenojë një votë në Këshill sipas shtyllës së Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) pa penguar vendimin unanimit.

Kjo zgjidhje u prezantua në Traktatin e Amsterdimit në nenin e ri 23 të Traktatit të Bashkimit Europian. Nëse abstenimi shoqërohet me një deklaratë zyrtare, Shteti Anëtar në fjalë nuk është i detyruar të zbatojë vendimin, por duhet të pranojë që vendimi të jetë i detyrueshëm për Bashkimin Europian. Shteti Anëtar nuk ndërmerr asnjë veprim që mund të jetë në kundërshtim ose të pengojë Bashkimin Europian të veprojë sipas këtij vendimi.

Acquis communautaire. *Acquis communautaire* është tërësia e të drejtave dhe e detyrimeve të përbashkëta që i bashkon të gjitha Shtetet Anëtare në Bashkimin Europian. *Acquis communautaire* ndryshohet vazhdimisht. *Acquis* përfshin:

- përmbajtjen, parimet dhe qëllimet politike të Traktateve
- legjislacionin e miratuar në zbatim të traktateve dhe të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian
- deklaratat dhe rezolutat e miratuara nga Bashkimi Europian
- masat në lidhje me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë
- masat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme
- marrëveshjet ndërkombëtare të përfunduara nga Komuniteti dhe marrëveshjet e përfunduara nga Shtetet Anëtare ndërmjet njëra-tjetrës në fushën e veprimtarive të Bashkimit Europian.

Kështu, *acquis communautaire* përfshin të drejtën komunitare në kuptim të ngushtë, akte të miratuara sipas shtyllës së dytë dhe të tretë të Bashkimit Europian si dhe objektivat e përbashkëta të parashikuara në Traktate. Bashkimi Europian është angazhuar të ruajë *acquis communautaire* në tërësinë e tij dhe ta zhvillojë më tej.

Vendet aplikante duhet ta pranojnë *acquis communautaire* përpara se të bashkohen me Bashkimin Europian. Shmangje nga *acquis* janë bërë vetëm në rrethana të veçanta dhe janë të kufizuara në qëllim.

Në përgatitje për zgjerimin e ardhshëm, vendet aplikante tani duhet të transpozojnë *acquis* në legjislacionin e tyre kombëtar dhe ta zbatojnë sapo të aderojnë në Bashkimin Europian.

Aderimi i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian. Neni 49 (ish neni O) i Traktatit të Bashkimit Europian parashikon aderimin e Shteteve të reja Anëtare në

Bashkimin European. Këshilli duhet të jetë dakord me unanimitet për hapjen e negociatave, pasi të jetë këshilluar me Komisionin dhe pasi të ketë marrë pëlqimin e Parlamentit European. Kushtet e pranimit, periudhat kalimtare dhe rregullimet në Traktatin mbi të cilën është themeluar Bashkimi European duhet të jenë pjesë e marrëveshjes ndërmjet Shtetit Anëtar dhe vendit aplikant. Marrëveshja përpara se të hyjë në fuqi duhet të ratifikohet nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat përkatëse kushtetuese.

Adoptimi i *acquis communautaire*. Këshilli European i Esenit (dhjetor 1994) i kërkoi Komisionit paraqitjen e një Libri të Bardhë për përgatitjen e vendeve të asociuara të Europës Lindore dhe Qendrore për integrim në tregun e brendshëm të Bashkimit European. Libri i Bardhë, që u prezantua në Këshillin European të Kanës në qershor 1995, përmban një program indikativ për përafrimin e legjislacionit të vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore me atë të tregut të brendshëm. Ky program parashikonte që këto vende të caktonin përparësi përfshirjen e rregullave të Komunitetit. Në këtë punë ato do të ndihmoheshin nga zyra e ndihmës teknike (TALEX) sidomos për të marrë informacion mbi legjislacionin komunitar.

Adoptimi dhe zbatimi i legjislacionit komunitar janë sfidat kryesore me të cilat përballen vendet aplikante. Ato kërkojnë që administratat dhe sistemet ligjore të forcohen dhe infrastruktura e tyre të përshtatet në përputhje me standardet komunitare veçanërisht për çështjen e mjedisit, transportit, energjisë dhe telekomunikacionit. Për të lehtësuar këto rregullime të konsiderueshme, vendeve aplikante u jepet ndihmë para-aderimi.

Negociatat e vendeve aplikante për aderim filluan në mars 1998. Hapi i parë ishte vlerësimi i pajtueshmërisë së legjislacionit të vendit aplikant me rregullat e Komunitetit (Kontrolli paraprak). Pastaj ky vlerësim ishte baza për fazën e dytë: negociatat dypalëshe ndërmjet Bashkimit European dhe secilit vend aplikant.

Në disa fusha, vendeve aplikante u është caktuar një periudhë kalimtare ndërmjet para aderimit të tyre dhe kohës kur janë plotësisht të afta për të zbatuar *acquis communautaire*. Megjithatë, çdo periudhë kalimtare kufizohet në qëllim dhe kohë sipas kushteve të repta.

Agjencitë e Bashkimit European. Agjencitë e Bashkimit European janë autoritete publike të krijuara sipas së drejtës europiane dhe gëzojnë personalitet juridik. Agjencitë e Bashkimit European janë krijuar nga një akt i legjislacionit dytësor të Komunitetit për të kryer detyra specifike teknike, shkencore ose administrative.

Agjencitë e para u krijuan në vitin 1970, por shumica e tyre filloi të funksionojë në vitin 1994 ose 1995, në vijim të vendimit të Këshillit European të Brukselit (tetor 1993) për vendosjen e selive të 7 agjencive. Agjencitë më të fundit janë: Autoriteti European për Sigurinë Ushqimore (Janar 2002), Agjencia Europiane për Sigurinë Detare (gusht 2002) dhe një Agjenci Europiane për Sigurinë Ajrore (shtator 2002).

Deri tani, i plotësojnë kushtet për përcaktimin e agjencisë së Komunitetit 15 institucione, edhe pse një larmi termash përdoren për t'i përshkruar (qendër, fondacion, agjenci, zyrë etj).

Si organizata autonome, agjencitë janë një grup heterogjen i bashkuar sipas një modeli të vetëm organizator. Në varësi të mandatit dhe të partnerëve ose klientëve, agjencitë mund të ndahen në 4 nëngrupe në bazë të veprimtarisë së tyre:

1- Agjenci që ndihmojnë në funksionimin e tregut të brendshëm

- a- Zyra për Harmonizim në Tregun e Brendshëm (OHIM) me seli në Alikante
- b- Zyra e Komunitetit për Larminë Bimore (CPVO) me seli në Angers
- c- Agjencia Europiane për Vlerësimin e Prodhimeve Mjekësore (EMA) me seli në Londër
- d- Autoriteti Europian për Sigurinë Ushqimore (EFSA) me seli të përkohshme në Bruksel
- e- Agjencia Europiane për Sigurinë Detare (EMSA), (vendndodhja e papërcaktuar)
- f- Agjencia Europiane për Sigurinë Ajrore (EASA) (vendndodhja e papërcaktuar)

2- Qendra monitorimi

- a- Agjencia Europiane e Mjedisit (EEA) me seli në Kopenhagen
- b- Qendra Europiane e Monitorimit për Drogat dhe Toksimaninë (EMCDDA) me seli në Lizbonë
- c- Qendra Europiane e Monitorimit për Racizmin dhe Ksenofobinë (EUMC) me seli në Vienë

3- Agjenci që nxisin dialog social në nivel evropian

- a- Qendra Europiane për Zhvillimin e Formimit Profesional (CEDEFOP) me seli në Selanik
- b- Fondacioni Europian për Përmirësimin e Kushteve të Jetesës dhe të Punës (Dublin)
- c- Agjencia Europiane për Sigurinë në punë dhe Shëndetin (Bilbao)

4- Agjenci që kryejnë programe dhe detyra në emër të Bashkimit Europian në fushat e tyre përkatëse të ekspertizës

- a- Fondacioni Europian i Trainimit (ETF) me seli në Torino
- b- Qendra e Përkthimit për Organet në Bashkimin Europian (CdT) me seli në Luksemburg
- c- Agjencia Europiane e Rindërtimit (ERA) me seli në Selanik

Arkitektura e Europës. Ky term ka të bëjë me organizatat, institucionet, marrëveshjet dhe marrëdhëniet e ndryshme tradicionale që krijojnë hapësirën europiane brenda të cilës anëtarët punojnë së bashku për probleme me interes të përbashkët.

Një pjesë thelbësore e kësaj arkitekture u vendos në Traktatin e Bashkimit European që formoi tri shtyllat: Komunitetin European (shtylla e parë), Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (shtylla e dytë) dhe bashkëpunimin në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (shtylla e tretë). Çështjet që i takojnë shtyllës së dytë dhe të tretë trajtohen nga institucionet e Komunitetit (Këshilli European, Këshilli, Komisioni, Parlamenti European etj.), por ende zbatohen procedurat ndërqeveritare.

Arsimi, Formimi profesional dhe Rinia. Parimi i subsidiaritetit do të thotë që çdo Shtet Anëtar të marrë përsipër përgjegjësi për organizimin e sistemit të arsimit dhe formimit profesional, si dhe për përmbajtjen e mësimi. Në përputhje me nenin 149 dhe 150 të Traktatit të Komunitetit European, roli i Komunitetit është të kontribuojë në zhvillimin e arsimit cilësor duke inkurajuar bashkëpunim ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, duke përkrahur dhe plotësuar veprimin e tyre sidomos me synim zhvillimin e dimensionit european në arsim, inkurajimin e lëvizjes dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet shkollave dhe universiteteve.

Në përputhje me këto nene, Bashkimi European nuk ka si synim të zhvillojë një politikë të përbashkët për arsimin, megjithatë ai ka në dispozicion një sërë mjetesh specifike për të inkurajuar bashkëpunimin në këtë fushë:

- programe veprimi të Komunitetit të miratuara me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët (Këshill dhe Parlament European), përkatësisht:
- SOCRATES, nxit lëvizjen e studentëve dhe për këtë qëllim bashkëpunimin ndërmjet universiteteve (programi Erasmus) shkollave (programi Comenius) dhe kurseve të gjuhës (Programi Lingua), si edhe zhvillimin e rrjeteve me synim njohjen e kualifikimeve (rrjeti Naric), sigurimin e informacionit në fushën e arsimit (Eurydice) dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet vendimmarrësve në fushën e arsimit (Arion)
- LEONARDO DA VINCI, nxit formimin profesional duke përmirësuar sistemet kombëtare të formimit profesional dhe duke inkurajuar të mësuarit gjatë gjithë jetës
- YOUTH (RINIA), lehtëson lëvizjen e të rinjve më pak të privilegjuar jashtë strukturave arsimore dhe u jep mundësinë me anë të Shërbimit Vullnetar European të marrin pjesë në projekte të drejtuara nga shoqëritë apo autoritetet vendase në Europë ose në vendet në zhvillim
- akte ligjore komunitare si: rekomandime, komunikata që inkurajojnë bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare (psh. për të mësuarit gjatë gjithë jetës ose vlerësimi i cilësisë së arsimit në shkolla dhe universitete), dokumente të punës, projekte pilot, etj;

- dy organe që mbështesin veprimtarinë e Bashkimit Europian në fushën e formimit profesional: Qendra Europiane për Zhvillimin e Trajnimit Profesional (CEDEFOP), e cila zhvillon veprimtari akademike dhe teknike në mbështetje të zhvillimit të formimit profesional në Europë, dhe Fondacioni Europian i Trajnimit (ETF) që përkrah dhe bashkërendon reformën e sistemeve të formimit profesional si pjesë e programeve PHARE, TACIS, dhe MEDA.

Për të arritur qëllimin e përcaktuar në Këshillin Europian të Lizbonës në mars 2000 (për një ekonomi më konkurruese në botë dhe të bazuar në njohuri), Komisioni ka rritur bashkëpunimin në fushën e të mësuarit gjatë gjithë jetës me qëllim përmirësimin e cilësisë së arsimit dhe sistemeve të formimit profesional, lehtësimin e mundësisë së arsimit e formimit profesional dhe prezantimin e këtyre sistemeve në gjithë botën. Ndihma që i jepet popullsisë për t'u përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme teknologjike është një nga mjetet kyçe në luftën kundër papunësisë dhe në ndërtimin e një Europe të njohurive është.

Avokati i popullit (Ombudsman). Avokati i Popullit emërohet nga Parlamenti Europian pas çdo procesi zgjedhor për mandatin parlamentar. Ai ka të drejtë të marrë ankesa që kanë të bëjnë me keqadministrimin në veprimtarinë e institucioneve të Komunitetit apo të organeve të Komunitetit (me përjashtim të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian dhe Gjykatës së Shkallës së Parë) nga çdo qytetar i Bashkimit, apo çdo person fizik ose juridik me banim në një Shtet Anëtar.

Në rast se Avokati i Popullit e përcakton një çështje si keqadministrim, ai e referon atë tek institucioni përkatës, heton, kërkon një zgjidhje për problemin dhe, në rast se është e nevojshme, dorëzon projekt-rekomandime ndaj të cilave institucioni duhet të përgjigjet me anë të një raporti të detajuar brenda tre muajve.

Ai i dorëzon Parlamentit Europian një raport në fund të çdo sesioni vjetor.

Axhenda 2000. Axhenda 2000 është një program veprimi i miratuar nga Komisioni më 15 korrik 1997 si një përgjigje zyrtare ndaj kërkesave të Këshillit Europian të Madridit në dhjetor 1995. Kjo axhendë paraqet një dokument të përgjithshëm mbi zgjerimin dhe reformën e politikave të përbashkëta dhe një komunikatë mbi të ardhmen e kuadrit financiar të Bashkimit Europian pas 31 dhjetorit 1999. Axhenda 2000 trajton të gjitha problemet që ka hasur Bashkimi Europian në fillim të shekullit XXI. Bashkëngjitur në të janë opinionet e Komisionit për vendet aplikante për anëtarësim në Bashkimin Europian.

Axhenda 2000 ndahet në tri pjesë:

- Pjesa e parë trajton çështjen e veprimeve të brendshme në Bashkimin Europian, veçanërisht reformën në Politikën e Përbashkët Bujqësore (CAP) dhe në Politikën e Kohezionit Ekonomik dhe Social. Kjo pjesë gjithashtu përmban rekomandimet për të përballuar sfidat e zgjerimit në kushtet më të mira të mundshme dhe propozon funksionimin e një kuadri të ri financiar për periudhën 2000-2006

- Pjesa e dytë propozon një strategji para-aderimi, e cila përfshin dy elementë kryesorë: partneritetin për aderim dhe pjesëmarrjen e zgjeruar të vendeve aplikante në programet Komunitare, si edhe mekanizmat për zbatimin e *acquis communautaire*
- Pjesa e tretë përfshin një studim mbi ndikimin e efekteve të zgjerimit në politikat e Bashkimit European

Këto prioritete u detajuan në rreth 20 propozime legjislative të parashtruara nga Komisioni European në vitin 1998. Këshilli European në Berlin i mbledhur në vitin 1999 arriti një marrëveshje të përgjithshme politike mbi paketën legjislative, si rezultat i së cilës masat u miratuan në të njëjtin vit. Këto masa mbulojnë 4 fusha të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën për periudhën 2000- 2006:

- reforma e Politikës së Përbashkët Bujqësore (PPB)
- reforma e politikës strukturore
- instrumentet e para-aderimit
- kuadri financiar

Axhenda politike e Bashkimit European. Këshilli European i Madridit (15-16 dhjetor 1995) e përshkruan axhendën e Bashkimit European për fundin e shekullit, si një axhendë që hedh themelet për Europën e së Ardhmes, një bashkësi e madhe që gëzon liri, mirëqenie dhe stabilitet. Më konkretisht kjo do të thotë:

- përshtatja e Traktatit të Bashkimit European
- kryerja e të gjitha transfertave në një monedhë të vetme sipas afateve dhe kushteve të rëna dakort
- përgatitja dhe zbatimi i negociatave për zgjerimin
- miratimi i perspektivës së ardhshme financiare për periudhën pas datës 31 dhjetor 1999
- përcaktimi i arkitekturës së re europiane të mbrojtjes
- vijueshmëri aktive e politikës së dialogut, bashkëpunimit dhe asociimit që ka nisur tashmë në vendet fqinje të Bashkimit, veçanërisht me Rusinë, Ukrainën, Turqinë dhe vendet mesdhetare.

Banka Europiane e Investimeve. Banka Europiane e Investimeve, e krijuar nga Traktati i Romës, është institucioni financiar i Komunitetit. Detyrat e saj kontribuojnë në zhvillimin e ekuilibruar të Komunitetit me anë të integritit ekonomik dhe kohezionit social.

Aksionerët e Bankës Europiane të Investimeve janë Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian. Banka administrohet nga Bordi i Guvernatorëve, që përfshin 15 ministrat e financave. Banka Europiane e Investimeve gëzon personalitet juridik dhe është e pavarur nga ana financiare. Siguron financim afatgjatë për projekte praktike për të cilat është siguruar mbështetje ekonomike, teknike, mjedisore dhe financiare. Banka Europiane e Investimeve jep kredi veçanërisht nga burimet e fituara nga tregjet kapitale, të cilave u shtohet kapitali i aksionerëve. Gjatë periudhës 1994 dhe 1999 transporti, telekomunikacioni, energjia, uji, arsimi dhe sektori i trainimit ishin përfituesit kryesorë.

Në mars 2000, përfundimet e Këshillit Europian të Lizbonës kërkuan forcimin e përkrahjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SME), "Grupi-Banka Europiane e Investimeve", që përfshin Bankën Europiane të Investimeve dhe Fondin Europian të Investimeve, u krijua për të rritur konkurrencën europiane. Me anë të iniciativës "Inovacion 2000", nxitet sipërmarrja, novacioni dhe përdorimi optimal i burimeve njerëzore, duke dhënë kredi afatmesme, garanci bankare, si dhe duke financuar veprimtari të sipërmarrjes së kapitalit.

Banka Europiane e Investimeve përkrah strategjitë e para-aderimit të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore dhe menaxhon dimensionin financiar të marrëveshjeve të përfunduara sipas ndihmës europiane për zhvillim dhe politikat europiane të bashkëpunimit.

Banka Qendrore Europiane. Banka Qendrore Europiane e filloi punën në 30 qershor 1998. Më 1 janar 1999, mori përsipër zbatimin e politikës monetare të Bashkimit Europian të përcaktuar nga Sistemi Europian i Bankave Qendrore. Organet vendimmarrëse të Bankës Qendrore Europiane (këshilli drejtues dhe bordi ekzekutiv) drejtojnë Sistemin Europian të Bankave Qendrore që kanë për detyrë menaxhimin e parave në qarkullim, drejtimin e veprimeve për shkëmbimin e valutës së huaj, ruajtjen dhe menaxhimin e rezervave të valutës së huaj të zyrtarëve të Shteteve Anëtare, nxitjen dhe lehtësimin e sistemit të pagesave. Banka Qendrore Europiane zëvendësoi Institutin Europian Monetar.

Traktati i Nisës i miratuar në dhjetor 2000 nuk e ndryshoi përbërjen e Këshillit Drejtues të Bankës Qendrore Europiane (i përbërë nga anëtarët e bordit ekzekutiv dhe guvernatorët e bankave qendrore dhe kombëtare), por lejoi ndryshimet në rregullat e vendimmarrjes (vendimet përgjithësisht miratohen me shumicë të thjeshtë ku secili shtet ka një votë). Çdo ndryshim kërkon vendim me unanimitet të Këshillit Europian për t'u ratifikuar nga Shtetet Anëtare.

Bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështjet penale. Disa nga fushat e politikës të përfshira në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (Drejtësia dhe Punët e Brendshme, apo "shtylla e tretë") u kaluan në shtyllën e parë nga Traktati i Amsterdimit. Për fushat që mbetën në shtyllën e tretë, veçanërisht bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet penale, Traktati i Amsterdimit caktoi një nga objektivat më të rëndësishme të Bashkimit - krijimin e një zone lirie, sigurie dhe drejtësie.

Qëllimi është që publiku të ketë një nivel të lartë mbrojtjeje për të parandaluar dhe për të luftuar dukuritë e racizmit dhe ksenofobisë, si dhe krimet të tjera ndërkufitare, përfshirë:

- terrorizmin;
- trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimeve kundër fëmijëve;
- trafikimin e drogave;
- trafikimin e armëve;
- korrupsionin dhe mashtrimin.

Kjo do të arrihet nëpërmjet:

- bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet forcave policore dhe autoriteteve doganore me anë të Zyrës Europiane të Policisë (Europol)
- bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore, përfshirë bashkëpunimin me Njësinë Europiane për Bashkëpunimin në Gjyqësor (Eurojust), caktuar në Traktatin e Nisës
- përafrimit, në rastet e nevojshme, të rregullave mbi çështjet penale në Shtetet Anëtare

Ndonëse Traktati i Amsterdimit dhe Traktati i Nisës zgjeruan përdorimin e votimit me shumicë të cilësuar, vendimet mbi çështje të përfshira nën shtyllën e tretë duhet të miratohen ende në mënyrë unanime. Nga ana tjetër, për sa i takon sigurisë dhe drejtësisë, kanë ndryshuar një sërë aktesh ligjore të përdorur në fushën e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në Traktatin e Masihtit. Qëndrimi i përbashkët dhe marrëveshja mbeten, ndërsa veprimet e përbashkëta janë zëvendësuar nga dy instrumente të reja: vendimet dhe vendimet kuadër.

Acquis mbi Shengenin e hartuar nga disa Shtete Anëtare në një kuadër ndërqeveritar, i cili mbulon bashkëpunimin policor e gjyqësor, u përfshi në kuadrin e Bashkimit dhe Komunitetit European me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.

Bashkëpunim më i ngushtë. Instrumente të ndryshëm, si Marrëveshja e Politikës Sociale dhe Marrëveshjet e Shengenit janë prezantuar për të inkurajuar një bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet vendeve të Bashkimit European të cilat duan të bashkëpunojnë përtej shkallës së integritit të parashikuar në Traktate (në fushën e punëve sociale, eliminimin e kontrolleve kufitare etj). Kjo u ka

dhënë mundësinë Shteteve Anëtare që të dëshirojnë të ecin përpara me një ritëm të ndryshëm ose objektiva të ndryshme jashtë kuadrit institucional të Bashkimit Europian.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, përdorimi i këtyre instrumentave u bë më formal me prezantimin e konceptit të "bashkëpunimit më të ngushtë" në Traktatin e Bashkimit Europian dhe Traktatin Themelues të Komunitetit Europian.

Qëllimi i një bashkëpunimi të tillë është që Shtetet Anëtare të cilat janë të gatshme dhe të afta, të thellojnë më tej integrimin europian brenda një kuadri të vetëm institucional të Bashkimit Europian.

Një bashkëpunim më i ngushtë duhet të plotësojë një sërë kushtesh. Në veçanti duhet të:

- shtrihet në fusha që nuk janë kompetencë ekskluzive e Komunitetit;
- synojë përparimin e objektivave të Bashkimit;
- respektojë parimet e Traktateve dhe të *acquis communautaire*;
- përdoret vetëm si mjete i fundit;
- përfshijë një numër minimal Shtetesh Anëtare;
- lejojë integrimin gradual të Shteteve të tjera Anëtare.

Bashkëpunimi më i ngushtë në Traktatin e Komunitetit Europian autorizohet nga Këshilli, i cili vendos me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit, pasi është këshilluar me Parlamentin Europian.

Qëllimi i një bashkëpunimi më të ngushtë në Traktatin e Komunitetit Europian, sipas dispozitave të Traktatit të Amsterdimit, është krijimi i një zone lirie, sigurie dhe drejtësie. Me kërkesë të Shteteve Anëtare të interesuara, ky bashkëpunim autorizohet nga Këshilli që pasi ka marrë mendimin e Komisionit dhe pasi i ka paraqitur kërkesën Parlamentit Europian vendos me shumicë të cilësuar.

Sipas Traktatit të Amsterdimit, një Shtet Anëtar mund të refuzojë kur të dojë bashkëpunimin më të ngushtë në një fushë të caktuar për arsye të rëndësishme të politikës kombëtare. Megjithatë, një shumicë e cilësuar në Këshill mund t'i drejtojë çështjen Këshillit Europian, i cili duhet të vendosë me unanimitet.

Traktati i Nisës në veçanti synoi thjeshtimin dhe përdorimin e bashkëpunimit më të ngushtë. Ai prezantoi ndryshime të rëndësishme, si:

- Numri minimal i Shteteve Anëtare të nevojshme për të krijuar bashkëpunim më të ngushtë u përgjysmua (Traktati i Amsterdimit) në tetë, pavarësisht nga numri i plotë i Shteteve Anëtare.
- Shtetet Anëtare nuk mund të pengojnë bashkëpunimin më të ngushtë. Çështja mund t'i drejtohet Këshillit Europian, por vendimin e merr Këshilli i Ministrave me shumicë të parashikuar në Traktate.
- Sipas Traktatit të Komunitetit Europian, kërkohet pëlqimi i Parlamentit nëse bashkëpunimi më i ngushtë mbulon një fushë që kërkon vendimmarrje të përbashkët.

- Është shtuar një kusht për zbatimin e bashkëpunimit më të ngushtë, i cili nuk duhet të rrezikojë tregun e brendshëm dhe kohezionin social.

Traktati i Nisës prezantoi mundësinë e bashkëpunimit më të ngushtë në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, me përjashtim të çështjeve që kanë implikime ushtarake dhe mbrojtjeje. Në nivel procedural, është Këshilli ai që merr vendime pasi ka marrë mendimin e Komisionit dhe vendos me shumicë të cilësuar bazuar në një strategji të përbashkët.

Bashkëpunim Politik Europian. Bashkëpunimi Politik Europian u prezantua jozyrtarisht në vitin 1970 (në përgjigje të raportit Davinjon) dhe u zyrtarizua me Aktin Unik Europian që hyri në fuqi në vitin 1987. Qëllimi i Bashkëpunimit Politik Europian është këshillimi ndërmjet Shteteve Anëtare në çështjet e politikës së jashtme. Shtetet Anëtare marrin parasysh pikëpamjet e Parlamentit Europian dhe kur është e mundur mbajnë qëndrime të përbashkëta në organizatat ndërkombëtare. Bashkëpunimi Politik Europian përfundoi me Politikën e Përbashkët të Jashtme të Sigurisë.

Bashkim Doganor. Bashkimi Doganor është elementi thelbësor i Tregut të Përbashkët. Prezantimi i tij ishte objektivi parësor pas nënshkrimit të Traktatit të Romës dhe vazhdoi deri në vitin 1968. Masat më të rëndësishme përfshinin:

- eliminimin e detyrimeve doganore dhe kufizimeve sasiore midis Shteteve Anëtare;
- prezantimin e një tarife të përbashkët doganore (CCT) të zbatueshme në Komunitetin Europian për mallrat nga vendet e treta (të ardhurat e fituara si rezultat i burimeve të vetë Komunitetit);
- politikën e përbashkët tregtare si një dimension të jashtëm të Bashkimit Doganor (Komuniteti ka zë në nivel ndërkombëtar).

Procedura dhe rregulla të përbashkëta u hartuan së bashku me Dokumentin Unik Administrativ që synon zëvendësimin e dokumenteve të ndryshëm të përdorur më përpara. Në vitin 1993, me hyrjen në fuqi të tregut të vetëm, u hoqën jo vetëm të gjitha kontrollet rutinë në kufijtë e brendshëm, por edhe formalitetet doganore. Kështu që shërbimet doganore të Shteteve Anëtare e humbën përgjegjësinë e tyre për të mbledhur akciza, TVSH dhe të dhëna statistikore.

Komuniteti ka përfunduar disa marrëveshje, si: për të lehtësuar tregun (marrëveshje me Zonën Ekonomike Europiane), për të nxitur zhvillim duke siguruar hyrje preferenciale në tregjet europiane (Konventa Lomé e nënshkruar me vendet e Afrikës, të Karaibeve dhe të Paqësorit).

Sfidat e së ardhmes përfshijnë nxitjen e bashkëpunimit më të ngushtë ndërmjet administratave kombëtare dhe luftën kundër mashtimit përmes programeve të njëpasnjëshme Dogana 2002 dhe Dogana 2007. Zgjerimi i Bashkimit Europian që u bë në 2004 ngre dhe çështjen e integritit të administratave të Shteteve të reja Anëtare.

Bashkimi Ekonomik dhe Monetar. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar është procesi i harmonizimit të Politikës Ekonomike dhe Monetare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian me synim prezantimin e një monedhe të vetme, Euron. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar ishte subjekt i njëres prej dy Konferencave Ndërqeveritare që i përfunduan diskutimet e tyre në Mاستriht në dhjetor 1991.

Traktati parashikon që Bashkimi Ekonomik dhe Monetar të arrihet me tri faza:

- faza e parë (1 korrik 1990- 31 dhjetor 1993): lëvizja e lirë e kapitalit ndërmjet Shteteve Anëtare, bashkëpunim i ngushtë të politikave ekonomike dhe bashkëpunim i ngushtë ndërmjet bankave qendrore.
- faza e dytë (1 janar 1994 - 31 dhjetor 1998): konvergjenca e politikave ekonomike dhe monetare të Shteteve Anëtare (për të siguruar stabilitet të çmimeve dhe financa të qëndrueshme publike), krijimi i Institutit Europian Monetar dhe i Bankës Qendrore Europiane në vitin 1998.
- faza e tretë (nga 1 janari 1999): përcaktim i pakthyesëm i kursit të këmbimit valutor dhe prezantim i një monedhe të vetme në tregjet e valutave të huaja dhe pagesave elektronike të ndjekur nga prezantimi i kartmonedhave dhe monedhave euro nga 1 Janari 2002.

Faza e tretë e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar filloi në 11 Shtetet Anëtare që u bashkuan dy vjet më vonë se Greqia. Tri Shtete Anëtare nuk e kanë miratuar monedhën e vetme: Britania e Madhe dhe Danimarka, të cilat përfituan nga një klauzolë e mospjesëmarrjes (opt-out), ndërsa Suedia nuk i plotëson të gjitha kriteret në lidhje me pavarësinë e bankës së saj qendrore.

Në 1 Janar 2002, kartmonedhat dhe monedhat euro u prezantuan në Shtetet Anëtare, duke zëvendësuar gradualisht valutën vendase (valuta "trashëgimie"). Në 28 shkurt 2002, përfundoi faza kalimtare e qarkullimit të dyfishtë të valutave. Euro tani është valuta e vetme për më shumë se 300 milion evropianë. Sfidat që përballen me suksesin afatgjatë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar janë konsolidimi i vazhdueshëm buxhetor dhe bashkëpunimi i ngushtë i politikave ekonomike të Shteteve Anëtare.

Bashkimi Europian Perëndimor. I krijuar në vitin 1948 nga Traktati i Brukselit, Bashkimi Europian Perëndimor është një organizatë europiane që ka për qëllim bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Përbëhet nga 28 vende me katër statuse të ndryshme: Shtete Anëtare, Anëtarë të Asociuar, Vëzhgues dhe Partnerë të Asociuar. Të gjitha vendet e Bashkimit Europian janë Shtete të plota Anëtare, me përjashtim të Danimarkës, Irlandës, Austrisë, Finlandës dhe Suedisë që kanë statusin e vëzhguesit. Gjashtë anëtarët e asociuar janë Republika Çeke, Hungaria, Islanda, Norvegjia, Polonia dhe Turqia, ndërsa partnerët të asociuar janë shtatë: Bullgaria, Estonia, Letonia, Lituania, Rumania, Sllovakia dhe Sllovenia.

Traktati i Amsterdimit e bëri Bashkimin Europian Perëndimor një "pjesë të pandarë të zhvillimit të Bashkimit", duke i dhënë aftësi vepruese në fushën e mbrojtjes. Bashkimi Europian Perëndimor luajti një rol të madh në detyrat e para të Petersburgut, si: tërheqja policore nga Mostari, apo bashkëpunimi me policinë

në Shqipëri. Megjithatë, tashmë ai duket sikur e ka braktisur atë rol në favor të zhvillimit të strukturave dhe të aftësive të vetë Bashkimit në sferën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Transferimi i aftësive vepruese të Bashkimit European Perëndimor tek Bashkimi European janë një dëshmi e kësaj. Organet dytësore të Bashkimit European Perëndimor, Instituti i Studimeve të Mbrojtjes dhe Qendra Satelitore iu bashkuan Bashkimit më 1 janar 2002. Traktati i Nisës fshihi nga Traktati mbi Bashkimin European një numër dispozitash që kishin të bënin me marrëdhëniet ndërmjet Bashkimit European Perëndimor dhe Bashkimit European. Fusha kryesore e përgjegjësive të Bashkimit European Perëndimor mbetën neni V (Mbrojtja kolektive). Transferimi i kësaj përgjegjësie tek Bashkimi duket se ka ndryshuar.

Bërthama (Kocka e fortë). Ky term ka të bëjë me një grup të vogël vendesh të afërta dhe që dëshirojnë të krijojnë një bashkëpunim më të ngushtë me një shtet tjetër. Ky koncept duhet parë në kontekstin e përgjithshëm të fleksibilitetit që përfshin integrim të ndryshëm të ruajtur në kuadrin institucional të Bashkimit European, për të mos lejuar që bërthama të formohet jashtë këtij kuadri (ashtu si ndodhi me zonën e Shengenit)

Burime vetjake. Fillimisht buxheti i Komunitetit, si edhe ai i organizatave të tjera, varej nga kontributet financiare të Shteteve Anëtare. Por, sipas një vendimi të miratuar më 21 prill 1970, kontributet e Shteteve Anëtare u zëvendësuan nga burime vetjake. Për të mbuluar financimin e shpenzimeve të Bashkimit European, Shtetet Anëtare bëjnë transferta në buxhetin e Komunitetit. I gjithë kombinimi i burimeve vetjake nuk e kalon masën 1.27% të produktit kombëtar bruto (PKB) të agreguar të Shteteve Anëtare.

Me futjen e këtij sistemi u vendos një autonomi financiare dhe që nga 1 janari i vitit 1978, buxheti i Komunitetit është financuar tërësisht nga burimet vetjake. Për momentin, këto përbëhen nga katër elementë:

- **Tarifat mbi importet bujqësore dhe taksat mbi sheqerin dhe izoglukozën** - përbëhen kryesisht nga tarifat mbi importet bujqësore, si edhe taksat e prodhimit dhe magazinimit në kuadrin e organizatës së përbashkët të tregjeve të sheqerit.
- **Detyrime doganore** - rrjedhojë e zbatimit të detyrimeve të zakonshme doganore mbi importet nga vendet e treta;
- **Burimi i TVSH-së** - rrjedhojë e zbatimit të një norme të caktuar mbi bazën e TVSH-së të secilit Shtet Anëtar. Norma ishte 1 % për vitin 1999, por me vendimin e ri për burimet vetjake (shtator 2000) ajo zbriti në 0.75% në vitin 2002-2003 dhe në 0.50% nga viti 2004. Shuma e TVSH-së nuk mund të kalojë masën 50% të PKB-së të një Shteti Anëtar;
- **'Burimi i katërt'** - i prezantuar në vitin 1988, është një burim i ashtuquajtur "burim shtesë", sepse përcaktohet sipas tre burimeve të tjera të të ardhurave buxhetore. Bazohet në PKB-në e të gjitha Shteteve Anëtare.

Në buxhetin e vitit 2002, të ardhurat e Bashkimit Europian arritën shumën 95.6 miliard euro, nga të cilat 43% vinin nga burimet e PKB-së, 38.3 % nga burimi i TVSH-së, 14.8% nga detyrimet doganore dhe 1.8% nga tarifat mbi importet bujqësore.

Buxheti. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkimit Europian në Komunitet përfshihen në buxhet në bazë të parashikimeve vjetore. Shpenzimet e përfshira në zbatim të Titullit V dhe VI të Traktatit të Bashkimit Europian, mund të përbëjnë një përjashtim nga ky rregull, pasi u ngarkohen Shteteve Anëtare. Buxheti i Komunitetit arrin shifrën 91 miliard euro në shumën të caktuar për angazhimet e ndryshme.

Buxheti i Komunitetit bazohet në disa parime, të cilat përfshijnë:

- bashkim (të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet mblihen në një dokument të vetëm)
- përvitshmëri (veprimet buxhetore përkohë me një vit të caktuar buxhetor)
- ekuilibër (shpenzimet nuk duhet të tejkalojnë të ardhurat)

Komisioni është përgjegjës për t'i paraqitur Këshillit, i cili ndan kompetenca buxhetore me Parlamentin Europian, një projekt buxhet paraprak. Forma e shpenzimeve përcakton se cili nga dy institucionet ka fjalën e fundit nëse shpenzimi është fikse apo variabël. Megjithatë, përveç klasifikimit të shpenzimeve dhe ndarjes së kompetencave, duhet të mbahet parasysh që Parlamenti Europian miraton përfundimisht ose refuzon buxhetin në tërësi.

Që në vitin 1993 buxheti ka qenë pjesë e një marrëveshjeje ndër-institucionale ndërmjet Parlamentit, Këshillit dhe Komisionit mbi disiplinën buxhetore dhe përmirësimin e procedurës buxhetore. Në vitin 1998 Komisioni paraqiti një plan për rishikimin e marrëveshjes ndër-institucionale, duke pasur parasysh përvojën e fituar në zbatim të tij dhe për të konsoliduar të gjitha deklaratat e përbashkëta dhe marrëveshjet ndër-institucionale për buxhetin që nga viti 1982.

Një perspektivë e re financiare do të miratohet nga Shtetet Anëtare për të përcaktuar shtesën e buxhetit për periudhën 2000-2006, si pjesë e reformave të propozuara nga Komisioni në "Axhendën 2000" në korrik 1997.

Coreper (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm). *Coreper*, një akronim francez që njihet si Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm, përbëhet nga Përfaqësues të Përhershëm të Shteteve Anëtare (Ambasadorë) dhe gjatë negociemeve paraprake është përgjegjës për të ndihmuar Këshillin e Bashkimit Europian në negociimin e çështjeve në axhendë (propozime dhe projekte të dokumentave të parashtruara nga Komisioni). *Coreper* zë një pozicion kyç në sistem e vendimmarrjes në Komunitet, i cili në të njëjtën kohë është një forum për dialog (midis Përfaqësuesve të Përhershëm dhe ndërmjet tyre dhe shtetasve) si edhe një organ që ushtron kontroll politik (duke përgatitur udhëzime, duke mbikqyrur punën e grupeve të ekspertëve). Në fakt, për të trajtuar çështjet që duhet të zgjidhë, *Coreper* është i ndarë në dy pjesë:

- Coreper I, përbëhet nga zëvendës përfaqësues të përhershëm
- Coreper II, përbëhet nga vetë përfaqësuesit e përhershëm.

Funksionimi i Këshillit varet nga puna e Coreper-it.

COREU (Korrespondenca Europiane). Coreu është një rrjet komunikimi i Bashkimit Europian ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komisionit për bashkëpunim në fushat e politikës së jashtme. Kjo e bën më të lehtë që vendimet të merren menjëherë.

- D -

Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian. Meqë zgjerimit iu dha drita jeshile, Konferenca Ndërqeveritare 2000 synoi krijimin e një debati më të gjerë dhe më të thellë mbi të ardhmen e Bashkimit Europian. Për këtë qëllim, Deklarata e Nisës, shtojcë e Traktatit të Nisës, kërkon fillimin e një debati të gjerë që bashkon të gjitha palët e interesuara, si përfaqësuesit e parlamenteve kombëtare ashtu edhe opinionin publik (Pra, organizata politike dhe tregtare, universitete dhe përfaqësues të shoqërisë civile në Shtetet Anëtare dhe në vendet candidate)

Ky debat mbi të ardhmen e Bashkimit do të vazhdojë deri në 2004 përmes diskutimeve dhe përdorimit të internetit për të mbledhur sa më shumë mendime për çështjet kyçe që lidhen me të ardhmen e Europës. Ky debat inkurajohet nga Komisioni që shpreson se do të nxitet në nivel europian me kontribute dhe forume diskutimi duke përfshirë personalitete nga Komuniteti dhe, në nivel kombëtar, me debate kombëtare për të ardhmen e Bashkimit duke përfshirë një numër të madh shtetasish.

Shkëmbimet që bëhen në kontekst të këtij debati drejtohen paralelisht me punën për Konventën përgatitore për KNQ 2004.

Deficit demokratik. Deficit demokratik është një koncept parimisht i ngritur mbi argumentin që në Bashkimin Europian mungon demokracia dhe nuk kuptohet nga qytetari i thjeshtë, sepse metoda e funksionimit të tij është shumë e ndërlikuar. Sistemi institucional i Komunitetit dominohet nga një institucion që kombinon kompetencat legjislative dhe qeveritare (Këshilli) dhe një institucion që nuk ka ligjshmëri demokratike (Komisioni, edhe pse anëtarët e tij emërohen nga Shtetet Anëtare dhe miratohen të gjithë në Parlament).

Me përparimin e integritimit europian, çështja e ligjshmërisë demokratike u bë mjaft delikate. Traktatet e Nisës, Amsterdami dhe Mastrohitit kanë vonuar përfshirjen e parimit të ligjshmërisë demokratike brenda sistemit institucional duke rirforcuar kompetencat e Parlamentit në lidhje me emërimin dhe kontrollin e Komisionit si dhe duke e shtrirë qëllimin e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët .

Ndërkohë, për ta afruar Europën me qytetarët, janë përcaktuar dy nisma. Pas Këshillit Europian të Nisës (7-10 dhjetor 2000), filloi debati mbi të ardhmen ku mund të marrin pjesë qytetarët e Bashkimit Europian. Gjithashtu u mbledh një Konventë Europiane në Këshillin Europian të Laeken-it që shqyrton, mes të tjerash, aspektet e ndryshme të ligjshmërisë demokratike.

Deklarata (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë). Deklarata është një dokument për të cilin nuk ka dispozita në Titullin V të Traktatit të Bashkimit Europian, por është tipar i bashkëpunimit politik europian. Deklarata nuk është instrument i detyrueshëm. Ajo përdoret vazhdimisht nën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë.

Deklarata e Laeken-it. Një vit pas Traktatit të Nisës dhe Deklaratës së Nisës, sipas të cilave duhet të ndiqen reforma institucionale. Këshilli Europian në Laeken më 15 dhjetor 2001 miratoi një Deklaratë mbi të ardhmen e Bashkimit Europian, ose Deklaratën e Laeken-it, ku kërkohet angazhimi i Bashkimit Europian për t'u bërë më demokratik, më transparent dhe më efektiv.

Kjo deklaratë prezanton 60 pyetje në lidhje me të ardhmen e Bashkimit Europian, rreth katër temave:

- 1- ndarjen dhe përcaktimin e kompetencave,
- 2- thjeshtimin e Traktateve,
- 3- rrjetin institucional
- 4- rrugën drejt një Kushtetute për qytetarët europianë.

U mbledh një Konventë për të shqyrtuar pyetjet themelore që kanë të bëjnë me zhvillimin e ardhshëm të Bashkimit për të qenë më transparentë dhe më të gjerë në KNQ e radhës.

Detyrat e Petersbergut. Këto detyra u përcaktuan në qershor 1992 në Këshillin Ministror të Bashkimit Europian Perëndimor të mbajtur në hotelin "Petersberg", jo shumë larg Bonit. Me këtë rast, Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian Perëndimor treguan gatishmërinë e tyre për të vënë në dispozicion njësi ushtarake nga i gjithë spektri i tyre i forcave të armatosura konvencionale, të drejtuara nën përgjegjësinë e Bashkimit Europian Perëndimor. U përcaktuan detyra të ndryshme ushtarake, të cilat mund të merren përsipër nga Bashkimi Europian Perëndimor. Përveç kontributit në mbrojtjen kolektive në përputhje me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit dhe nenit V të Traktatit të modifikuar të Brukselit, njësitë ushtarake të Shteteve Anëtare të Bashkimit Europian Perëndimor mund të angazhohen për:

- detyra humanitare dhe shpëtimi
- detyra paqeruajtëse
- detyrat e forcave të luftimit në menaxhimin e krizave, përfshirë edhe vendosjen e paqes

Këto detyra janë të përfshira shprehimisht në nenin 17 të Traktatit të Bashkimit Europian dhe përbëjnë një pjesë të pandarë të Politikës Europiane të Mbrojtjes dhe Sigurisë.

Dialogu social. Dialogu social është termi i përdorur për përshkrimin e procedurës së konsultimit të përbashkët me përfshirjen e partnerëve social në nivel europian (Bashkimi i Industrive të Komunitetit Europian, Qendra Europiane për Ndërmarrje Publike, Komiteti Ekonomik dhe Social). Këtu përfshihen diskutime, veprime të përbashkëta dhe, ndonjëherë, negociata ndërmjet partnerëve social europian, si dhe diskutime ndërmjet partnerëve social dhe institucioneve të Bashkimit.

Komisioni European e nisi këtë dialog në vitin 1985 dhe pas Aktit Unik European, në Traktat Komisionit i kërkohet zyrtarisht të zhvillojë këtë dialog social (neni 139, ish neni 118b). Deri më tani, kanë rezultuar pesëmbëdhjetë mendime të përbashkëta (përveç gjërave të tjera) mbi rritjen ekonomike, futjen e teknologjisë së re, arsimin dhe formimin profesional. Dialogu social mund të çojë gjithashtu në marrëdhënie kontraktuale, përfshirë edhe marrëveshjet, zbatimin e cilave i nënshtrohet vendimit të Këshillit me propozim të Komisionit. Ka patur dy marrëveshje të këtij lloji ndërmjet punëdhënësve dhe të punësuarve – mbi lejen e prindërve dhe mbi punën me kohë të pjesëshme.

Përveç dialogut të vazhdueshëm ndërmjet dy anëve të industrisë, në mars 1996, Komisioni organizoi Forumin e Parë European mbi politikën sociale, i cili mbledhi përfaqësues nga organizata vullnetare, organizata joqeveritare, sindikata, organizata të punëtorëve, institucione të Bashkimit European dhe Shtete Anëtare.

Dispozita fiskale. Pavarësisht prezantimit të një tregu të vetëm dhe Bashkimit Ekonomik Monetar, nuk ekziston ende një politikë e vërtetë e Komunitetit mbi dispozitat fiskale. Dispozita të veçanta janë përcaktuar nga neni 90 në nenin 93 të Traktatit të Komunitetit European (ish nenet 95-99), por procedura e vendimmarrjes së përbashkët për dispozitat fiskale kërkon një votim unanim në Këshill. Deri më tani kjo ka shërbyer si një shkëputje për miratimin e rregullave të përgjithshme për taksat direkte dhe indirekte.

Me qëllim shmangien e këtyre pengesave, Komisioni inkurajon tani përdorimin e procedurës së "bashkëpunimit më të ngushtë" të paraqitur në Traktatin e Amsterdimit dhe të çuar më tej nga Traktati i Nisës. Kjo procedurë bën të mundur që Komisioni të propozojë një grup prej të paktën tetë Shtetesh të cilat të bashkëpunojnë mbi një çështje të caktuar pas miratimit nga Këshilli që vepron me shumicë të cilësuar. Procedura gjithashtu inkurajon Shtetet Anëtare të miratojnë rekomandime që synojnë eliminimin e pengesave të dëmshme të krijuara nga taksat, dhe jo të propozimeve detyruese ligjore.

Kontrollet kufitare për TVSH-në u shfuqizuan me futjen e tregut të vetëm në vitin 1993. Sot, produktet taksohen në vendin e blerjes, por pasi Këshilli të vendosë sistemin përfundimtar të TVSH-së, produktet do të taksohen në vendin e origjinës. Gjithashtu, TVSH-ja dhe normat e akcizës janë afruar më shumë në Shtete të ndryshme Anëtare.

Miratimi i një monedhe të vetme po e bën akoma më urgjente vendosjen e normave të përbashkëta të TVSH-së dhe rregullave të taksave të përbashkëta në Bashkimin European. Në dhjetor të vitit 1997, Këshilli miratoi një kod etike mbi politikën e taksave të biznesit ("paketa e taksave"). Këshilli është duke analizuar propozime të ndryshme të Komisionit, veçanërisht mbi marrëdhëniet ndërmjet shoqërive të asociuara, taksat mbi kursimet ndër-kufitare dhe një sistem të përbashkët TVSH-je.

Drejhtësia dhe punët e brendshme. Bashkëpunimi në drejtësi dhe në punët e brendshme u institucionalizua me Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (njihet

edhe si "shtylla e tretë"). Qëllimi i këtij bashkëpunimi ishte t'i jepte forcë praktike parimit të lëvizjes së lirë të personave. Drejtësia dhe punët e brendshme mbulojnë fushat e mëposhtme:

- politikat për azilin
- rregullat për kalimin e kufijve të jashtëm të Shteteve Anëtare
- politikat e emigracionit
- luftën kundër drogës
- luftën kundër mashtrimit ndërkombëtar
- bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale dhe civile
- bashkëpunimin doganor

Për të marrë masa në këtë fushë u krijuan instrumente të ndryshme, si: veprimi i përbashkët, qëndrimi i përbashkët dhe konventa. Edhe pse është bërë përparim i rëndësishëm, bashkëpunimi në përgjithësi në këtë fushë është kritikuar. Konsensus është arritur me nevojën për të prezantuar dispozita më efektive për të forcuar strukturat e bashkëpunimit dhe për të përfshirë në kuadrin Komunitar fushat e lartpërmendura që lidhen me kontrollin e personave (azili, emigracioni, kalimi i kufijve).

Traktati i Amsterdimit riorganizoi bashkëpunimin në fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Traktati vendosi si qëllim krijimin e një zone lirie, sigurie dhe drejtësie. Disa sektorë u përfshinë brenda kuadrit të Komunitetit, ndërsa në të njëjtën kohë u shfaqën metoda dhe mjete të reja.

Zona Shengen, që u formua jashtë kuadrit ligjor të Bashkimit European me iniciativën e disa shteteve anëtare që donin të përparonin akoma më shumë përsa i përket lëvizjes së lirë të personave, përfundimisht do të përfshihet në Traktatin e Bashkimit European dhe Traktatin e Komunitetit European.

Traktati i Nisës përmban votimin me shumicë të cilësuar në disa fusha të drejtësisë dhe punëve të brendshme që janë brenda kuadrit komunitar, siç është lëvizja e lirë e personave. Çështjet e shtyllës së tretë kërkojnë përsëri unanimitet. Përveç kësaj, ndryshimet e prezantuara me Traktatin e Nisës e kanë bërë më pak të kufizuar sesa më parë procedurën për bashkëpunim të përforcuar në shtyllën e tretë. Bashkëpunimi në çështjet gjyqësore është rritur për të krijuar një bazë për veprim dhe për krijimin e Njësisë Europiane për Bashkëpunim në Gjyqësor (*Eurojust*) në Traktatin e Bashkimit European.

E drejta e iniciativës. Në mënyrë që Komisioni të ruajë rolin e tij si gardian dhe mbrojtës i interesave të përgjithshme, Komisioni ka të drejtën e iniciativës, e cila i jep autoritet dhe i kërkon të bëjë propozime për çështje në Traktat, sepse kështu parashikohet shprehimisht në të, ose sepse kjo konsiderohet e nevojshme nga Komisioni.

- Kompetenca për iniciativë është ekskluzive për sa i takon çështjeve të Komunitetit, me parimin se Këshilli merr vendime vetëm "me propozim të Komisionit", në mënyrë që të ruhet një kuadër i vazhdueshëm për të gjitha iniciativat.
- Nën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë, Komisioni mund të bëjë propozime, ashtu si edhe Shtetet Anëtare. Nga ana tjetër, ai nuk gëzon të njëjtën të drejtë për çështje të caktuara të lidhura me drejtësinë dhe punët e brendshme.

Këshilli dhe Parlamenti European mund t'i kërkojnë edhe Komisionit të paraqesë propozime, në rast se është e nevojshme. E drejta për iniciativë konsiderohet si një element bazë në ekuilibrin institucional të Komunitetit.

Traktati i Amsterdimit ka shtrirë të drejtën e Komisionit për iniciativë në drejtim të politikave të reja (shëndetësia dhe punësimi), çështjeve që kanë të bëjnë me lëvizjen e lirë të personave dhe me shtyllën e tretë. Në rastin e shtyllës së tretë, Komisioni ndan të drejtën për iniciativë me Shtetet Anëtare.

E drejta komunitare. E drejta komunitare përmban traktatet themeluese (legjislacionin parësor) dhe dispozitat e akteve të miratuara nga institucionet komunitare (legjislacioni dytësor).

Në një kuptim më të gjerë, e drejta komunitare përfshin të gjitha rregullat e rendit ligjor komunitar, përfshirë këtu parimet e përgjithshme të së drejtës, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European, ligjin që është rezultat i marrëdhënieve të jashtme të Komunitetit dhe e drejta shtesë që përfshihet në konventa dhe marrëveshje të ngjashme të lidhura ndërmjet Shteteve Anëtare me qëllim që dispozitat e Traktatit të hyjnë në fuqi.

Të gjitha këto rregulla të së drejtës përbëjnë një pjesë të asaj që njihet si *acquis communautaire*.

e-Europe. Iniciativa *e-Europe* filloi nga Komisioni European në dhjetor 1999 dhe u miratua nga Këshilli European i Lizbonës (mars 2000). Komunikata që u miratua me titullin "*eEurope* - Një shoqëri informacioni për të gjithë", është pjesë e asaj që njihet si strategjia e Lizbonës dhe përcakton qëllimin kryesor që brenda vitit 2010 të jetë ekonomia botërore më konkurruese, më dinamike dhe e bazuar në njohuri. Qëllimet kryesore të iniciativës janë:

- regjistrimi i çdo qytetari, familjeje dhe shkolle, biznesi dhe administrate në dixhital dhe *online*;
- krijimi i një Europe të informuar me mjete dixhitale e mbështetur nga një kulturë sipërmarrëse e hapur për teknologjinë e informacionit;
- sigurimi që shoqëria e informacionit të jetë gjithëpërfshirëse.

Për të arritur këtë qëllim në maj të vitit 2000 Komisioni miratoi Plan Veprimin “*e-Europe 2002*”, i cili në qershor të po këtij viti u miratua edhe nga Këshilli European i Feiras. Veprimet kryesore synonin të nxisnin një internet të shpejtë, të lirë dhe të sigurt, investim financiar dhe rritje të kapaciteteve, si edhe përdorim të internetit.

Plani i Veprimit “*e-Europe*” në qershor 2000 u plotësua më tej me Planin e Veprimit “*e-Europe+*” në vendet candidate që synonin përshpejtimin e reformave dhe modernizmin e ekonomive të vendeve candidate, inkurajimin dhe krijimin e kapaciteteve institucionale, përmirësimin e konkurrencës globale dhe forcimin e kohezionit social.

Në qershor 2002, Këshilli European i Seviljes miratoi Plan Veprimin *e-Europe 2005* që vjen pas *e-Europe 2002*. Plani i ri i Veprimit përqendrohet në përdorimin e rrjetit të komunikimit me çmime konkurruese, sigurinë e rrjetit dhe përdorimin më të mirë të teknologjisë nga organe publike (“*e-Government*”).

Ekuilibrë institucional. Parimi i ekuilibrit institucional të Komunitetit do të thotë që secili institucion duhet të veprojë në përputhje me kompetencat që i jepen nga Traktatet. Vetë ky parim nuk përcaktohet me shumë fjalë në Traktate, por rrjedh nga një vendim i Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European duke ndaluar kështu çdo shkelje kompetencash nga një institucion tek tjetri. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European mban përgjegjësi që ky parim të respektohet.

Marrëdhënia ndërmjet Komisionit, Këshillit dhe Parlamentit European drejtohet nga ideja e “trekëndëshit institucional”. Marrëdhëniet dhe kompetencat që jepen nga Traktatet kanë ndryshuar rrënjësisht gjatë viteve, veçanërisht, në rastin e Parlamentit, ndikimi i të cilit është rritur mjaft. Pavarësisht nga progresi që është bërë nga Traktati i Bashkimit European dhe nga Traktati i Amsterdimit, ekziston akoma një mungesë ekuilibri ndërmjet kompetencave legjislative të Këshillit dhe atyre të Parlamentit, duke qenë se kompetencat legjislative ndahen nga të dyja institucionet në disa fusha ku sundon vendimmarrja e përbashkët.

Konventa, që ka për detyrë të hartojë propozime për një reformë themelore të Bashkimit European, duhet të vendosë një ekuilibër të ri ndërmjet institucioneve (veçanërisht ndërmjet Komisionit dhe Këshillit) dhe të shtrijë në më shumë fusha procedurën e vendimmarrjes së përbashkët. Këto masa synojnë të luftojnë deficitin demokratik që ndikon në Bashkimin European.

Energjia. Qëllimi i politikës së Bashkimit European për energjinë është të garantojë furnizim të sigurt dhe me kosto të ulët të energjisë që nuk përbën rrezik për shëndetin e qytetarit dhe mjedisin.

Në fillim, Traktatet themeluese të Komuniteteve Europiane nuk parashikonin dispozita për një politikë komunitare për energjinë.

Fillimi i procesit të krijimit të Europës shënoi ngritjen e kuadrit institucional për energjinë atomike dhe të qymyrit.

- Në 1951, KEQÇ, traktati i të cilit mbaroi në 31 dhjetor 2002;
- Në 1957 EUROATOM

Traktate të tjera nuk krijuan një bazë të veçantë ligjore për politikën komunitare për energjinë, parimet e së cilës bazohen në Traktatin e Euroatomit dhe në një numër dispozitash që përmbahen në kapitujt "Tregu i brendshëm" dhe "Mjedisi".

Në sistemin aktual të energjisë, Bashkimi European duhet të përballlet me shumë sfida, si : zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, hapjen e tregjeve të energjisë dhe gazit, pakësimin e varësisë energjitike dhe sigurinë bërthamore të Bashkimit European.

I përballur me këto sfida të reja, Bashkimi European ka marrë masa për të garantuar në veçanti siguri të furnizimit përballë varësisë nga importet e naftës nga rajone të pastabilizuara, duke përcaktuar përparësitë në lidhje me energjinë bërthamore, pasi merren parasysh rreziqet e aksidenteve dhe hedhja e mbeturinave, si edhe duke nxitur zhvillim të qëndrueshëm.

Me enegjinë e re për programin e veprimit për Europën, Komisioni po propozon rritjen e përkrahjes europiane për nxitjen e energjive të ripërtëritshme (ALTENER) dhe përdorimin efikas të energjisë (SAVE), ndërsa veprimet ndërkombëtare drejtohen sërish drejt këtyre dy prioritetëve (COOPENER).

Eurocorps (Trupat europiane). *Eurocorps* u krijua në takimin e 59-të Franko-Gjerman të nivelit të lartë, i cili u mbajt në La Rochelle më 21 dhe 22 maj 1992. Që atëherë i janë bashkuar edhe tri vende të tjera: Belgjika më 25 qershor 1993, Spanja më 10 dhjetor 1993 dhe Luksemburgu më 7 maj 1996. *Eurocorps* përfshin 50000 trupa dhe ka funksionuar që në 30 nëntor 1995 në vazhdimësi të Pegasus-95.

Eurocorps është pjesë e Forcave Përgjegjëse për Bashkimin European Perëndimor. Ai mund të funksionojë si i tillë brenda Bashkimit European Perëndimor ose NATO-s dhe mund të mobilizohet për misione humanitare, misione për evakuimin e shtetasve të Shteteve Anëtare dhe vendosjen apo ruajtjen e paqes, nën drejtimin e OKB-së ose OSBE-së. Angazhimi i *Eurocorps* nën kontrollin politik të Bashkimit European Perëndimor u bë subjekt i një marrëveshjeje të nënshkruar në 24 shtator 1993 kurse angazhimi nën autoritetin e NATO-s u kodifikua me marrëveshjen e 21 janarit 1993.

Që në qershor 2001, *Eurocorps* janë një forcë e reagimit të shpejtë në dispozicion të Bashkimit European dhe NATO-s.

EUROFOR/EUOMARFOR. Deklarata e Lizbonës për Bashkimin European Perëndimor në 15 maj 1995 ratifikoi vendimin e Spanjës, Italisë dhe Francës për të

krijuar forca tokësore dhe detare (EUROFOR/EUROMARFOR). Ato janë pjesë e forcave të Bashkimit Europian Perëndimor dhe duhet të forcojnë kapacitetin e Europës për të vepruar sipas Deklaratës së Petersburgut. Portugalia ka rënë dakord të marrë pjesë në të dyja forcat, kur përdoren brenda kontekstit të Bashkimit Europian Perëndimor, pa paragjykuar pozicionin e mbrojtjes kolektive të Shteteve Anëtare.

Europa “à la carte”. Ka të bëjë me një mënyrë jo standarte integrimi që i lejon Shtetet Anëtare të zgjedhin politikat si në një “meny” dhe të përfshihen plotësisht në këto politika. Megjithatë mbeten akoma një numër minimal objektivash të përbashkëta.

Europë me “gjeometri të ndryshueshme”. Europë me “gjeometri të ndryshueshme” është termi i përdorur për të përshkruar idenë e një metode të një integrimi të diferencuar, i cili pranon se ka dallime të pakorrigjueshme brenda strukturës së integritimit dhe, rrjedhimisht, mundëson një ndarje të përhershme ndërmjet një grupi të Shteteve Anëtare dhe një numri njësisht integrimi më pak të zhvilluara.

Europa me “ritëm të shpejtë”. Europë me “ritëm të shpejtë” është termi që përshkruan integrim të diferencuar, ku objektiva të përbashkëta ndiqen nga një grup Shtetesh Anëtare të afërta dhe me dëshirë për të ecur përpara, duke lënë të nënkuptohet që Shtetet e tjera Anëtare do të vijnë më pas.

Europol (Zyra Europiane e Policisë). Europol përmendet në nenin 29 të Traktatit të Amsterdami si një mënyrë për të siguruar qytetarët me një nivel të lartë sigurie brenda zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Ideja për krijimin e një Zyre Europiane të Policisë u hodh fillimisht në Këshillin Europian në Luksemburg në 2 dhe 28 qershor 1991. Plani ishte që të krijohet një organ i ri, i cili do të siguronte një strukturë të re për zhvillimin e bashkëpunimit gjyqësor ndërmjet Shteteve Anëtare në parandalimin dhe në luftimin e formave të rënda të krimit ndërkombëtar të organizuar. Një dispozitë për Zyrën u bë në Traktatin e Mastrohtit dhe Zyra filloi veprimtarinë në 3 janar 1994 si Njësia Europol e Drogës. Në fillim përpjekjet u përqendruan në luftën kundër drogës, por temat e referencës u shtrinë gradualisht në krime të tjera të rënda.

Konventa që krijoi Europolin, u nënshkrua në korrik 1995 dhe hyri në fuqi në 1 tetor 1998, por filloi të funksionojë në 1 korrik 1999. Europol mori përsipër veprimtaritë e Njësive Europol të Drogës psh., në fushën e trafikut të drogës, rrjeteve të emigracionit klandestin, trafikun e mjeteve të vjedhura, trafikun e qenieve njerëzore (përfshi këtu pornografinë me fëmijë), falsifikimin e monedhave dhe të mjeteve të tjera të pagesës, trafikun e substancave radioaktive dhe bërthamore, terrorizmin dhe pastrimin e parave.

Traktati i Amsterdami i kaloi një numër detyrash të ndryshme Europolit, si: bashkërendimin dhe zbatimin e hetimeve specifike të kryera nga autoritetet e Shteteve Anëtare, zhvillimin e ekspertizës së specializuar për të ndihmuar Shtetet Anëtare në hetimin e krimit të organizuar, vendosjen e kontakteve me prokurorët dhe hetuesit e kualifikuar në luftën kundër krimit të organizuar.

Roli i Europolit u rrit në dhjetor 2001 kur kompetencat u shtrinë në të gjitha format e krimit të organizuar të përcaktuar në aneksin e Konventës Europol. U bënë dy sugjerime të tjera shtesë në lidhje me mundësinë për t'i dhënë Europolit kompetenca hetimore dhe me mënyrat për të ushtruar kontroll demokratik mbi këtë zyrë.

Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit. Fondet Strukturore dhe Fondi i Kohezionit janë pjesë e politikës strukturore të Komunitetit, që kanë për qëllim të ngushtojnë hapësirat e zhvillimit ndërmjet rajoneve dhe Shteteve Anëtare të Bashkimit European. Fondet jepen të plota për përbushjen e qëllimeve të kohezionit ekonomik dhe social.

Buxheti i shpërndarë për politikën rajonale të Komunitetit për periudhën 2000-2006 është 213 miliard euro, përfshirë 195 miliard euro për Fondet Strukturore dhe 18 miliard euro për Fondin e Kohezionit. Buxheti përfaqëson 35% të buxhetit të Komunitetit dhe kështu është njëra e dytë për nga madhësia në buxhet.

Ekzistojnë katër Fonde Strukturore:

- Fondi European i Zhvillimit Rajonal, i ngritur në vitin 1975, është fondi më i madh. Ai siguron mbështetje për krijimin e infrastrukturës, investime frytdhënëse për hapjen e vendeve të punës, kryesisht për biznese dhe projekte zhvillimi
- Fondi European Social, i ngritur në vitin 1958, kontribuon në integrimin e të papunëve dhe shtresave të pa privileguara të popullsisë duke financuar kryesisht programe trajnimi.
- Fondi European i Udhëzimit dhe Garancisë Bujqësore, i ngritur gjithashtu në vitin 1958 si një mjet financues për politikën e përgjithshme në bujqësi, ka dy pjesë: një pjesë "Udhëzimi" që jep mbështetje për zhvillimin rural dhe ndihmë për fermerët e vendosur në zona të prapambetura, dhe një pjesë "Garancie" që financon organizata të përgjithshme të tregut së bashku me masat e zhvillimit rural në pjesë të tjera të Komunitetit.
- Instrumenti Financiar për Udhëzimet në Peshkim (IFUP) është krijuar në vitin 1993. Ky instrument rregullon dhe modernizon pajisje dhe materiale të këtij sektori dhe diversifikon ekonominë e zonave që janë të varura nga peshkimi.

Me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimit të Komunitetit gjatë periudhës 2000-06, komunikata e Komisionit "Afhenda 2000" propozoi një reformë të zgjeruar të politikës strukturore, ndikimet financiare të se cilës u përcaktuan në takimin e Këshillit të Berlinit në vitin 1999. Kjo reformë rriti përqendrimin e ndihmës dhe thjeshtoi procedurat për shpërndarjen dhe menaxhimin e ndihmës duke shkurtuar në tre numrin e objektivave parësore:

- Objektivi 1, kontribuon në zhvillimin dhe rregullimin strukturor të rajoneve me zhvillim të prapambetur të cilët kanë një PKB për frymë më të vogël se 75% e mesatares së Komunitetit.
- Objektivi 2, mbështet shndërrimin ekonomik dhe social të zonave me probleme strukturore, si ato zona që kalojnë ndryshime ekonomike, zona rurale në rënie dhe zona që mbështeten në peshkim, zona me probleme urbane, si dhe zona gjeografike me probleme serioze natyrore apo demografike.

- Objektivi 3, mbështet rregullimin dhe modernizimin e politikave dhe sistemeve të arsimit, trajnimit dhe punësimit për rajonet që nuk përfshihen nga rajonet e Objektivit 1.

Gjithashtu, u hartuan edhe katër iniciativa të Komunitetit për të provuar forma të reja zhvillimi për vështirësi të veçanta. Ato do të marrin 5.53% të shpërndarjes për Fondet Strukturore:

- *Interreg III* - ka si qëllim inkurajimin e bashkëpunimit ndërkufitar, ndërkombëtar dhe ndërrajonal
- *Leader+* - kërkon të nxisë zhvillimin social-ekonomik në zonat rurale
- *Equal* - parashikon zhvillimin e praktikave të reja për të luftuar diskriminimin dhe pabarazinë e çdo lloji në drejtim të tregut të punës
- *Urban II* - inkurajon ripërtëritjen ekonomike dhe sociale të qyteteve dhe rrethinave jo shumë të zhvilluara.

Në vitin 1993, një Fond Kohezioni u ngrit për të përforcuar më tej politikën strukturore. Ai ka si synim vendet me një PKB për frymë më të vogël se 90% e mesatares së Komunitetit, që përfshin Greqinë, Spanjën, Irlandën dhe Portugalinë. Qëllimi i Fondit të Kohezionit është të financojë projekte për mjedisin dhe infrastrukturën e transportit.

Globalizim i ekonomisë. Fenomeni i globalizimit ekonomik u identifikua nga Këshilli European i Torinos si një nga sfidat më të mëdha që ka hasur Bashkimi European në fund të shekullit 20. Termi ka të bëjë me procesin e rritjes së integrimit ekonomik në mbarë botën dhe forcat shtytëse kryesore pas tij janë:

- Liberalizimi i tregtisë ndërkombëtare dhe lëvizjet e kapitalit
- Përshpejtimi i progresit teknologjik dhe fillimi i shoqërisë së informacionit
- Moszbatimi i rregullores

Këto tri faktorë theksojnë njëri-tjetrin. Kështu, progresi teknologjik nxit tregtinë ndërkombëtare dhe modelet botërore të tregtisë mundësojnë shpërndarjen më efektive të progresit teknologjik. Në të njëjtën kohë, moszbatimi i rregullores nxit zhvillimin e formave të reja të teknologjisë dhe ndihmon në heqjen e barrierave të tregtisë. Disa studiues i vënë fajin progresit teknologjik për të bërë të mundur që bizneset dhe individët të gjejnë një mënyrë më të lehtë për rregulloret kombëtare.

Gjykata Europiane e Llogarive. Gjykata Europiane e Llogarive në Luksemburg përbëhet nga 15 anëtarë të emëruar për 6 vjet me vendim unanim të Këshillit të Bashkimit European pas këshillimit me Parlamentin European. Kjo Gjykatë kontrollon të ardhurat dhe shpenzimet e Bashkimit European nga ana ligjore dhe rregullsisë, si dhe siguron që menaxhimi financiar të jetë i efektshëm. U krijua në 1977 dhe statusin e plotë institucional e fitoi me Traktatin e Bashkimit European të vitit 1992.

Sipas Traktatit të Amsterdimit (të miratuar në qershor 1997), Gjykata e Llogarive ka kompetenca t'i raportojë Parlamentit European e Këshillit parregullsitë. Përgjegjësitë kontrolluese të Gjykatës janë shtrirë në fondet komunitare që menaxhohen nga organet e jashtme dhe nga Banka Europiane e Investimeve.

Traktati i Nisës (i miratuar në dhjetor 2000) përcakton me hollësi përbërjen e Gjykatës Europiane të Llogarive, e cila duhet të përfshijë një shtetas nga secili Shtet Anëtar. Gjithashtu sipas Traktatit të Nisës, Gjykata Europiane e Llogarive mund të ngrejë dhoma të brendshme për miratimin e kategorive të caktuara të raporteve apo të opinioneve.

Gjykata e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane. Gjykata e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane u krijua në vitin 1989 për të forcuar mbrojtjen e interesave individuale me prezantimin e një shkalle të dytë të autoritetit gjyqësor gjë që e lejon Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit European të përqendrohet në detyrat kryesore për sigurimin e interpretimit standard dhe zbatimin e së drejtës komunitare.

Gjykata e Shkallës së Parë përbëhet nga 15 gjyqtarë të emëruar me marrëveshje të përbashkët nga qeveritë e Shteteve Anëtare për një mandat të dytë 6 vjeçar. Duhet pasur kujdes që në përgjigje të një kërkesë të paraqitur nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European. Jashtë kuadrit të KNQ-së, Coreper ra dakord të rrisë në 21 numrin e gjyqtarëve për Gjykatën e Shkallës së Parë. Rregullimet në lidhje me sistemin e rotacionit për emërime mbeten akoma për t'u vendosur.

Traktati i Nisës prezantoi fleksibilitet më të madh për marrjen e statusit të Gjykatës së Shkallës së Parë që mund të ndryshohet nga Këshilli me unanimitet me kërkesë të Gjykatës ose të Komisionit. Miratimi i rregullave të procedurës së Gjykatës së Drejtësisë dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë në të ardhmen do të bëhet me shumicë të cilësuar.

Për të lehtësuar punën e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European, Traktati i Nisës synon të përmirësojë ndarjen e përgjegjësisë ndërmjet saj dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, duke e bërë këtë të fundit një gjykatë të zakonshme për të gjitha paditë e drejtpërdrejta (padi kundër një vendimi, padi për mosveprim, dëmshpërblime etj.), me përjashtim të çështjeve të caktuara për një panel gjyqësor dhe të çështjeve të përcaktuara për Gjykatën e Drejtësisë të Bashkimit European. Bazuar në të drejtën e iniciativës që ndahet ndërmjet Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European dhe Komisionit, Traktati i ri parashikon krijimin e

paneleve gjyqësore për shqyrtimin në shkallë të parë të disa masave në çështje specifike, me qëllim lehtësimin e punës së Gjykatës së Shkallës së Parë. Përfundimisht, Traktati i Nisës i jep Gjykatës së Shkallës së Parë të drejtën për të dhënë një vendim paraprak në disa fusha specifike.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian. Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian përbëhet nga aq gjyqtarë sa ka dhe Shtete Anëtare. Për momentin ka 15 gjyqtarë që ndihmohen nga 8 avokatë të përgjithshëm të emëruar për 6 vjet me marrëveshje midis Shteteve Anëtare.

Ajo mund të mbledhet në dhoma ose seanca plenare për çështje të një rëndësie të veçantë ose për çështje të ndërlikuara dhe me kërkesë të një Shteti Anëtar.

Dy funksionet bazë janë:

- Të kontrollojë nëse dokumentat e institucioneve europiane dhe të qeverive janë në pajtueshmëri me Traktatet.
- Të prononcohet me kërkesë të një gjykate kombëtare për interpretimin ose vlefshmërinë e dispozitave që përmban e drejta komunitare.

Gjykata ndihmohet nga Gjykata e Shkallës së Parë e krijuar në vitin 1989.

Traktati i Nisës reformoi sistemin e gjykatave të Bashkimit Europian. Përsa i takon Gjykatës Europiane të Drejtësisë, çështjet më të rëndësishme janë:

- Fleksibilitet më i madh për të marrë statusin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Europian i cili tani mund të ndryshohet nga Këshilli me unanimitet dhe me kërkesën e Gjykatës ose të Komisionit.
- Miratimi i rregullave të procedurës së gjykatës nga Këshilli tani bëhet me shumicë të cilësuar.
- Një nen i ri 229a i Traktatit të Komunitetit Europian, i cili i jep gjykatës juridiksion në konfliktet që lidhen me të drejtat e pronës industriale në komunitete me vendim unanim nga Këshilli dhe pas ratifikimit nga parlamentet kombëtare.
- Një ndarje më të mirë të kompetencave ndërmjet Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian duke e lehtësuar këtë të fundit nga garkesa e punës.

- H -

Hierarkia e akteve komunitare (hierarkia e normave). Një deklaratë e shtuar në Traktatin e Bashkimit Europian pohon që "mund të jetë i mundshëm rishikimi i klasifikimit të akteve komunitare me synim krijimin e një hierarkie të duhur ndërmjet kategorive të ndryshme të aktit".

Qëllimi kryesor i kësaj hierarkie është që autoriteti legjislativ të përqendrohet në aspektet e politikave të çështjeve të veçanta dhe jo në çështje hollësish. Kjo hierarki do të diktojë formën e procesit vendimmarrës të Komunitetit duke siguruar që instrumentet me status kushtetues të kalojnë në procedura më të kufizuara (si miratimi i votimit unanim, shumicë e cilësuar dhe pëlqim) sesa aktet legjislative që kalojnë nën procedura më pak fleksibël (psh. procedura e vendimmarrjes së përbashkët), madje edhe sesa aktet zbatuese (psh. delegimi i institucionalizuar i kompetencave tek Komisioni).

Subjekti, në diskutimet e para në vitin 1999, u përqendrua në mundësinë e përfshirjes së procedurës së vendimmarrjes së përbashkët në Traktat. Ideja e theksuar ishte shmangia e një procedure tepër të rreptë që zbatohet për disa akte të një rëndësie dytësore dhe në këtë mënyrë parandalon bllokimin e procesit legjislativ. Në 1991, gjatë negociatave për Traktatin e Amsterdami, Komisioni propozoi prezantimin e një hierarkie normash dhe të një sistemi të ri për klasifikimin e dokumenteve të Komunitetit (traktate, ligje, akte dytësore dhe zbatuese), por nuk arriti të kapërcejë problemet e ngritura nga tradita të ndryshme kombëtare ligjore. Kjo çështje është ngritur përsëri në Konventën Europiane në Dhjetor 2001, me detyrën për të hartuar një Kushtetutë për Europën që do të formonte majën e piramidës së akteve komunitare.

Identiteti European i mbrojtjes dhe sigurisë. Ideja për zhvillimin e një identiteti european të mbrojtjes është nxitur nga dy konsiderata.

Për disa vite Europa është përballur me shfaqjen e disa burimeve të destabilitetit në gjysmën lindore të kontinentit, si në Bosnjë-Hercegovinë apo Kosovë.

Shtetet e Bashkuara kanë ridimensionuar gradualisht angazhimin e tyre në lidhje me mbrojtjen europiane duke krijuar një boshllëk që Europa nuk ka ditur të mbushë. Vitet e fundit kanë shërbyer për të theksuar kufizimet e një aleance (NATO) që përcaktohet në marrëdhënie me një kërcënim të jashtëm. Në të njëjtën kohë, ekziston një kuptim gjithnjë e në rritje i nevojës për një njësi politike të motivuar nga ndërgjegjësimi i interesave të përbashkëta për të përballuar sfidat e reja të sigurisë në Europë.

Në këtë kontekst, Këshilli i NATO-s, i mbajtur në Bruksel në janar 1994, njohu rëndësinë e përcaktimit të një identiteti european në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen. Hapat e para u hodhën në Këshillin e NATO-s në Berlin më 3 qershor 1996 me zhvillimin e konceptit të Grupeve të Përbashkëta Konsultative të Kombinuara, ku ministrat e aleancës u regjistruan në samitin e janarit 1994 si një mënyrë për të përdorur kapacitetet ushtarake të NATO-s në veprimet e drejtuara nga Bashkimi European Perëndimor nën kontrollin e tij politik dhe menaxhimin strategjik.

Që atëherë Bashkimi European ka krijuar strukturat e veta të përhershme politike dhe ushtarake për kontrollin politik dhe menaxhimin strategjik të krizave. Në dhjetor 2002, brenda kuadrit të marrëveshjeve të përhershme për bashkëpunim dhe këshillim Bashkim European - NATO të njohura si "Berlin Plus", u nënshkrua një marrëveshje strategjike partneriteti për menaxhimin e krizave. Me anë të kësaj marrëveshjeje, Bashkimi European me efekt të drejtpërdrejtë do të ketë të drejtën për të përdorur burimet logjistike dhe planifikuese të NATO-s, përfshirë informacionin. Prandaj, Bashkimi European do të përdorë këto burime për të zbatuar veprimet paqeruajtëse dhe do të krijojë një forcë të reagimit të shpejtë të përbërë nga 60000 trupa.

Instrumentet ligjore komunitare. Termi instrumente ligjore komunitare ka të bëjë me instrumentet që disponohen nga institucionet e Komunitetit për të kryer detyrat e tyre sipas Traktatit themelues të Komunitetit European duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit. Ato janë:

- Rregulloret - janë të detyrueshme në tërësinë e tyre dhe drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare
- Direktivat - janë të detyrueshme për Shtetet Anëtare vetëm në rezultatin që duhet arritur. Ato duhet të transpozohen në kuadrin ligjor kombëtar duke i lënë kështu vetë Shtetit Anëtar zgjedhjen e teknikës për formën dhe mjetet e zbatimit
- Vendimet - janë të detyrueshme në tërësinë e tyre për të gjithë
- Rekomandimet dhe mendimet nuk janë të detyrueshme, por janë instrumente deklaruese.

Karta e të Drejtave Themelore. Në vijim të përvjetorit të 50-të të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut në dhjetor 1998, Këshilli Europian i Këlnit (3-4 qershor 1999) filloi punën për hartimin e një karte të të drejtave themelore. Qëllimi i kësaj karte ishte që të drejtat themelore në nivel të Bashkimit Europian të konsolidoheshin në një dokument të vetëm për të sensibilizuar më shumë opinionin publik. Karta bazohet në Traktatet Komunitare, konventat ndërkombëtare, si Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (1950) dhe Karta Sociale Europiane (1989), tradita kushtetuese e njëjtë për shtetet anëtare, si edhe deklarata të ndryshme të Parlamentit Europian.

Puna ju besua një organi të veçantë – i vetëquajtur Konventë – që përbëhej nga 62 anëtarë, përfshirë përfaqësuesit e qeverive të shteteve anëtare, Presidentin e Komisionit Europian, anëtarët e Parlamentit Europian dhe parlamenteve kombëtare. Katër përfaqësues nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian, Këshilli i Europës dhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, morën pjesë si vëzhgues. Përbërja, metodat e punës dhe marrëveshjet praktike të Konventës u miratuan në Këshillin Europian të Tampères (15-16 tetor 1999).

Puna filloi në 17 dhjetor 1999. Komiteti Ekonomik dhe Social, Komiteti i Rajoneve, Ombudsmani (Avokati i Popullit), vendet aplikante dhe ndonjë organ tjetër, grup social apo ekspert u ftuan të parashtronjë pikëpamjet e veta. Qëllimi ishte të arrihej konsensus. Rezultati i punës u paraqit në Këshillin Europian të Biarritz (13-14 tetor 2000). Në 7 kapituj të ndarë në 54 nene, Karta përcakton të drejtat themelore në lidhje me dinjitetin, lirinë, barazinë, solidaritetin, shtetësinë dhe drejtësinë. Kjo kartë u prezantua në Këshillin Europian të Nisës (7-10 dhjetor 2000).

Në Konferencën Ndërqeveritare (KNQ) që përfundoi në Këshillin Europian të Nisës nuk mund të arrihej marrëveshje për përfshirjen e Kartës në traktate prandaj u bë ligjërishit e detyrueshme. Megjithatë, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian deklaroi që dëshironte ta përdorte Kartën si udhëzues në marrjen e vendimeve. Këshilli Europian i Laeken-it i dha Konventës Europiane një mandat për të shqyrtuar çështjen e përfshirjes së Kartës në traktatet ekzistuese.

Karta sociale. Të gjitha Shtetet Anëtare, me përjashtim të Mbretërisë së Bashkuar në vitin 1989 miratuan Kartën e të Drejtave Themelore Sociale të Punëtorëve, e njohur si Karta Sociale në formën e një deklarate. Karta Sociale konsiderohet si një instrument që përmban "detyrimet morale", objekti i së cilës është të garantojë respektimin e të drejtave sociale të caktuara në vendet përkatëse. Në radhë të parë këto lidhen me tregun e punës, formimin profesional, mundësitë e barabarta dhe mjedisin e punës. Karta përmban gjithashtu një kërkesë të qartë drejtuar Komisionit për të përfshirë përkthimin e përmbajtjes së Kartës Sociale në legjislacion. Kjo Kartë është pasuar nga programe të veprimeve sociale.

Kërkim dhe zhvillim. Politika europiane për kërkim dhe zhvillim bazohet në dispozitat e tre traktateve themelore (Komuniteti European i Qymyrit dhe Çelikut, Euratom dhe Titulli XVIII i Traktatit të Komunitetit European). Akti Unik European futi konceptin e teknologjisë në të drejtën komunitare dhe më pas Traktati European i zhvillim objektivave të Komunitetit në këtë fushë. Përparësitë e Komunitetit janë mbështetja e konkurrencës në industrinë europiane dhe nxitja e kërkimeve me qëllim përballimin e sfidave teknologjike.

Bashkërendimi i nismave në fushën e kërkimeve dhe zhvillimit brenda Komunitetit bazohet në instrumenta të ndryshme:

- Programi kuadër për kërkime dhe zhvillim në fushën e teknologjisë. Ky program shumëvjeçar, i ngritur në vitin 1984, bashkërendon programe më të veçanta për fusha po aq të ndryshme sa edhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, mjedisit, biologjisë, energjisë (përfshirë edhe atë nukleare), transportit dhe lëvizjes së kërkuesve. Programi kuadër i pestë (1998-2002) ka shpërndarë më shumë se 14.9 miliard euro për të arritur objektivat e tij, përfshirë inkurajimin e shoqërisë së informacionit lehtësisht të përdorshme dhe e drejta e bizneseve të vogla për kërkime.
- Qendra e Kërkimeve të Përbashkëta dhe Agjensia Euratom e Furnizimit. Qendra e Kërkimeve të Përbashkëta përbëhet nga tetë institute kërkimore të ngritura në Komunitetin European për përmbushjen e nevojave të veçanta të Komisionit. Është pararoja e kërkimeve në energjinë nukleare (veçanërisht siguria) dhe është ndarë në sektorë si materialet, mjedisi dhe rreziqet industriale.
- Bashkëpunimi european në fushën shkencore dhe në kërkimet teknike (COST), i cili u krijua në vitin 1971, mbulon 25 vende: pesëmbëdhjetë Shtetet Anëtare të Bashkimit European plus Islandën, Norvegjinë, Zvicrën, Kroacinë, Republikën Çeke, Hungarinë, Poloninë, Sllovakinë, Slloveninë dhe Turqinë. Qëllimi i këtij programi të bashkëpunimit European është të bashkërendojë përparësitë e kërkimeve kombëtare në Europë.
- Eureka është një organizatë ndërqeveritare me 26 vende përfshirë edhe Shtetet Anëtare të Bashkimit European, Rusinë, Zvicrën dhe Turqinë. Ajo u ngrit në vitin 1985 dhe ka për qëllim të mbështesë partneritetin ndërmjet bizneseve dhe institucioneve kërkimore, veçanërisht në sektorët e teknologjisë së avancuar.

Programi shumëvjeçar është miratuar me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdami nuk kërkohet më unanimiteti në Këshill. Programet e veçanta miratohen gjithnjë nga Këshilli me shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit, pas këshillimit me Parlamentin European dhe me Komitetin Ekonomik dhe Social.

Këshilli European. Këshilli European është termi i përdorur për të përshkruar takimet e rregullta të krerëve të shteteve ose qeverisë së Shteteve Anëtare të Bashkimit European. Këshilli European u krijua nga komunikatat e lëshuara në dhjetor 1974 në Takimin e Nivelit të Lartë në Paris dhe u mbledh për herë të parë në 1975 (në

Dublin 10-11 mars). Përpara kësaj kohe, nga 1961-1974, ka ekzistuar praktika e konferencave europiane të nivelit të lartë. Ekzistenca e Këshillit European u njoh ligjërisht me Aktin Unik European, ndërsa statusi zyrtar iu dha në Traktatin e Bashkimit European. Këshilli European mbledhet të paktën dy herë në vit dhe Presidenti i Komisionit European merr pjesë si anëtar me të drejta të plota. Qëllimet e tij janë t'i japë Bashkimit European nxitjen që duhet për të zhvilluar më tej dhe për të përcaktuar udhëzimet e përgjithshme të politikës.

Këshilli i Bashkimit European. Këshilli i Bashkimit European (Këshilli disa herë nënkupton Këshillin e Ministrave) është institucioni kryesor vendimmarrës i Bashkimit. Përbëhet nga ministrat e 15 Shteteve Anëtare që janë përgjegjës për fushën e veprimtarisë në axhendë: punë të jashtme, bujqësi, industri, transport apo çfarëdo qoftë. Pavarësisht nga ekzistenca e këtyre konfigurimeve të ndryshme në varësi të fushës së veprimtarisë, Këshilli mbetet një institucion i vetëm.

Çdo Shtet Anëtar drejton për një periudhë 6 mujore. Vendimet përgatiten nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm të Shteteve Anëtare (Coreper) që ndihmohet nga grupet e punës së zyrtarëve të lartë. Këshilli ndihmohet nga Sekretariati i Përgjithshëm. Vendimet e Këshillit në shtyllën e dytë miratohen në bazë të propozimeve të Komisionit.

Në maj 1999, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, Sekretari i Përgjithshëm funksionon si Përfaqësues i Lartë për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ai ndihmohet edhe nga zëvendës sekretari i përgjithshëm që emërohet me unanimet nga Këshilli dhe mban përgjegjësi për Sekretariatit e Përgjithshëm të Këshillit.

Në këndvështrim të zgjerimit, Traktati i Nisës e shtriu qëllimin e vendimeve të miratuara me shumicë të cilësuar në fusha të tjera dhe aspekte të ndryshme të politikave që pjesërisht kërkojnë shumicë të cilësuar, si për shembull Politika e Përbashkët Tregtare.

Klasifikim i shpenzimeve. Ka të bëjë me dallimin që bëhet ndërmjet shpenzimeve të Bashkimit European nga të cilat parimi bazë dhe shuma përcaktohen ligjërisht nga marrëveshjet, legjislacioni dytësor, konventat, traktatet ndërkombëtare apo kontratat private (shpenzime "të detyrueshme") dhe shpenzimeve për të cilat autoriteti buxhetor është i lirë të vendosë shumën si t'i duket e arsyeshme (shpenzime "jo të detyrueshme"). Çështja nëse shpenzimi duhet të konsiderohet apo jo i detyrueshëm, shkakton ndarje ndërmjet dy anëve të autoritetit buxhetor, Këshillit dhe Parlamentit European, pasi Parlamenti ka fjalën e fundit në përcaktimin e shumës së shpenzimeve vetëm kur këto nuk janë të detyrueshme. Meqë shpenzimet bujqësore konsiderohen të detyrueshme, rezultati është që më shumë se 45% e buxhetit të Komunitetit është jashtë kontrollit të Parlamentit.

Klauzola e mospjesëmarrjes (Opting out). Mospjesëmarrja është një përjashtim që i ofrohet një vendi që nuk dëshiron të bashkohet me Shtetet e tjera Anëtare

në një fushë të caktuar bashkëpunimi, si një mënyrë për të shmangur një bllokim të përgjithshëm. Për shembull, Mbretëria e Bashkuar kërkoi të mos merrte pjesë në fazën e tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar dhe për nene të tjera të ngjashme u ra dakort edhe me Danimarkën përsa i takon BEM, mbrojtjes dhe qytetarisë europiane.

Klauzola e pezullimit. Traktati i Amsterdimit i shtoi Traktatit të Bashkimit European klauzolën e pezullimit (neni 7). Sipas kësaj klauzole, disa nga të drejtat e një Shteti Anëtar (p.sh.të drejtat e votimit në Këshill) mund të pezullohen në qoftë se ky shtet ka shkelur në mënyrë të vazhdueshme parimet mbi të cilat është themeluar Bashkimi European (liria, demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe liritë themelore, si edhe shtetin e së drejtës). Megjithatë, detyrimet e tij do të jenë sërish detyruese.

Traktati i Nisës i shtoi një mekanizëm parandalues kësaj procedure. Me një propozim të një të tretës të Shteteve Anëtare, nga ana e Komisionit apo e Parlamentit European, Këshilli, me shumicë prej katër të pestat e anëtarëve të tij pas marrjes së pëlajimit të Parlamentit European, përcakton nëse ekziston një rrezik i dukshëm i shkeljeve të rënda të këtyre parimeve themelore nga ana e një Shteti Anëtar dhe jep rekomandimet e duhura për të.

Kodifikimi i legjisllacionit (formal/zyrtar). Kodifikimi i legjisllacionit (formal/zyrtar) ka të bëjë me miratimin e një akti të ri ligjor, botuar në Fletoren Zyrtare (Seria L), i cili përfshin dhe shfuqizon aktet e kodifikuara (akti bazë+akt i ndryshuar), pa e ndryshuar përmbajtjen e tyre. Kodifikimi mund të jetë:

- *Vertikal*- akti i ri përfshin aktin bazë dhe aktet që e ndryshojnë në një akt të vetëm;
- *Horizontal*- akti i ri përfshin disa akte bazë paralele dhe ndryshimet e tyre, në lidhje me të njëjtën çështje në një akt të vetëm.

Kohezioni ekonomik dhe social. Në nivel european, origjina e politikës së kohezionit ekonomik dhe social i përket Traktatit të Romës (1957) ku bëhet një referencë në parathënie për të reduktuar ndryshimet rajonale. Në 1970, u ndërmorr veprimi i Komunitetit për të bashkërenduar instrumentat rajonale dhe për të siguruar burimet shtesë financiare. Rrjedhimisht, këto masa rezultuan të papërshtatshme për situatën në Komunitet, ku, ndryshe nga parashikimet, krijimi i tregut të brendshëm ka dështuar në pakësimin e mosmarrëveshjeve ndërmjet rajoneve.

Me miratimin e Aktit Unik European në 1986, kohezioni ekonomik dhe social u bë qëllim së bashku me përfundimin e tregut të vetëm.

Më në fund, Traktati i Mastroiitit e përfshiu këtë politikë në vetë Traktat (neni 158-162). Kohezioni ekonomik dhe social është shprehje e solidaritetit ndërmjet Shteteve Anëtare dhe rajoneve të Bashkimit European. Qëllimi i këtij kohezioni

është zhvillimi i ekuilibruar në Bashkimin Europian, duke pakësuar ndryshimet strukturore ndërmjet rajoneve dhe duke nxitur mundësi të barabarta për të gjithë individët. Në terma praktike, kjo arrihet me një larmi veprimesh financiare, fillimisht përmes Fondeve Strukturore dhe Fondit të Kohezionit.

Përveç reformës së Politikës së Përbashkët Bujqësore dhe zgjerimit me Vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, politika rajonale ishte një nga çështjet kryesore të diskutuara në Axhendën 2000, kryesisht për shkak të implikimeve financiare. Politika rajonale është zëri buxhetor më i madh i Komunitetit me një shumë prej 213 miliard eurosh për periudhën 2000-2006. Çdo tre vjet, Komisioni Europian paraqet një raport për progresin e arritur në lidhje me kohezionin ekonomik dhe social dhe mënyrën se si politikat e Komunitetit kanë ndihmuar për këtë progres. Kriteret kryesore për analizën janë PBB, punësimi dhe faktorët e nxitjes së zhvillimit të qëndrueshëm.

Zgjerimi i Bashkimit Europian në maj 2004 do të përfshijë një rënie mesatarisht 13% të PBB-së dhe një shtrirje të ndryshimeve rajonale në shkallë të paparë në ndonjë zgjerim të mëparshëm. Meqë 60% e rajoneve, zhvillimi i të cilave ka mbetur prapa, janë në Shtetet Anëtare, politika ekonomike dhe sociale do të zhvendoset drejt lindjes. Pas vitit 2006, kjo politikë do të përqendrohet në problemet e zhvillimit të rëndësishëm, ndërkohë do të vazhdojë të përkrahë rajonet që nuk e kanë përfunduar procesin e konvergencës në shifra konkrete (veçanërisht Spanja, Greqia dhe Protugalia) dhe në zona gjeografike që kanë probleme strukturore (zona që kërkojnë ristrukturim industrial, zona urbane, zona rurale, zona që varen nga peshkimi dhe zona që vuajnë nga mangësitë natyrore apo demografike). Thjeshtimi i mekanizmave të transferimit dhe të menaxhimit të fondeve strukturore do të jetë motoja e reformave të ardhshme.

Komisioni Europian. Komisioni Europian është organi me kompetencën e iniciativës, zbatimit, menaxhimit dhe kontrollit. Komisioni është mbrojtësi i Traktateve dhe mishërimi i interesave të Komunitetit. Përbëhet nga 20 anëtarë të pavarur (dy nga Franca, Gjermani, Italia, Spanja dhe MB dhe një nga të gjitha vendet e tjera), ku përfshihet Presidenti dhe Zv/presidentët. Komisioni Europian emërohet për mandat 5 vjeçar nga Këshilli me shumicë të cilësuar në marrëveshje me Shtetet Anëtare dhe pas pëlqimit të Parlamentit Europian para të cilit jep llogari. Komisionerët ndihmohen nga një administratë e përbërë nga drejtori të përgjithshme dhe departamente të specializuara, stafi i të cilëve ndodhet në Bruksel dhe në Luksemburg.

Komisioni i ri, që filloi punën në 23 janar 2000 për një mandat 5 vjeçar, filloi reformat në institucion me synim modernizimin e metodave të punës e procedurave, si dhe sigurimin e një procesi vendimmarrjeje (politika rajonale, PBB, tregu i brendshëm). Rëndësia që Komisioni i jep reformave pasqyrohet në Librin e Bardhë të miratuar në 1 mars 2000. Kjo reformë ka tri drejtime kryesore:

- Caktimin e prioriteteve dhe akordimin e burimeve
- Rinovimin e politikës së burimeve njerëzore
- Përmirësimin në menaxhimin financiar, efektivitetin dhe autorizimin.

Komisione parlamentare. Brenda Parlamentit janë ngritur disa komisione për të organizuar punën e tij. Anëtarët e çdo komisioni zgjidhen në fillim të çdo mandati parlamentar ose në mes, sipas përkatësisë së tyre politike dhe ekspertizës së tyre.

Rregullat e Procedurës së Parlamentit përcaktojnë që anëtarët e Parlamentit të caktojnë numrin e komiseve dhe përcaktojnë kompetencat e tyre.

Momentalisht ekzistojnë 17 komisione të përkohshme të specializuara ku diskutohen propozimet e Komisionit. Parlamenti mund të krijojë edhe nën komisione, komisione të përkohshme dhe komisione hetimore nëse shihet e nevojshme. Deri tani janë ngritur dy komisione hetimore (një për procedurat kalimtare të Komunitetit në 1996 dhe një për epideminë encefalopati poroze të gjedhëve (BSE) në 1997).

Detyra kryesore e komiseve të përhershme është të debatojnë propozimet për legjislacionin e ri të parashtruar nga Komisioni Europian dhe të hartojë raporte me iniciativën e vet. Një relator emërohet për çdo propozim për legjislacionin apo iniciativë tjetër sipas një marrëveshjeje ndërmjet grupeve politike që përbëjnë Parlamentin. Raporti i relatorit diskutohet, ndryshohet dhe votohet brenda komisionit parlamentar, pastaj i transmetohet kuvendit plenar që mbledhet një herë në muaj në Strasburg dhe diskuton e voton në bazë të këtij raporti.

Në përgatitje të votës së miratimit të Parlamentit për Komisionin Europian, komisionet parlamentare dëgjojnë anëtarët e propozuar të Komisionit në fushat e tyre të specializimit.

Komitetet dhe grupet e punës. Komitetet që kanë për detyrë të ndihmojnë institucionet e Komunitetit përfshihen në të gjitha fazat e procesit legjislativ. Komisioni këshillohet rregullisht me ekspertët përpara se të hartojë një propozim të ri për legjislacionin. Këto komitete, të cilat përbëhen nga përfaqësues të shtresës së interesuar, ekspertë nga sektori privat ose qeveria, sigurojnë që Komisioni të jetë i hapur ndaj shqetësimeve të atyre që do të preken nga legjislacioni. Gjithsej janë 69 komitete këshillimi që mbulojnë të gjithë sektorët edhe pse gjysma e tyre merret me çështje bujqësore.

Në Parlamentin Europian disa komitete të përhershme organizojnë punën e deputetëve të Parlamentit Europian.

Këshilli ndihmohet nga komitetet dhe grupet e punës të cilat përgatisin vendimet e tij. Ekzistenca e disa komiteve parashikohet në traktate (p.sh. neni 36 "Komiteti për drejtësi dhe punë të brendshme") dhe të tjerat janë komitete *ad hoc*, si komiteti i çështjeve kulturore që vlerëson propozimet për bashkëpunim kulturor, përgatit diskutimet e Këshillit dhe vijon me masat e ndërmarra. Këto komitete përbëhen nga përfaqësues të Shteteve Anëtare plus një anëtar i Komisionit. Paralelisht disa grupe pune bëjnë punën përgatitore për *Coreper*, ndërsa disa prej tyre janë krijuar mbi një bazë të përkohshme për t'u marrë me një dosje të veçantë. Rreth 100 grupe mbulojnë një sektor të caktuar dhe takohen rregullisht.

Kur miratohet një tekst legjislativ, parashtron parimet e përgjithshme që duhet të respektohen. Masa më të sakta zbatuese mund të jenë të nevojshme për zbatimin e këtyre parimeve. Në këtë rast, teksti parashikon që një komitet të ngrihet brenda Komisionit me qëllim që të merret vendimi i duhur. Këto komitete përbëhen nga ekspertë të emëruar nga Shtetet Anëtare, drejtohen nga Komisioni dhe përgjithësisht qeverisen nga rregulla të përcaktuara me Vendimin e Këshillit që njihet, si "Vendimi për Komitologjinë". Ka rreth 300 të emëruar në fushat e industrisë, çështjeve të brendshme, bujqësisë, mjedisit, tregut të brendshëm, studimit dhe zhvillimit, mbrojtjes së konsumatorit dhe sigurisë ushqimore.

Komiteti European Ekonomik dhe Social. Komiteti European Ekonomik dhe Social u krijua me Traktatin themelues të Komunitetit European Ekonomik në 1957 për të përfaqësuar interesat e grupeve të ndryshme ekonomike dhe sociale. Përbëhet nga 222 anëtarë që ju përkasin tri kategorive: nëpunësve, punëtorëve dhe përfaqësuesve të llojeve të veprimtarive të veçanta (si fermerët, artizanët, bizneset e vogla dhe industria, profesionet, përfaqësuesit e konsumatorëve, shkencëtarët dhe mësuesit, kooperativistët, familjet, lëvizjet për mjedisin). Anëtarët emërohen me vendim unanim nga Këshilli me një mandat 4-vjeçar të ripërsëritshëm.

Komiteti European Ekonomik dhe Social këshillohet përpara se të miratohen shumë instrumenta që kanë të bëjnë me tregun e brendshëm, arsimin, mbrojtjen e konsumatorit, mjedisin, zhvillimin rajonal dhe çështjet sociale. Komiteti European Ekonomik dhe Social mund të japë dhe mendime me iniciativën e vet. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komiteti European Ekonomik dhe Social duhet të këshillohet për disa çështje (politikën e re të punësimit, legjisacionin e ri për punët sociale, shëndetin publik, mundësi të barabarta). Gjithashtu, Këshillimi i Komitetit European Ekonomik dhe Social mund të kërkohet nga vetë Parlamenti European.

Traktati i Nisës i miratuar në dhjetor 2000 nuk e ndryshoi numrin dhe shpërndarjen e vendeve të Shteteve Anëtare në Komitet. Megjithatë, e drejta për anëtarësi u qartësua: KEES përbëhet nga "përfaqësues të kategorive të ndryshme të veprimtarive ekonomike dhe shoqërore" (neni 257 i Traktatit të Komunitetit European)

Komiteti i Pajtimimit. Neni 251 (4) (ish neni 189b (4)) i Traktatit të Bashkimit European parashikon krijimin e një komiteti pajtimi si pjesë e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët ndërmjet Këshillit dhe Parlamentit. Ky Komitet përfshin anëtarët e Këshillit ose përfaqësuesit e tyre dhe një numër të njëjtë përfaqësuesish nga Parlamenti. Çdo mosmarrëveshje ndërmjet dy institucioneve si rezultat i procedurës së vendimmarrjes së përbashkët i drejtohet Komitetit me qëllim që të arrihet një marrëveshje për një tekst që do të pranohet nga të dy palët.

Drafti i çdo teksti të përbashkët duhet të miratohet brenda gjashtë javësh me shumicë të cilësuar në Këshill dhe me shumicë absolute në Parlament. Nëse njëri nga institucionet e refuzon propozimin, ky draft nuk miratohet.

Komiteti i Punësimit. I krijuar me Traktatin e Amsterdimit, Komiteti Këshillimor i Punësimit ka zëvendësuar Komitetin e Punësimit dhe Tregut të Punës të krijuar në 1996 (neni 130 i Traktatit të Komunitetit Europian)

I përbërë nga dy përfaqësues të secilit Shtet Anëtar dhe dy përfaqësues të Komisionit, detyra e Komitetit është të ndihmojë Këshillin me përgjegjësitë e tij në këto fusha.

Ky komitet monitoron politikat e punësimit dhe të tregut të punës së Shteteve Anëtare, nxit bashkëpunimin e tyre dhe jep mendime. Në kryerjen e detyrave të veta komiteti i punësimit këshillohet me partnerë socialë (menaxhim dhe punë).

Komiteti i Rajoneve (KR). I krijuar me Traktatin e Mاستrihtit në vitin 1992, Komiteti i Rajoneve përbëhet nga 222 përfaqësues të autoriteteve lokale dhe rajonale të emëruar nga Këshilli për katër vjet në bazë të propozimeve të Shteteve Anëtare. Ky Komitet konsultohet nga Këshilli, Parlamenti dhe Komisioni në fusha që prekin interesat lokale dhe rajonale, si arsimit, rinia, kultura, shëndetësia dhe kohezioni social dhe ekonomik.

Komiteti i Rajoneve mund të japë mendime edhe me iniciativën e vet.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit (maj 1999), Komiteti duhet të konsultohet për një gamë të gjerë fushash, si: mjedisi, fondi social, formimi profesional, bashkëpunimi ndër kufitar dhe transporti.

Traktati i Nisës (e miratuar në dhjetor 2000) nuk e ndryshoi numrin e shpërndarjes së vendeve nga Shteti Anëtar në Komitetin e Rajonit. Duke pasur parasysh zgjerimin, Traktati parashikon që në të ardhmen numri i anëtarëve të mos kalojë numrin 350. Për sa i takon të drejtës për t'u zgjedhur për anëtarësi, Traktati parashikon qartë që anëtarët duhet të kenë mandat zgjedhor të autoritetit lokal apo rajonal ose të jenë politikisht të zgjedhur për një asamble të zgjedhurish.

Komiteti Politik dhe i Sigurisë. Komiteti Politik dhe i Sigurisë zëvendëson Komitetin Politik, por ndjek zhvillimet ndërkombëtare në fushën e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS), ndihmon në përcaktimin e politikave dhe monitoron zbatimin e tyre. Nën autoritetin e Këshillit, ai është përgjegjës për kontrollin politik dhe drejtimin strategjik të operacioneve të menaxhimit të krizave. I përbërë kryesisht nga përfaqësues kombëtarë, Komiteti Politik dhe i Sigurisë është në thelb të veprimtarive të menaxhimit të krizave. Për të siguruar funksionimin e tij sa më të mirë, ai mbështetet nga Grupi Politik-Usharak, Komiteti për Aspektet Civile të Menaxhimit të Krizave, Komiteti Ushtarak (KU) dhe Stafi Ushtarak (SU).

Komitologji. Sipas Traktatit themelues të Komunitetit Europian, Komisioni zbaton legjislacionin në nivel komunitar (neni 202 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 145). Praktikisht, secili akt legjislativ përcakton qëllimin e kompetencave zbatuese që i janë dhënë Komisionit dhe mënyrën e përdorimit të këtyre

kompetencave. Ky instrument do të parashikojë vazhdimisht që Komisioni të ndihmohet nga një komitet në përputhje me procedurën që njihet si "komitologji".

Komitetet që janë forume diskutimi përbëhen nga përfaqësues të Shteteve Anëtare dhe drejtohen nga Komisioni. Ato mundësojnë dialogun me administratat kombëtare përpara miratimit të masave zbatuese. Komisioni siguron që të pasqyrohet situata në secilin rast në fjalë.

Procedurat që rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet Komisionit dhe Komiteteve bazohen në modele të përcaktuara në Vendimin e Këshillit (vendimi "i komitologjisë"). Vendimi i parë për "komitologjinë" është marrë në 13 korrik 1987. Me qëllim që të merren parasysh ndryshimet në Traktat, veçanërisht pozita e re e Parlamentit me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët, por edhe për t'ju përgjigjur kritikizmit që sistemi komunitar është shumë i ndërlikuar dhe i paqartë, vendimi i vitit 1987 është zëvendësuar nga vendimi i Këshillit i 28 qershorit 1999.

Vendimi i ri siguron që Parlamenti të mbikqyrë zbatimin e akteve legjislativ të miratuara me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët. Në rastet kur legjislativi bëhet nën këtë procedurë, Parlamenti mund të mos japë miratimin e masave të propozuara nga Komisioni ose në disa raste nga Këshilli, të cilat sipas mendimit të Parlamentit, i tejkalojnë kompetencat zbatuese të parashikuara në legjislativ.

Vendimi qartëson kriteret e zgjedhura nga komiteti që duhet të zbatohen dhe thjeshton procedurat e veprimit. Komitetet mbështetin opinionin e tyre në projektmasat zbatuese të përgatitura nga Komisioni. Komitetet mund të ndahen sipas kategorive të mëposhtme:

- **Komitetet e këshillimit**- japin mendime të cilat Komisioni duhet t'i marrë në konsideratë. Kjo procedurë e drejtpërdrejtë përdoret përgjithësisht kur çështjet në diskutim nuk janë shumë delikate politikisht.
- **Komitete e menaxhimit**- nëse masat e miratuara nga Komisioni nuk përputhen me mendimin e komitetit (që merret me shumicë të cilësuar), Komisioni duhet t'ia komunikojë ato Këshillit, i cili me shumicë të cilësuar mund të marrë një vendim tjetër. Kjo procedurë në veçanti përdoret për masat në lidhje me menaxhimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore, Politikës së Përbashkët të Peshkimit dhe me programet kryesore të komunitetit.
- **Komitetet rregullatore**- Komisioni mund të miratojë vetëm masat zbatuese nëse merr miratimin me shumicë të cilësuar nga takimi i Shteteve Anëtare brenda Komitetit. Në mungesë të një mbështetjeje të tillë, masa e propozuar i kthehet Këshillit që vendos me shumicë të cilësuar. Megjithatë, nëse Këshilli nuk merr një vendim, Komisioni miraton përfundimisht masën zbatuese me kusht që Këshilli të mos kundërshtojë me shumicë të cilësuar. Kjo procedurë përdoret për masat në lidhje me mbrojtjen e shëndetit ose sigurinë e personave, kafshëve dhe bimëve dhe për masat që ndryshojnë dispozitat jo themelore të akteve bazë legjislativ.

Parashikohen edhe kriteret të cilat, në varësi të çështjes që është në diskutim, do të udhëheqin autoritetin legjislativ për zgjedhjen e procedurës së Komitetit për

aktin legjislativ. Kjo synon lehtësimin e miratimit të legjislationit me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët.

Së fundmi, disa të reja në Vendimin e ri për "komitologjinë" rrisin transparencën e sistemit të komitetit në të mirë të Parlamentit dhe publikut: dokumentet e komitetit do të bien më lehtë në duart e qytetarit (rregullimet janë si ato të dokumentave të Komisionit). Dokumentet e komiteteve gjithmonë do të regjistrohen në një regjistër publik që do të vihet në dispozicion në vitin 2001. Me kompjuterizimin e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët qëllimi përfundimtar është publikimi në internet i teksteve të plota të dokumenteve që i dërgohen Parlamentit. Që nga viti 2000, Komisioni do të botojë një raport të përvitshëm që jep një përmbledhje të veprimtarive të Komitetit gjatë vitit të kaluar.

Kompetenca dytësore. Neni 308 i Traktatit të Komunitetit European (ish neni 235) pasqyron faktin që hartuesit e Traktatit të Romës kuptuan se kompetencat e ndara posaçërisht për Komunitetin (kompetencat ekzekutive) mund të mos jenë të përshtatshme për arritjen e objektivave të caktuara shprehimisht nga vetë Traktatet (kompetenca *ratione materiae*).

Ky nen mund të përdoret për të mbuluar atë hapësirë, pasi përcakton që "në rast se veprimi nga ana e Komunitetit është i nevojshëm për arritjen e njëres prej objektivave të Komunitetit dhe në rast se kompetencat e nevojshme nuk parashikohen nga ky traktat, Këshilli merr masat e duhura duke vepruar me unanimitet mbi bazën e një propozimi nga Komisioni dhe pas këshillimit me Parlamentin European."

Meqënëse kjo dispozitë i jep Parlamentit European një rol thjesht këshillimor, gjë që nuk merr parasysh kompetencat e tanishme legjislativ të Parlamentit, përdorimi i papërshtatshëm i kompetencave mund të dëmtojë ekuilibrin institucional. Për të shmangur këtë gjë, përdorimi i nenit 308 si një bazë ligjore shoqërohet nga nene të tjera të Traktatit të cilat i japin Parlamentit një rol më të madh legjislativ.

Kompetencat e Komunitetit. Kompetencat e Komunitetit janë kompetencat që i janë dhënë Komunitetit në disa fusha specifike. Komunitetet Europiane mund të veprojnë vetëm brenda kuadrit të Traktateve.

Ka tri lloje kompetencash të cilat varen nga mënyra e atribuimit:

- Kompetenca të qarta: janë përcaktuar qartë në traktate
- Kompetenca të nënkuptuara: kur Komuniteti European ka kompetenca të qarta në një fushë të veçantë (psh. transporti) si edhe kompetenca në të njëjtën fushë në lidhje me marrëdhëniet e jashtme (psh. negociata për marrëveshje ndërkombëtare)
- Kompetenca dytësore: kur Komuniteti European nuk ka kompetenca të qarta ose të nënkuptuara për të arritur një qëllim. Traktati në nenin 308 në lidhje me tregun e vetëm përcakton që Këshilli të marrë me unanimitet masat që i konsideron të nevojshme.

Kompromisi i Janinës. Kompromisi i Janinës e merr emrin nga një takim jo zyrtar i ministrave të jashtëm në qytetin grek të Janinës në 29 mars 1994. Mes vendimeve të marra, në takim u mor edhe një vendim i Këshillit në lidhje me çështjen specifike të votimit me shumicë të cilësuar në një Komunitet me 16 anëtarë. Më vonë vendimi u rregullua pas vendimit të Norvegjisë për të mos u bashkuar. Kompromisi përfundimtar parashikon që, nëse anëtarët e Këshillit që përfaqësojnë 23 vota dhe 26 vota (kufiri i ri) shpehin qëllimin e tyre për të kundërshtuar vendimmarrjen nga Këshilli me shumicë të cilësuar, Këshilli brenda kompetencave të tij dhe brenda një kohe të arsyeshme do të gjejë një zgjidhje të kënaqshme që mund të miratohet me 65 nga 87 vota.

Në vijim të ripeshimit të votave në Këshill të Ministrave, Traktati i Nisës i jep fund kompromisit të Janinës.

Kompromisi i Luksemburgut. Kompromisi i Luksemburgut i arritur në janar 1996 i dha fund krizës “karrigia bosh”, kur Franca në Korrik 1965refuzoi të zërë vendin e saj në Këshill. Kompromisi ishte një pranim i mosmarrëveshjes ndërmjet atyre të cilët, kur ishte në rrezik interesi kombëtar, donin që anëtarët e Këshillit të bënin të pamundurën brenda një kohe të arsyeshme për të gjetur zgjedhje që mund ta miratonin të gjitha palët, pa cënuar interesat e tyre reciproke. Madje, edhe Franca që ishte në favor të vazhdimit të diskutimeve derisa u arrit marrëveshje unanime. Rrjedhimisht, Shtete të tjera Anëtare u bashkuan me pikëpamjen franceze.

Kompromisi nuk e ka ndaluar Këshillin nga marrja e vendimeve në përputhje me Traktatin e Komunitetit Europian, i cili në shumë raste parashikon votimin me shumicë të cilësuar. Nuk i ka ndaluar as anëtarët nga përpjekjet e mëtejshme për të bashkuar pikëpamjet përpara se Këshilli të vendosë.

Komunitarizëm. Komunitarizëm do të thotë kalimi i një çështjeje e cila në kuadrin institucional të Bashkimit Europian trajtohet sipas mënyrës ndërqeveritare (shtylla e dytë dhe e tretë) tek metoda komunitare (shtylla e parë).

Metoda Komunitare mbështetet tek ideja që interesi i përgjithshëm i qytetarëve të Bashkimit Europian mbrohet më mirë kur institucionet e Komunitetit luajnë rol të plotë në procesin e vendimmarrjes së përbashkët duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit.

Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdamin, çështja që lidhet me lëvizjen e lirë të njerëzve, e cila më parë trajtohej nën bashkëpunimin për drejtësi dhe punë të brendshme (shtylla e tretë), është “komunitarizuar”. Prandaj, ajo do të trajtohet sipas metodës komunitare pas një faze tranzitore 5 vjeçare.

Konferenca Ndërqeveritare dypalëshe (Bashkim Europian-Vend aplikant).

Negociatat për aderimin e Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin Europian kanë formën e Konferencave Ndërqeveritare (KNQ) dypalëshe ndërmjet Bashkimit Europian dhe secilit nga vendet aplikante.

Konferencat Ndërqeveritare për aderimin e Republikës Çeke, Estonisë, Hungarisë, Polonisë, Sllovenisë dhe Qipros u hapën zyrtarisht në 30 mars 1998. Në 10 nëntor 1998 u mbajt takimi i parë në nivel ministror për të negociuar me këto 6 vende. Konferencat për aderimin e Bullgarisë, Letonisë, Lituanisë dhe Maltës filluan në 15 shkurt 2000.

Konferenca Europiane. Konferenca Europiane u krijua për të siguruar një kuadër për procesin e zgjerimit gjatë viteve të ardhshme duke bashkuar Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian me vendet europiane që shpresojnë të bashkohen. Konferenca Europiane është një forum shumëpalësh për këshillim politik në lidhje me çështjet me interes të përgjithshëm. Këtu përfshihet veçanërisht:

- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
- Drejtësia dhe punët e brendshme
- Çështjet ekonomike dhe bashkëpunimi rajonal.

Filloi me Këshillin Europian të Luksemburgut në dhjetor 1997 në vazhdimësi të një iniciative franceze në tetor 1997. Ajo mbledhet një herë në vit në nivel të krerëve të shtetit ose qeverisë dhe presidentit të Komisionit, dhe një herë në vit në nivel ministrash të jashtëm. Drejtohet nga vendi që ka Presidencën e Këshillit në Bashkimin Europian.

Konferenca Europiane për herë të parë u mbledh në Londër, më 12 mars 1998 dhe vendosi krijimin e një grupi të përbashkët ekspertësh që ka për detyrë raportimin e problemeve që shkakton krimi i organizuar për shoqërinë europiane, veçanërisht në Europën Lindore. Takimi i parë në nivel ministrash u mbajt në 6 tetor 1998, në Luksemburg.

Konferenca Ndërqeveritare (KNQ). Ky term përdoret për të përshkruar negociatat ndërmjet qeverive të Shteteve Anëtare me synim ndryshimin e Traktateve. KNQ-të luajnë një rol të rëndësishëm në intergimin europian pasi ndryshimet institucionale duhet të jenë gjithmonë rezultat i negociatave të tilla.

Këto konferenca mbledhen me nismën e Shteteve Anëtare ose të Komisionit nga Këshilli i Ministrave me shumicë të cilësuar (pas këshillimit me Parlamentin Europian dhe nëse duhet, edhe këshillimit me Komisionin).

Puna përgatitore i besohet një grupi prej përfaqësuesish të secilës qeveri të Shteteve Anëtare dhe si e do zakoni nga një përfaqësues i Komisionit. Parlamenti Europian përfshihet me anë të vëzhguesve dhe diskutimeve me Presidentin e Parlamentit. Ky grup raporton rregullisht tek Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme. Vendimet përfundimtare merren nga krerët e shteteve dhe qeverive në Këshillin Europian.

KNQ-të më të rëndësishme të viteve të fundit kanë përfunduar në traktatet e mëposhtme:

- Akti Unik Europian (1986) - prezantoi ndryshimet e nevojshme për të përfunduar tregun e brendshëm në 1 janar 1993.

- Traktati i Mاستrihtit (1992) - Traktati i Bashkimit European u negociua në dy KNQ të veçanta, një për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar dhe tjetra për bashkimin politik që përbën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe bashkëpunimin për drejtësinë dhe punët e brendshme.
- Traktati i Amsterdimit (1997)- është rezultat i KNQ që filloi në Këshillin European në Torino në Mars 1996. Detyra e Konferencës ishte rishikimi i dispozitave të Traktatit të Mاستrihtit, i cili ngriti probleme të zbatimit dhe përgatitjes për zgjerim në të ardhmen.

Meqë Traktati i Amsterdimit nuk prezantoi të gjithë reformën institucionale të nevojshme për të siguruar që institucionet do të funksionin me efektivitet pas zgjerimit, Këshilli European i Këlnit (3-4 Qershor 1999) vendosi që të mblidhej një KNQ e re në 2000 për të shqyrtuar çështjet e pazgjidhura në Traktatin e Amsterdimit.

Këto ishin:

- Përmasa dhe përbërja e Komisionit;
- Peshimi i votave në Këshill;
- Shtrirja e votimit me shumicë të cilësuar në Këshill.

Në Qershor 2000, Këshilli European Santa Maria de Feira e shtriu fushën e KNQ-së për të përfshirë "bashkëpunimin më të ngushtë".

KNQ e re filloi në 15 shkurt 2000 pas këshillimit zyrtar të Komisionit dhe Parlamentit European. KNQ përfundoi në Këshillin European në Nisë (7-10 dhjetor 2000) dhe i dha shtysë Traktatit me të njëjtin emër që u nënshkrua në 26 shkurt 2001.

Traktatit të Nisës iu shtua një deklaratë për të ardhmen e Bashkimit European dhe i referohet KNQ-së që do të mbahej në 2004 pas një debati të gjerë publik dhe pas përgatitjes për reformë institucionale nga një konventë. Konventa u krijua nga Këshilli European i Laeken-it në dhjetor 2001 dhe në qershor 2003 raportoi mbi punën e kryer si pikënisje për negociatat e KNQ-së.

Konfirmimi i Komisionit European. Traktati i Mاستrihtit dhe Traktati i Amsterdimit rishikojnë procedurën e emërimit të Komisionit me prezantimin e një procedure konfirmimi.

Procedura përfshin dy faza: Kandidati për president Komisioni emërohet me marrëveshje të përbashkët nga qeveritë e Shteteve Anëtare. Kandidati i tyre miratohet nga Parlamenti European. Shtetet Anëtare emërojnë anëtarët pas këshillimit me Presidentin e caktuar. Më pas, i gjithë Komisioni i nënshtrohet një votimi për miratim nga Parlamenti European pas seancave individuale dëgjimore në komisionet e dhura parlamentare dhe më në fund emërohet në takimin e përfaqësuesve të qeverive të Shteteve Anëtare në Këshill.

Traktati i Nisës, që hyri në fuqi në 1 shkurt 2003, prezantoi ndryshime të mëtejshme për procedurën e emërimit të Komisionit.

Kjo procedurë vazhdon të ketë dy faza, e para lidhet me Presidentin dhe e dyta me Komisionin si një i tërë, por roli i Këshillit European është rritur ndjeshëm.

Tani përgjegjësia për emërimin e Presidentit bie mbi Këshillin European me shumicë të cilësuar dhe pas miratimit të Parlamentit. Këshilli me shumicë të cilësuar dhe me marrëveshje të përbashkët me kandidatin për president miraton listën e personave të tjerë që synon të emërojë anëtarë të Komisionit. Lista hartohet në përputhje me propozimet e Shteteve Anëtare dhe Presidenti e shikon përpara se të miratojë emrat e propozuar.

Në fund, Presidenti dhe anëtarët e Komisionit emërohen nga Këshilli me shumicë të cilësuar pasi të gjithë komisionerët janë miratuar nga Parlamenti.

Konkurrenca. Rregullat e konkurrencës sigurojnë që Zona Ekonomike Europiane e bazuar në forcat e tregut të funksionojë me sukses. Politika e Komunitetit European për konkurrencën (neni 81-89 i Traktatit të Komunitetit European, ish-nenet 85-94) bazohet në pesë parime kryesore:

- Ndalimi i marrëveshjeve ndërmjet ndërmarrjeve, vendimet e shoqërizimit ndërmjet ndërmarrjeve si edhe praktikave të përqendruara, të cilat janë të tilla që mund të çenojnë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare ose që kanë për objekt ose pasojë pengimin, kufizimin, shtrembërimin e konkurrencës brenda tregut të përbashkët
- Ndalimi i çdo abuzimi nga ana e një ose disa ndërmarrjeve i pozicioneve të tyre dominuese në tregun e përbashkët për aq sa mund të çenojë tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare
- Mbikëqyrja e ndihmës së dhënë në çdo lloj forme nga Shtetet Anëtare ose nëpërmjet burimeve shtetërore të tilla që shtrembërojnë, apo kërcënojnë konkurrencën me anë të favorizimit të disa ndërmarrjeve ose të disa prodhimeve
- Mbikëqyrja parandaluese e shkrirjeve me dimension european duke miratuar ose ndaluar aleancat e parashikuara
- Liberalizimi i disa sektorëve ku ndërmarrjet shtetërore apo private janë zhvilluar në formë monopoli, si telekomunikacioni, transporti, ose energjia.

Megjithatë dy parimet e para mund të jenë subjekt shmangejeje sidomos kur një marrëveshje ndërmjet ndërmarrjeve përmirëson prodhimin, shpërndarjen e prodhimeve ose nxit progresin teknik. Skemat e ndihmës së shtetit, subvencionet sociale, ose subvencionet për nxitjen e kulturës dhe ruajtjen e trashëgimisë janë shembuj të përjashtimeve të mundshme për zbatimin korrekt të rregullave të konkurrencës.

Vështirësia për të ndjekur një politikë efektive për konkurrencën qëndron në faktin që Komuniteti vazhdimisht mund të organizojë qëllime të cilat janë shpesh në kundërshtim me njëra-tjetrën, pasi duhet të sigurojë që:

- kërkesa për konkurrencë të përsosur në tregun e brendshëm nuk i bën bizneset europiane më pak konkurruese në tregun botëror

- përpjekja për të liberalizuar nuk kërcënon plotësimin e nevojave bazë nga shërbimi publik.

Konkurrueshmëria. Libri i Bardhë i Komisionit Europian i vitit 1994 për Rritjen, Konkurrueshmërinë dhe Punësimin përmban udhëzime për një politikë konkurrueshmërie. Politika përfshin katër qëllime të cilat nuk kanë ndryshuar me kalimin e viteve. Qëllimet e politikës janë:

- Të ndihmojë kompanitë europiane të përshtaten me situatën e re të globalizuar dhe të pavarur konkurrese
- Të shfrytëzojë avantazhet konkurrese të shoqëruara me ndryshimin gradual në një ekonomi të bazuar në njohuri
- Të nxisë një zhvillim të qëndrueshëm të industrisë
- Të ulë afatin kohor ndërmjet ritmit të ndryshimit për ofertën dhe ndryshimeve të ndërsjellta për kërkesën.

Titulli i ri për punësimin i përfshirë në Traktatin e Komunitetit Europian nga Traktati i Amsterdimit merr parasysh qëllimet e Librit të Bardhë.

Konsolidim i legjislacionit –informal/deklarues. Ekziston një procedurë e veçantë për konsolidimin jo zyrtar dhe krejt deklarues të legjislacionit dhe thjeshtimit të akteve ligjore. Përfshirja e ndryshimeve të njëpasnjëshme në tërësinë e një akti bazë nuk e përfshin miratimin e një akti të ri. Në këtë rast bëhet fjalë thjesht për një sqarim nga Komisioni. Teksti përfundimtar që nuk ka fuqi ligjore mund të botohet në Fletoren Zyrtare (Seria C) pa citime.

Kontrolli paraprak. Në maj 1995, në Librin e Bardhë përgatitor për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore për integrim në tregun e vetëm të Bashkimit është hartuar një tabelë e legjislacionit të Komunitetit, të cilën ata duhet ta përfshijnë në legjislacionin e tyre përpara se të hyjnë në Bashkimin Europian.

Në prill 1998, nën dritën e *acquis communautaire* filloi analiza e legjislacionit të vendeve aplikante, përveç Turqisë. Faza e parë kishte të bënte me vlerësimin e pajtueshmërisë së legjislacionit të secilit vend me rregullat e Komunitetit. Ky proces i vlerësimit paraprak u krye në bashkëpunim me Komisionin dhe secilin vend aplikant. Sektor më sektor u hartua një hartë për secilin vend aplikant duke treguar se cilat instrumente ligjore duhen miratuar ose ndryshuar në mënyrë që anëtarët e ardhshëm të mund të aderojnë në legjislacionin e Komunitetit sa më shpejt të jetë e mundur pas hyrjes në Bashkimin Europian. Zyra e Shkëmbimit të Informacionit për ndihmën teknike (TAIEX) kreu një vëzhgim të *acquis communautaire* dhe të masave të marra nga vendet aplikante me qëllim përfshirjen në legjislacionin e tyre.

Kontrolli paraprak ishte thelbësor sepse shërbeu si bazë për negociatën dypalëshe ndërmjet Bashkimit Europian dhe secilit vend aplikant.

Konventa (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian). Bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme (Kreu VI i Traktatit të Bashkimit Europian) u prezantua me Traktatin e Mاستrihtit në 1993. Ky bashkëpunim parashikon dokumente specifike si konventat. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdami, konventat mund të përdoren për bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështjet penale dhe tani drejtohen nga rregulla të reja.

Mbështetur në nenin e ri 34 të Traktatit të Bashkimit Europian, një konventë miratohet me vendim unanim të Këshillit, pasi ky i fundit është këshilluar me Parlamentin Europian dhe pastaj ratifikohet nga Shtetet Anëtare në përputhje me procedurat përkatëse kushtetuese. Pas ratifikimit nga gjysma e Shteteve Anëtare, konventa hyn në fuqi në ato vende.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian ka juridiksion të japë vendime paraprake për interpretimin e konventave dhe të zgjidhë mosmarrëveshjet në lidhje me zbatimin e tyre. Megjithatë, roli i saj duhet të miratohet nga Shtetet Anëtare. Secili Shtet Anëtar duhet të bëjë një deklaratë me anë të së cilës pranon juridiksionin e Gjykatës dhe autorizon gjykatat kombëtare t'i drejtojnë çështje Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Konventa Europiane. Në dhjetor 2000, në Këshillin Europian të Nisës, u miratua një deklaratë për të ardhmen e Bashkimit Europian, Deklarata e Nisës. Qëllimi i kësaj deklarate ishte ndjekja e reformës institucionale përtej rezultateve të KNQ 2000. Ajo përcaktoi tri hapa për këtë reformë:

- 1- fillimin e një debati për të ardhmen e Bashkimit,
- 2- një konventë për reformën institucionale, për zbatimin e së cilës u ra dakord në Këshillin Europian në Laeken në dhjetor 2001
- 3- më në fund mbledhja e një KNQ në 2004.

Qëllimi i kësaj Konvente është të shqyrtojë 4 çështje kryesore për të ardhmen e Bashkimit:

- 1- ndarjen e kompetencave,
- 2- thjeshtimin e traktateve,
- 3- rolin e parlamenteve kombëtare
- 4- statusin e kartës së të drejtave themelore.

Takimi i parë i Konventës u mbajt në 28 shkurt 2002 dhe sipas deklaratës Laeken puna e saj përfundon në mars 2003.

Në Konventë u parashikuan tri faza: një fazë dëgjimore, një fazë diskutimi dhe një fazë propozimi. Në fund të fazës së propozimit do të hartohet një tekst i vetëm kushtetues. Ky tekst mund të përfshijë mundësi të ndryshme për përkrahjen që i është dhënë secilit, apo rekomandime nëse është arritur një konsensus. Konventa do të shërbejë si një pikënisje për negociatat e KNQ të drejtuara nga krerët e shtetit dhe qeverisë të cilët janë përgjegjës për çdo vendim për

ndryshimin e traktateve. Planifikohet që ky projekt kushtetues të paraqitet në qershor 2003 në Këshillin European të Selanikut.

Konventa është një risi për aq kohë sa KNQ të mëparshme nuk janë paraprirë më përpara nga faza e debatit të hapur për të gjithë të interesuarit. Përveç anëtarëve të Konventës, organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë me anë të një forumi interaktiv "Forum i mbi të ardhmen e Europës".

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut e nënshkruar në Romë nën drejtimin e Këshillit të Europës në 4 nëntor 1950 vendosi një sistem të paprecedent të mbrojtjes ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke ju ofruar individëve mundësinë që t'u drejtohen gjykatave për përforcimin e të drejtave të tyre. Konventa, që është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit European, krijoi disa organe mbikqyrjeje në Strasburg. Ato janë:

- Komisioni përgjegjës për shqyrtim të avancuar të aplikimeve nga shtetet ose nga individët
- Gjykata Europiane e të drejtave të njeriut tek e cila dërgoheshin çështje nga Komisioni ose nga Shtetet Anëtare në vijim të një raporti nga Komisioni (në rastin e një vendimi gjyqësor)
- Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës, i cili funksionon si ruajtës i KEDNJ, të cilit i drejtohej një çështje që nuk çohet para gjykatës për të siguruar zbutje politike të mosmarrëveshjeve.

Numri gjithnjë e në rritje i çështjeve e bëri të nevojshme reformën e marrëveshjeve mbikqyrëse të krijuara nga Konventa (shtesë e Protokollit 11). Në 1 nëntor 1998, organet mbikqyrëse u zëvendësuan nga një Gjykatë Europiane e të Drejtave të Njeriut. Struktura e thjeshtuar e shkurtoi kohëzgjatjen e procedurave dhe rriti karakterin gjyqësor të sistemit.

Është hedhur shpesh ideja që Bashkimi European të përfshihet në KEDNJ. Megjithatë, në një opinion dhënë më 28 mars 1996, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit European përcaktoi që Komunitetet Europiane nuk mund të përfshihen tek Konventa, sepse Traktati i Komunitetit European nuk parashikon kompetenca për të parashuar rregulla apo për të përfunduar marrëveshje ndërkombëtare në lidhje me të drejtat e njeriut. Për momentin, aderimi varet nga Traktati që do të ndryshohet.

Megjithatë, Traktati i Amsterdimit kërkon respektimin e të drejtave themelore të garantuara nga Konventa, ndërsa formalizon vendimet e Gjykatës së Drejtësisë për këtë çështje. Në lidhje me marrëdhëniet ndërmjet dy gjykatave, praktika e zhvilluar nga Gjykata e Drejtësisë për të përfshirë parimet e Konventës në të drejtën e Bashkimit European ka mundur koherencën në punën dhe pavarësinë e tyre.

Kriteret e konvergencës. Traktati specifikon pesë kriteret e konvergencës të cilat duhet të plotësohen nga secili Shtet Anëtar për të siguruar konvergencë të

qëndrueshme për arritjen e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (BEM) përpara pjesëmarrjes në fazën e tretë të BEM. Komisioni dhe Banka Qendrore Europiane hartojnë raporte për të kontrolluar nëse plotësohen kriteret. Këto kritere janë:

- Raporti i deficitit të qeverisë me PBB nuk duhet të kalojë 3%
- Raporti i borxhit të qeverisë me PBB nuk duhet të kalojë 60%
- Duhet të ekzistojë një nivel i qëndrueshëm i çmimeve të tregut si edhe një normë mesatare e inflacionit, një vit përpara shqyrtimit, normë e cila nuk duhet të kalojë me më shumë se 1.5% normën e tri Shteteve Anëtare që kanë ecurinë më të mirë të stabilitetit të çmimeve
- Duhet të ekzistojë një normë afatgjatë interesi që nuk e kalon me më shumë se 2% normën e Shteteve Anëtare që kanë ecurinë më të mirë të stabilitetit të çmimeve
- Kufijtë normal të luhatjes të parashikuara nga mekanizmi i kursit valutor në sistemin monetar europian duhet të respektohen pa tensione të ashpra të paktën për dy vitet e para përpara shqyrtimit.

Kriteret e konvergencës synojnë të sigurojnë që zhvillimi ekonomik brenda BEM të jetë i ekuilibruar dhe të mos krijojë tensioneve ndërmjet Shteteve Anëtare. Duhet pasur parasysh edhe që kriteret në lidhje me deficitin dhe borxhin e qeverisë duhet të plotësohen pas fillimit të fazës së tretë të BEM (1 janar 1999). Me këtë synim, në qershor 1997 në Këshillin Europian të Amsterdami, u nënshkrua një pakt stabiliteti.

Kritere të pranimit (Kriteret e Kopenhagenit). Në qershor 1993, Këshilli Europian i Kopenhagenit, u njohu vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore të drejtën për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian pasi të plotësonin tri kritere:

- Kriteri politik: institucione të qëndrueshme që garantojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut dhe respektimin e minoriteteve
- Kriteri ekonomik: ekonomi funksionale tregu
- Përafrim i legjislationit vendas me *acquis communautaire*: njëjtësim me qëllimet politike, ekonomike dhe monetare të Bashkimit Europian.

Këto kritere për aderim u konfirmuan në dhjetor 1995 në Këshillin Europian të Madridit, në të cilin u theksua edhe rëndësia për të ndërmarrë strukturat administrative të vendeve aplikante për në Bashkimin Europian, me qëllim që të krijohen kushtet për një integrim gradual dhe të harmonizuar.

Megjithatë, Bashkimi Europian ka të drejtë të vendosë se kur do të jetë gati për të pranuar anëtarë të rinj.

Kuadër i vetëm institucional. Kuadri i vetëm institucional është shprehja e zakonshme e parimit se ekziston vetëm një grup institucionesh. Ai parashikon që

Shtetet Anëtare, të cilat duan të integrohen dhe të bashkëpunojnë akoma më tej duhet të bien dakort të veprojnë përmes institucioneve të përbashkëta. Gjithashtu ky kuadër u kërkon Shteteve të tjera Anëtare të cilat nuk janë pjesëmarrëse të pranojnë që institucionet e përbashkëta mund të përdoren për veprime të tilla për të mbajtur më të bashkuar Bashkimin European pa përfshirjen e të gjitha Shteteve Anëtare.

Kufizim i kompetencave. Kufizimi i kompetencave ndërmjet Bashkimit European dhe Shteteve Anëtare është një nga çështjet kryesore e identifikuar nga Deklarata Laeken dhe nga Deklarata mbi të ardhmen e Bashkimit e shtuar në Traktatin e Nisës. Qëllimi i këtij kufizimi është shpërndarja e qartë dhe e saktë e kompetencave të Bashkimit European në respektim të parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit ndërsa plotësohen brenda mundësive dëshirat e qytetarëve europianë. Sistemi për monitorimin e pajtueshmërisë me këtë kufizim duhet të forcohet. Në këtë mënyrë bëhet identifikimi më i mirë i kompetencave të Komunitetit, kompetencave rajonale apo lokale.

Po merret parasysh ideja e një kreu të veçantë për kompetencat në një traktat të ardhshëm kushtetues. Bëhet fjalë nëse është e nevojshme të hartohet një listë e gjatë e kompetencave të Bashkimit European duke bërë një dallim të saktë ndërmjet kompetencave ekskluzive, të ndara dhe plotësuese. Në çdo rast, ky kufizim nuk duhet të pengojë fleksibilitetin e përcaktuar në nenin 308 të Traktatit të Komunitetit European.

Kultura. Edhe pse dëshira për të zhvilluar veprimtari kulturore në nivel european ishte e dukshme në fillim të viteve 70', kulturës iu dha vend zyrtarisht në integrimin european vetëm në vitin 1991 me anë të nenit 151 të Traktatit të Mاستrihtit ku thuhet se: "Komuniteti do të kontribuojë në zhvillimin e plotë të kulturave të Shteteve Anëtare, duke respektuar karakteristikat e tyre kombëtare dhe rajonale dhe në të njëjtën kohë duke vënë në dukje trashëgiminë e përbashkët kulturore".

Për të krijuar një fushë kulturore europiane, Bashkimi European është thirrur për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet Shteteve Anëtare dhe, nëse është e nevojshme, për të përkrahur dhe për të harmonizuar veprimtaritë e tyre në fushat e mëposhtme:

- Shpërndarja e kulturës dhe historisë së popujve europianë
- Konservimi i trashëgimisë kulturore me rëndësi europiane
- Shkëmbime kulturore jotregtare
- Krijimtari artistike, letrare dhe shërbime audiovizive
- Bashkëpunim me vendet e treta dhe organizatat përgjegjëse ndërkombëtare.

Komisioni për dhjetë vjet përkrahu bashkëpunimin kulturor përmes tre programeve eksperimentale në këtë sektor, duke mbuluar artet pamore, plastike dhe skenike, trashëgiminë dhe librat (Kaléidoscope, Ariane and Raphaël).

Komuniteti Europian ka përkrahur edhe nismën e Shteteve Anëtare për të zgjedhur çdo vit "Qytetin Europian të Kulturës" që nga viti 1985.

Në vitin 2000, Komisioni miratoi programin kuadër Kultura 2000, një orientim i ri për veprimtari kulturore. Qëllimi i këtij programi është krijimi i një hapësire të përbashkët kulturore duke nxitur dialogun kulturor, krijimin dhe shpërndarjen e kulturës dhe lëvizjen e artistëve dhe veprave të tyre, trashëgiminë kulturore europiane, format e reja të shprehjes kulturore dhe rolin social-ekonomike të kulturës.

Bashkëpunimi kulturor në Europë nxitet edhe nga veprimtari specifike të financuara nga programe të tjera europiane, ndryshe nga Kultura 2000; në veçanti, veprimtari që kryhen në kontekst të politikave të ndihmës së zhvillimit rajonal, ekonomik, kërkimit, arsimit, kualifikimit të cilat nxisin gjithashtu bashkëpunimin kulturor. Ky bashkëpunim është shpjeguar mbi një bazë të gjerë pasi shumica e programeve janë të hapura për Shtetet Anëtare të Zonës Ekonomike Europiane dhe vendeve candidate, por janë përfshirë edhe vende të treta dhe organizata ndërkombëtare.

- L -

Lëvizja e lirë e personave (politika e vizave, azilit, emigracionit dhe të tjera).

Traktati i Amsterdimit ka shtuar një titull të ri IV në Traktatin e Komunitetit Europian që mbulon fushat e mëposhtme:

- lëvizjen e lirë të personave
- kontrole në kufijtë e jashtëm
- azilin, emigracionin, dhe mbrojtjen e të drejtave të shtetasve të vendeve të treta
- bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale.

Këto fusha dikur ishin në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit Europian (Drejhtësia dhe punët e brendshme), por tani Traktati i Amsterdimit i ka "komunitarizuar", me fjalë të tjera i ka përfshirë në kuadrin ligjor të Parlamentit Europian. Gjatë një periudhe kalimtare 5-vjeçare pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.

- Komisioni ndan të drejtën e iniciativës me Shtetet Anëtare
- Këshilli vendos me unanimitet (me përjashtim të disa rregullave të veçanta për vizat) pas këshillimit me Parlamentin Europian
- Këshilli ka juridiksion në përputhje me rregullat e Traktatit të Komunitetit Europian (përveç disa përjashtimeve në nenin 62, pika 1).

Pas kësaj periudhe 5-vjeçare:

- Vetëm Komisioni do të ketë të drejtën e iniciativës
- Këshilli do të vendosë me unanimitet pas këshillimit me Parlamentin Europian për zbatimin e votimit me shumicë të cilësuar dhe procedurës së vendimmarrjes së përbashkët
- Megjithatë, kalimi në votimin me shumicë të cilësuar dhe në procedurën e vendimmarrjes së përbashkët do të bëhet automatik (me votë unanime nga Këshilli) për dhënien e vizave dhe për rregullat në lidhje me vizat.

Traktati i Nisës e ka shtrirë qëllimin e këtij kalimi automatik nga unanimitet në shumicë të cilësuar. Së pari, me hyrjen në fuqi të Traktatit të Nisës votimi me shumicë të cilësuar zbatohet për azilin dhe refugjatët (me kusht që legjislacioni i Komunitetit të miratohet), si edhe për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale me dimension mbarëkufitar, me përjashtim të aspekteve që përfshijnë të drejtën familjare. Së dyti, nga 1 maji 2004 votimi me shumicë të cilësuar do të zbatohet (në përputhje me periudhën kalimtare 5-vjeçare) për masat në lidhje me lëvizjen e lirë të shtetasve të vendeve jo anëtare në territorin e Shteteve Anëtare për një periudhë maksimale prej tri muajsh, emigracion të paligjshëm dhe bashkëpunim administrativ për lëvizjen e lirë të personave.

Sipas Traktatit të Amsterdimit, Britania e Madhe dhe Irlanda kanë përzgjedhur masat e ndërmarra nën Titullin IV. Danimarka do të marrë pjesë vetëm në masat që lidhen me vizat.

Libri i Bardhë. Libri i Bardhë i Komisionit është dokument që përmban propozime për veprim të Komunitetit në një fushë të veçantë. Në disa raste, ky libër është vijim i një Libri të Gjelbër, të publikuar për fillimin e një procesi këshillimi në nivel evropian. Shembujt përfshijnë Librin e Bardhë mbi tregun e brendshëm, rritjen ekonomike, konkurrencën dhe punësimin si dhe përafrimin e ligjeve të shteteve të asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore në fusha të lidhura me tregun e brendshëm. Në rast se Libri i Bardhë pranohet nga Këshilli, ai mund të kthehet në program veprimi për Bashkimin në fushën përkatëse.

Libri i Gjelbër. Libri i Gjelbër i Komisionit përfshin dokumentet që synojnë të nxisin debat dhe të nisin një proces këshillimi në nivel evropian për një çështje të caktuar (si politika sociale, monedha unike, telekomunikacionet). Këto këshillime mund të çojnë në publikimin e një Libri të Bardhë që shndërron përfundimet e debatit në propozime praktike për veprimin e Komunitetit.

Lufta kundër drogës. Lufta kundër drogës përfshin një fushë të gjerë veprimtarish, mes të cilave kryesore është lufta kundër toksimanisë dhe trafikut të paligjshëm. Baza specifike ligjore e Bashkimit Evropian varet nga masat e ndërmarra.

Parandalimi i toksimanisë përmendet në nenin 152 të Traktatit të Bashkimit Evropian (Shëndeti Publik-ish neni 129). Masat e ndërmarra nga Komuniteti në lidhje me këtë çështje përfshijnë një program të ri veprimi për 2003-2008.

Njësia Europol e Drogës është përgjegjëse për luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogës. Kjo Njësi përbëhet nga një njësi inteligjence për përmirësimin e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor ndërmjet Shteteve Anëtare. Njësia, në 1 tetor 1998, u bë pjesë e Zyrës Europiane të Policisë.

Traktati i Amsterdimit përcakton qartë luftën kundër trafikut të paligjshëm të drogës si një nga objektivat e Titullit të ri VI të Traktatit të Bashkimit Evropian (bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështje penale). Në 1999, Komisioni paraqiti një komunikatë mbi planin e veprimit të Bashkimit Evropian për të luftuar drogën (2000-04). Ky plan e bën luftën kundër drogës një nga prioritetet e brendshme dhe të jashtme të Bashkimit Evropian. Plani rekomandon të dhëna të vlefshme dhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në dhjetor 1999, Këshilli Evropian i Helsinkut miratoi strategjinë e Bashkimit Evropian për drogën mbështetur në komunikatën e Komisionit. Në qershor 2000, Këshilli Evropian i Feiras miratoi plan veprimin 2000-2004 për drogën, që e shndërron strategjinë në afërsisht 100 masa specifike që duhet të merren nga Shtetet Anëtare, Komisioni, Qendra Europiane e Monitorimit për Drogën dhe Toskimaninë dhe Europoli.

Lufta kundër krimit të organizuar. Fillimisht, përgjegjësia për të luftuar krimin ndërkombëtar ra mbi Njësinë Europol të Drogës që shkëmben informacion ndërmjet Shteteve Anëtare për të përmirësuar bashkëpunimin policor dhe gjyqësor. Në 1 Tetor 1998, Europol mori përsipër përgjegjësitë e Njësisë së Drogës, një strukturë e përkohshme që funksionoi në 1994 në pritje të hyrjes në fuqi të Konventës Europol.

Lufta kundër krimit ndërkombëtar ishte një nga fushat e përfshira në titullin e ri VI të Traktatit të Mاستrihtit. Kjo referencë e qartë mundësoi që Shtetet Anëtare të shkonin përtej shkëmbimit të thjeshtë të informacionit.

Në qershor 1997, në Këshillin European të Amsterdimit, vullneti politik i Shteteve Anëtare në luftën kundër krimit të organizuar, u përkthye në një program veprimi me përparësitë e Bashkimit European. Përveç kësaj, në 28 Maj 1998 me vendet kandidate u nënshkrua një pakt para-aderimi për krimin e organizuar.

Sipas Traktatit të Amsterdimit, një nga objektivat e Bashkimit është t'i sigurojë qytetarët e tij brenda zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Ky objektivi duhet të arrihet me anë të parandalimit të krimit dhe luftës kundër fenomeneve të ngjashme duke përfshirë terrorizmin, trafikun e qenieve njerëzore, krimet kundër fëmijëve, trafikun e drogës, trafikun e armëve, korrupsionin dhe mashtrimin.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, objektivat kryesore të luftës kundër krimit u përcaktuan në takimin e veçantë të Këshillit European në Tampere në Tetor 1999.

Traktati i Nisës siguroi një bazë për veprim dhe ngritjen e një njësie për prokurorë publikë, gjyqarë apo oficerë me kompetenca të njëjta (Eurojust).

Pas krijimit të Zyrës Europiane të Policisë (Europol), që filloi të funksionojë në qershor 1999, dhe pas krijimit të Njësisë Europiane për Bashkëpunimin në Gjyqësor (pas vendimit të 28 shkurtit 2002), Shtetet Anëtare kanë forcuar bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve të tyre të hetimit penal dhe autoriteteve gjyqësore për të luftuar krimin e organizuar me rezultate të kënaqshme.

Gjithashtu Bashkimi European merr pjesë në takimet e një sërë organizatash ndërkombëtare që përfshijë G8, OKB, OECD (Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim), Grupet Ndërkombëtare të Punës për veprimet financiare dhe Këshillin e Europës.

Lufta kundër mashtrimit. Lufta kundër mashtrimit dhe korrupsionit mbështetet në dy baza të veçanta ligjore, të dyja të ndryshuara me Traktatin e Amsterdimit.

- Neni 29 i Traktatit të Bashkimit European kërkon bashkëpunim më të ngushtë ndërmjet forcave policore, autoriteteve doganore dhe autoriteteve të tjera kompetente në Shtetet Anëtare, si drejtpërdrejt ashtu edhe përmes Europolit në këtë fushë
- Neni 280 i Traktatit të Komunitetit European ka të bëjë me veprimtaritë që prekin interesat financiare të Komunitetit. Këshilli dhe Parlamenti European kanë kompetencë të miratojnë masat nën procedurën e vendimmarrjes së përbashkët pas këshillimit me Gjykatën e Llogarive.

Konventa e nënshkruar në 26 Korrik 1995 sipas shtyllës së tretë të Traktatit të Bashkimit Europian për mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit hyri në fuqi në tetor 2000. Qëllimi i Konventës është të sigurojë dispozita në të drejtën penale të të gjithë Shteteve Anëtare për mashtrimin kundër interesave financiare të Komunitetit. Pas 1988, ky lloj mashtrimi u trajtua nga Grupi i Punës së Komisionit Europian për Parandalimin e Mashtrimit, i cili, në qershor 1999 u zëvendësua nga Zyra Europiane Kundër Mashtrimit.

Në orientimin e tij të përgjithshëm (qershor 2000), Komisioni përcaktoi një numër objektivash të politikës së përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e interesave financiare dhe luftën kundër mashtrimit gjatë periudhës 2001-2005. Në maj 2001, u miratua një plan veprimi për 2001-2003 që synonte realizimin e këtyre objektivave.

Komisioni, në Konferencën Ndërqeveritare në Nisë, për të forcuar veprimin e Komunitetit në luftën kundër mashtrimit, propozoi prezantimin e një bazë ligjore në Traktate për të përcaktuar një sistem rregullash në lidhje me procedurat mbi të drejtën penale për mashtrimin transnacional dhe për të parandaluar shkeljet që përfshijnë interesa financiare të Bashkimit.

Kjo bazë ligjore u pasua nga një Libër i Gjelbër (dhjetor 2001) për mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit dhe për caktimin e një Prokurori Europian.

Lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë. Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, brenda kuadrit të politikës sociale, janë marrë disa masa kundër racizmit dhe ksenofobisë. Për shembull, viti 1997 u shpall viti Europian kundër racizmit. Në mars 1998, Komisioni prezantoi një plan veprimi kundër racizmit për të konsoliduar atë që u arrit gjatë 1997 dhe për të përgatitur terrenin për hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit.

Me fillimin e Traktatit të Amsterdimit, neni 13-të i Traktatit themelues të Komunitetit Europian parashikon një bazë për të luftuar të gjitha format e diskriminimit në bazë të seksit, racës, origjinës etnike, fesë apo besimit, handicapit, moshës apo orientimit seksual. Në bazë të këtij neni, Këshilli në vitin 2000 miratoi një direktivë të rëndësishme në zbatim të parimit të trajtimit të njëjtë ndërmjet njerëzve pavarësisht nga origjina raciale apo etnike.

Përveç angazhimit për zbatimin e nenit 13, Bashkimi Europian ka bërë përpjekje për të integruar luftën kundër racizmit, ksenofobisë dhe të gjitha politikatat e saj:

- 1- Punësimi
- 2- Fondi Strukturor Europian
- 3- Arsimi, Formimi Profesional dhe Rinia.

Për më tepër, neni 29 i Traktatit të Bashkimit Europian, i shtuar me Traktatin e Amsterdimit, parashikon një bazë ligjore për luftën kundër racizmit dhe ksenofobisë në fushat e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale.

Qendra Europiane e Monitorimit për Racizmin dhe Ksenofobinë luan rol të rëndësishëm. E ngritur në Vienë në qershor 1997, detyra e saj kryesore është të mbikqyrë shkallën e racizmit dhe ksenofobisë brenda Bashkimit dhe zhvillimet në këtë fushë, të analizojë arsyet për këto fenomene dhe të hartojë propozime për prezantim në institucionet e Komunitetit dhe në Shtetet Anëtare. Qendra e Monitorimit mban përgjegjësi për ngritjen dhe bashkërendimin e një Rrjeti Informativ European për Racizmin dhe Ksenofobinë. Përveç kësaj, në 21 dhjetor 1998, u përfundua një marrëveshje ndërmjet Qendrës dhe Këshillit të Europës me qëllim që të rritej bashkëpunimi ndërmjet komitetit të mëparshëm dhe komitetit të Këshillit European për racizmin dhe intolerancën.

Lufta kundër terrorizmit. Bashkimi European ka për qëllim t'u japë aytetarëve të vet siguri brenda një zone lirie, sigurie dhe drejtësie. Traktati i Amsterdimit shtoi në nenin 29 të Traktatit të Bashkimit European një referencë specifike për terrorizmin si një krim të rëndë.

Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, Këshilli European, në një takim të jashtëzakonshëm në 21 shtator 2001, miratoi një plan veprim për forcimin e bashkëpunimit policor dhe gjyqësor, zhvillimin e instrumentave ligjore ndërkombëtare, ndalimin e financimit të terrorizmit, forcimin e sigurisë të trafikut ajror dhe pajtueshmëri më të madhe ndërmjet politikave të Bashkimit European. Në Këshillin European në Laeken në dhjetor 2001, u arrit një marrëveshje politike për dy vendime kuadër të lidhura ngushtë: njëri për luftën kundër terrorizmit (i miratuar në 13 qershor 2002) dhe tjetri për urdhër arrestin european (i miratuar në 13 qershor 2002).

Edhe pse sulmet e 11 shtatorit 2001 zbuluan qartë mangësinë e formave tradicionale të bashkëpunimit gjyqësor dhe policor dhe siguruan kështu stimulin për një sërë iniciativash, problemi i akteve të terrorizmit u ngrit në Këshillin European të Tamberes në 1999 dhe në Këshillin European në Santa Maria de Feira në 2000. Përveç kësaj, Bashkimi European mori një numër masash specifike në vitet e kaluara shumë përpara se të bëheshin sulmet

- Konventa Europol ka të bëjë me bashkëpunimin për parandalimin e terrorizmit dhe luftën kundër tij (Nëntor 1995)
- Veprimi i përbashkët i Këshillit për krijimin dhe mirëmbajtjen e një diretorie të kompetencave të specializuara kundër terrorizmit, aftësive dhe ekspertizës (tetor 1996)
- Veprimi i përbashkët i Këshillit për krijimin e një rrjeti european gjyqësor me kompetenca në lidhje me aktet terroriste (qershor 1998)
- Veprimi i përbashkët i Këshillit për të quajtur krim pjesëmarrjen në një organizatë kriminale në Shtetet Anëtare të Bashkimit European (dhjetor 1998)
- Vendimi i Këshillit që udhëzon Europolin të trajtojë krimet e kryera ose krimet do të kryhen në rrjedhën e veprimtarive terroriste (dhjetor 1998)
- Rekomandimi i Këshillit për bashkëpunim në luftën kundër financimit të grupeve terroriste

- Vendimi i Këshillit i 28 shkurtit 2002 që krijon Njësinë Europiane për Bashkëpunimin në Gjyqësor (në bazë të Traktatit të Nisës) me synim përforcimin e luftës kundër krimeve të rënda (duke përfshirë luftën kundër terrorizmit).

Të gjitha Shtetet Anëtare kanë nënshkruar një sërë konventash ndërkombëtare dhe protokolle për terrorizmin të hartuara me mbikqyrjen e OKB-së dhe të Këshillit të Europës si, p.sh. Konventa Europiane e Këshillit të Europës për shtypjen e terrorizmit (janar 1977)

- M -

Marrëveshja e Europës. Marrëveshja e Europës është një lloj i veçantë marrëveshjeje asociimi e përfunduar ndërmjet Bashkimit European dhe disa shteteve të Europës Qendrore dhe Lindore. Qëllimi i Marrëveshjes së Europës është përgatitja e shteteve të asociuara për aderim në Bashkimin European dhe bazohet në respektimin e të drejtave të njeriut, demokracisë, shtetit të së drejtës dhe ekonomisë së tregut. Marrëveshjet e Europës janë përfunduar me 10 vende: Bullgari, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovaki, Slloveni (Marrëveshja e Europës me Sllovenisë u nënshkrua në 10 qershor 1996, por nuk ka hyrë akoma në fuqi).

Marrëveshja e Europës përfundohet për një periudhë të pacaktuar dhe përbëhet nga një numër elementesh:

- Aspekti politik, parashikon këshillim dypalësh dhe shumëpalësh për çështje me interes të përbashkët
- Aspekti tregtar parashikon krijimin e një zonë të tregtisë së lirë
- Bashkëpunimi ekonomik, kulturor dhe financiar
- Përafrimi i legjislacionit, veçanërisht për pronësinë intelektuale dhe rregullat e konkurrencës.

Përsa i përket marrëveshjeve institucionale, menaxhimi i përgjithshëm i Marrëveshjes së Europës është përgjegjësi e Këshillit të Asociimit i përbërë nga përfaqësues të Këshillit dhe Komisionit nga njëra anë, dhe përfaqësues të qeverive të shteteve të asociuara në anën tjetër. Komiteti i Asociimit, i përbërë nga anëtarë të Këshillit të Asociimit, ndjek punën dhe përgatit diskutimet e Këshillit të Asociimit. Një Komitet Parlamentar Asociimi i përbërë nga anëtarë të Parlamentit European dhe nga parlamentet kombëtare të shteteve të asociuara, i bën rekomandime Këshillit të Asociimit.

Marrëveshja e Politikës Sociale. Marrëveshja e Politikës Sociale u nënshkrua nga katërbëdhjetë Shtete Anëtare në dhjetor 1991. Mbretëria e Bashkuar nuk mori pjesë. Kjo marrëveshje paraqet objektivat e politikës sociale qw janë nxitja e punësimit, përmirësimi i kushteve të jetesës dhe të punës, lufta kundër përjashtimit social, zhvillimi i burimeve njerëzore, etj. Rruga për këto objektiva u hap nga Karta Sociale në vitin 1989. Ajo përcakton gjithashtu edhe procedurën për miratimin e masave të politikës sociale dhe njeh pjesën më kryesore të luajtur nga menaxhimi dhe puna në këtë fushë.

Marrëveshja e nënshkruar iu shtua Protokollit mbi Politikën Sociale, një mekanizëm ky me anë të të cilit Mbretëria e Bashkuar i lejoi Shtetet e tjera Anëtare të ecnin përpara me politikën sociale pa pjesëmarrjen e saj.

Në vijim të zgjedhjeve të vitit 1997 për qeverinë e re, Mbretëria e Bashkuar lajmëroi se kishte ndërmend të hiqte dorë nga klauzola e mospjesëmarrjes.

Marrëveshja e Politikës Sociale u përfshi më pas në Kreun Social të Traktatit të Komunitetit Europian me anë të Traktatit të Amsterdimit. Gjithashtu, ajo përfshinte shfuqizimin zyrtar të Protokollit mbi Politikën Sociale.

Masa për të luftuar pastrimin e parave. Pastrimi i parave ka të bëjë me justifikimin e rremë të origjinës së pronës ose të të ardhurave me anë të një shkeljeje të së drejtës penale ose pjesëmarrjes në këtë veprim.

Për shkak të shkallës së problemit, lufta kundër pastrimit të parave tani është përparësi e Bashkimit Europian. Në përfundimet e Këshillit Europian të Tamperes në 15 dhe 16 Tetor 1999, krerët e shteteve dhe qeverisë shprehën dëshirën e tyre që pastrimi i parave "të zbulohet sa herë që ndodh".

Një sërë instrumentesh janë miratuar dhe dy më të rëndësishmet janë:

- direktiva e 10 qershorit 1991 për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për pastrim parash e ndryshuar nga Parlamenti dhe Këshilli në 4 dhjetor 2001;
- konventa e 29 majit 2000 për ndihmë reciproke në çështjet penale dhe protokollin i miratuar nga Këshilli më 16 tetor 2001.

Mbrojtja e konsumatorit. Mbrojtja e konsumatorit trajtohet në nenin 153 të Traktatit të Komunitetit Europian (ish neni 129a) i cili u shtua me Traktatin e Mastrohtit. Mbrojtja e konsumatorit ka për qëllim mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, sigurisë, interesave ligjore dhe ekonomike dhe të drejtën e tyre për t'u informuar.

Neni 153, i referohet qartë një baze ligjore për arritjen e objektivave, përkatësisht në nenin 98 (ish neni 100a) ku kërkohet procedura e vendimmarrjes së përbashkët për të gjitha masat që përfshijnë përaftrim më të ngushtë të legjislacionit të Shteteve Anëtare për arritjen e një tregu të vetëm ku trajtohet mbrojtja e konsumatorit. Në të njëjtën kohë, ky nen përcakton që të miratohen masa specifike, të cilat përkrahin dhe i shtohen politikës së ndjekur nga Shtetet Anëtare sipas procedurës së vendimmarrjes së përbashkët pas këshillimit me Komitetin Ekonomik dhe Social.

Një Shtet Anëtar mund të ruajë ose prezantojë masa më të rrepta për mbrojtjen e konsumatorit, sesa ato të parashtruara nga Komuniteti, për sa kohë që ato përputhen me Traktatin dhe Komisioni njoftohet rreth tyre.

Mbrojtja kolektive. Mbrojtja kolektive ka të bëjë me pjesëmarrjen në mbrojtjen e Europës sipas Traktatit të Brukselit (neni V) dhe të Uashingtonit (neni 5), që përcaktojnë se në rast sulmi, vendet nënshkruese duhet të sigurojnë ndihmë për vendosjen e sigurisë.

Që në vitin 1949, NATO ka qenë garantuesi kryesor i sigurisë në Europën Perëndimore, ndërsa Bashkimi Europian Perëndimor thjesht ka numëruar në vend

për pothuajse 30 vjet. Duhet pasur parasysh që Bashkimi Europian Perëndimor është e vetmja organizatë europiane që ka caktuar detyrimin automatik të mbrojtjes kolektive. Siguria europiane dhe mbrojtja e identitetit nuk ndikon në parimin se NATO vazhdon të jetë themeli i mbrojtjes kolektive të Europës.

Metoda komunitare dhe ndërqeveritare. Metoda komunitare është shprehje e përdorur për mënyrën institucionale të veprimit në shtyllën e parë të Bashkimit Europian. Kjo metodë vijon nga një logjikë integrimi duke pasur parasysh parimin e subsidiaritetit dhe ka tiparet dalluese të mëposhtme:

- monopol i Komisionit me të drejtën e iniciativës
- përdorim të gjerë të votimit me shumicë të cilësuar në Këshill
- rol aktiv të Parlamentit Europian
- interpretim standart të së drejtës komunitare nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian

Kjo metodë është në kundërshtim me metodën ndërqeveritare të veprimit që përdoret në shtyllën e dytë dhe të tretë, e cila shkon sipas një logjike ndërqeveritare. Ajo ka këto tipare dalluese:

- e drejta e iniciativës e Komisionit ndahet me Shtetet Anëtare ose kufizohet për disa fusha të veçanta të veprimtarisë
- Këshilli përgjithësisht vepron me unanimitet
- Parlamenti Europian ka një rol krejt këshillimor
- Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian nuk luan rol të rëndësishëm.

Mirëqenia e kafshëve. Çështja e mirëqenies së kafshëve u trajtua për herë të parë në një deklaratë bashkëngjitur Traktatit të Komunitetit Europian me rastin e KNQ mbi bashkimin politik në 1991-92.

Traktati i Amsterdimit në "Protokolli mbi mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve" parashtron rregulla të reja për masat e Bashkimit Europian në këtë drejtim. Ky protokoll pohon që kafshët janë qenie të ndjeshme dhe i detyron institucionet europiane t'u kushtojnë vëmendje të plotë kërkesave për mirëqenien e kafshëve kur formulojnë dhe zbatojnë politikatat e Komunitetit.

Legjislacioni komunitar në drejtim të mirëqenies së kafshëve synon të shpëtojë kafshët nga vuajtjet në tri fushat kryesore: mbartje, transport dhe therje. Politika të tjera të Komunitetit (bujqësia, transporti, tregu i brendshëm dhe kërkimet) duhet të marrin parasysh këtë nevojë si pjesë e një strategjie gjithëpërfshirëse të sigurisë ushqimore.

Në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse të Shteteve Anëtare, Zyra e Ushqimit dhe e Veterinarisë kryen kontrolle në vend për të siguruar pajtueshmëri me legjislacionin komunitar.

Mjedisi. Qëllimi i politikës së Komunitetit për mjedisin është jo vetëm ruajtja, mbrojtja dhe përmirësimi i cilësisë së mjedisit, por edhe mbrojtja e shëndetit të njeriut, përdorimi i matur dhe me kriter i burimeve natyrore. Së fundmi, synon të nxisë marrjen e masave në nivel ndërkombëtar për të përballuar probleme rajonale ose botërore të mjedisit. (neni 174, ish-nenin 130r i Traktatit të Komunitetit European)

Formulimi i politikës i nënshtrohet procedurës së vendimmarrjes së përbashkët në varësi të zonës. Për të arritur qëllimet, Këshilli:

- vendos me unanimet pas këshillimit me Parlamentin European, Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve kur është fjala për dispozita fiskale dhe dispozita në lidhje me urbanistikën, administrimin e burimeve njerëzore ose përdorimin e tokës (me përjashtim të administrimit të mbeturinave dhe të masave me karakter të përgjithshëm), ose kur zgjedhja e një Shteti Anëtar ndikon mjaft në çështjen e energjisë. (neni 175(2)).
- vendos sipas procedurës së vendimmarrjes së përbashkët pas këshillimit me Komitetin Ekonomik dhe Social dhe Komitetin e Rajoneve për miratimin e një program veprimi me karakter të përgjithshëm që përcakton objektivat parësore që duhet të arrihen.

Traktati i Amsterdimit e ka përfshirë konceptin e “zhvillimit të qëndrueshëm” si një nga objektivat e Bashkimit European, ndërsa kërkesat për mbrojtjen e mjedisit kanë fituar peshë më të madhe në politikat e tjera të Komunitetit, veçanërisht në kontekst të tregut të brendshëm (neni 2 dhe 6 i Traktatit të Bashkimit European).

Dispozitat që lejojnë një Shtet Anëtar të zbatojë rregulla më të rrepta sesa rregullat e harmonizuara janë bërë më të thjeshta. Këto rregulla të rrepta duhet të përputhen me Traktatin dhe duhet t’i komunikohen Komisionit.

Politika e mjedisit bazohet në parimin e marrjes së masave paraprake dhe parandaluese, dhe korrigjimin që në burim të dëmeve të shkaktuara në mjedis si edhe në parimin “kush ndot, paguan”.

Monitorimi i zbatimit të së drejtës komunitare. Detyra për monitorimin e zbatimit të së drejtës komunitare bie mbi Komisionin European si mbrojtësi i Traktateve. Bashkimi European bazohet në shtetin e së drejtës dhe qëllimi i tij është të sigurohet që ligji zbatohet në, dhe nga Shtetet Anëtare. Në ushtrimin e funksionit monitorues, Komisioni kujdeset të ruajë rolin që i është caktuar edhe autoriteteve kombëtare, në veçanti gjykatave në këtë fushë.

Monitorimi i zbatimit të së drejtës mund të marrë format e mëposhtme:

- fillimin e ndjekjeve për shkelje në vijim të ankesave ose kur rastet zbulohen në vazhdimësi të ngjarjeve
- padi kundër institucioneve të tjera
- kontrolli nëse ndihma e dhënë nga Shtetet Anëtare është e ligjshme

- kontrolli që të zbatohen parimet të cilat ndalojnë disa lloj marrëveshesh, vendimesh dhe praktikash të përqendruara, apo abuzim i një pozicioni dominant.

Raportet e përvitshme të Komisionit për zbatimin e së drejtës komunitare janë shprehje e dëshirës për transparencë në trajtimin jo vetëm të ankesave, por edhe të qytetarëve dhe anëtarëve të Parlamentit.

Mundësi të barabarta. Dy elemente kryesore të parimit të përgjithshëm të mundësive të barabarta janë ndalimi i diskriminimit mbi bazë shtetësie (neni 12 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 6) dhe pagë e njëjtë për burrat dhe gratë (neni 141 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 119). Mundësitë e barabarta zbatohen në të gjitha fushat veçanërisht ekonomike, sociale, kulturore dhe jetën familjare.

Traktati i Amsterdimit i shtoi një nen të ri 12 Traktatit që përforcon parimin e mosdiskriminimit të lidhur ngushtë me mundësitë e barabarta. Sipas këtij neni, Këshilli gëzon të drejtën të marrë masat e duhura për të luftuar diskriminimin mbi bazë gjinore, racore apo origjinë etnike, feje apo besimi, handikapi, moshe apo orientimi seksual.

E miratuar në dhjetor 2000, Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Europian përfshiu kapitullin "Barazia" që përcakton parimet e mosdiskriminimit, barazi ndërmjet burrit dhe gruas, larmisë kulturore, fetare dhe gjuhësore. Në lidhje me mosdiskriminimin, Karta përcakton që "Ndalohet çdo diskriminim me bazë gjinore, racore, ngjyre, origjine etnike apo sociale, tipare gjenetike, gjuhe, feje apo besimi, bindjeje politike apo tjetër, anëtarësie në pakicë kombëtare, pronësie, ditëlindjeje, handikapi, moshe apo orientimi seksual".

NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior). Aleanca e Atlantikut u krijua në 1949 dhe e ka selinë në Bruksel. Përbëhet nga 19 anëtarë: Shtetet Anëtare të Bashkimit Europian (me përjashtim të Austrisë, Finlandës, Irlandës dhe Suedisë), Kanada, SHBA, Islanda, Norvegjia dhe Turqia dhe pas 12 Marsit 1999 edhe nga Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke.

Politika e Bashkimit respekton detyrimet e disa Shteteve Anëtare që rrjedhin nga anëtarësia në NATO dhe përputhet me politikën e përbashkët të mbrojtjes dhe sigurisë për të cilën është rënë dakord në NATO. Deklarata për Bashkimin Europian Perëndimor që i është shtuar Traktatit të Bashkimit Europian specifikon marrëdhëniet e ardhshme ndërmjet NATO-s dhe Bashkimit Europian Perëndimor dhe shërben si një armë mbrojtjeje e Bashkimit dhe si një mjet për të forcuar shtyllën europiane të Aleancës së Atlantikut.

NATO “e rinovuar”. NATO i rinovuar” ka të bëjë me procesin e ripërcaktimit të rolit dhe punës së organizatës. Aspektet kyçe që përfshihen janë: njohja e identitetit europian të mbrojtjes, forcimi i komponentit europian të sistemit transatlantik të sigurisë, roli i ri i Bashkimit Europian Perëndimor dhe perspektiva e zgjerimit lindor të NATO-s -në fillim duke marrë Hungarinë, Poloninë dhe Republikën Çeke, si është rënë dakord në Këshillin e Atlantikut Verior në Madrid në Korrik 1997.

Kjo do të shoqërohet me një thellim të marrëdhënieve të NATO-s me vendet e treta me anë të partneriteteve për paqe dhe Këshillit për Bashkëpunim të Atlantikut Verior. Një sfidë e madhe në lidhje me këtë është krijimi i një partneriteti të qëndrueshëm me Rusinë dhe Ukrainën.

Ndihma para-aderimi. Kërkohej një investim shumë i madh nga ana e vendeve aplikante për përshtatjen e standardeve të tyre, veçanërisht normave të tyre industriale dhe mjedisore, me qëllim që ato të përputhen me legjislacionin europian kur bëhen pjesë e Bashkimit. Ndihma para aderimit për periudhën 2000-2006 për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore është një element kyç i strategjisë së Bashkimit Europian kundrejt vendeve aplikante dhe përfshin dy elementë kryesorë:

- programin Phare, i cili financon projektet e nevojshme për të përshtatur sistemet administrative dhe ligjore të vendeve aplikante dhe për të zhvilluar infrastrukturën e tyre (10.5 miliard euro);
 - dy fonde ndihmash të caktuar për të menaxhuar ndihmën shtesë:
- 1- mbështet masat strukturore në fushën e bujqësisë (Programeve të Veçanta të Aderimit për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural- 3.5 miliard Euro)
 - 2- financon zhvillimin e infrastrukturës në fushën e mjedisit dhe transportit (Instrumenti Struktural Para Aderimit, 7 miliard euro). Instrumenti për Politikën Strukturore Para Aderimit luan të njëjtin rol për vendet aplikante siç është dhe Fondi i Kohëzimit për Spanjën, Portugalinë, Greqinë dhe Irlandën.

Partneriteti për aderim i përfunduar ndërmjet Bashkimit dhe vendeve aplikante përbën thelbin e strategjisë së para-aderimit dhe shërben si një kanal për lloje të ndryshme ndihme.

Qipro, Malta dhe Turqia marrin ndihmë të veçantë të para-aderimit. Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 555/2000 parashikon një shumë reference prej 95 milion Euro-sh për zbatimin e veprimeve në kuadrin e strategjisë së para aderimit për Qipron dhe Maltën (57 milion euro për Qipron dhe 38 milion euro për Maltën). Kjo shumë vihet në dispozicion deri më 31 dhjetor 2004. Rregullorja (e Këshillit European) Nr.2500/2001, që ka të bëjë me ndihmën financiare para aderimit për Turqinë, parashikon një ndihmë të veçantë gjithsej mbi 2 milion euro.

Të gjitha vendet aplikante mund të marrin gjithashtu pjesë në ndihmën para-aderimit të Bankës Europiane të Investimeve.

Në Këshillin European të Kopenhagenit (12 dhe 13 dhjetor 2002) u miratuan ndihma shtesë para aderimit për Bullgarinë dhe Rumaninë.

Ndihma humanitare. Bashkimi European është një nga donatorët më të mëdhenj të ndihmës humanitare në botë.

Dimensionet e ndihmës humanitare të veprimit të jashtëm të Komunitetit European janë bërë të rëndësishme vitet e fundit për shkak të rritjes së numrit të krizave në mbarë botën dhe vullnetit të Komunitetit për të marrë rolin drejtues në përpjekjet ndërkombëtare humanitare.

Prandaj, në 1992 u krijua Zyra e Ndihmës Humanitare të Komisionit European. Detyra e kësaj zyre është të sigurojë ndihmë urgjente dhe ndihmë për viktimat (në formën e mallrave dhe shërbimeve) e katastrofave natyrore apo artificiale ose për konflikte jashtë Bashkimit European. Kjo ndihmë bazohet në parimet e mosdiskriminimit, paanshmërisë dhe humanizmit. Ndihma humanitare shpërndahet nga partnerë të zyrës së ndihmës humanitare të Komisionit European, kryesisht OJQ-të, agjensitë humanitare të OKB-së dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Ndihma Shtetërore. Neni 87 (ish neni 92) i Traktatit të Komunitetit European përcakton që “çdo ndihmë e dhënë nga një Shtet Anëtar ose nëpërmjet burimeve shtetërore në çfarëdo forme që, e cila kërcënon apo rrezikon të kërcënojë konkurrencën duke favorizuar sipërmarrje të caktuara ose prodhimin e produkteve të caktuara, konsiderohet e papajftueshme me tregun e përbashkët për aq kohë sa ajo ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare”.

Komisioni European dhe Gjykata e Drejtësisë kanë bërë një interpretim mjaft të gjerë mbi konceptin e “ndihmës” për sa i takon donatorit, i cili mund të variojë nga Shteti deri tek një autoritet rajonal apo vendor, nga një organ mbi të cilin Shteti ka ndikim vendimtar në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, tek një ndërmarrje e sektorit privat ose një korporatë publike, etj.

Rrjedhimisht, çdo avantazh i dhënë nga Shteti konsiderohet si ndihmë shtetërore kur:

- i jep përfituesit avantazhe ekonomike
- jepet në mënyrë të përzgjedhur për sipërmarrje ose produkte të caktuara
- mund të kërcënojë konkurrencën
- ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare.

Ndalimi i ndihmës zbatohet për një paketë të masave të ndihmës, qofshin këto (lëshime) direkte ose indirekte (p.sh., masa që e çlirojnë një ndërmarrje nga detyrimet financiare) dhe pavarësisht nga baza apo qëllimet e këtyre masave.

Megjithatë, një ndalim absolut i ndihmës shtetërore nuk mund të bëhet, dhe neni 87 (2) dhe (3) parashikon një numër përjashtimesh për ato ndihma që përputhen me tregun e përbashkët dhe për ndihma që mund të përputhen sipas disa kushteve të caktuara.

Sipas nenit 88 (ish neni 93) të Traktatit, Rregullorja për Ndihmën Shtetërore përcakton se çdo ndihmë apo skeme ndihme duhet t'i njoftohet Komisionit dhe të merret miratimi i tij përpara se të zbatohet. Megjithatë, kërkesa për njoftim paraprak është zbutur nga Rregullorja për Ndihmën Horizontale Shtetërore, e cila autorizon Komisionin të përjashtojë kategori të caktuara ndihme duke përfshirë ndihmën për trajnime, ndihmën për punësim, ndihmën për ndërmarrje të vogla dhe të mesme dhe ndihma të një rëndësie të vogël.

Me hartimin e udhëzimeve dhe kuadrove të reja, Komisioni ka bërë të qarta kushtet sipas të cilave mund të jepen forma të tjera të ndihmës shtetërore duke ndjekur objektivat horizontale të tilla, si: ndihma për zhvillimin rajonal, ndihma për mjedisin dhe kërkime.

Ndihma për zhvillim. Fillimet e politikës së zhvillimit të Komunitetit European nisën me nënshkrimin e Traktatit të Romës në vitin 1957. Shtetet Anëtare dhe territoret e jashtme ishin përfitueset e para. Megjithatë, vetëm me hyrjen në fuqi të Traktatit të Bashkimit European kjo politikë gëzon bazë specifike ligjore (neni 177/181 i Traktatit të Komunitetit European). Me zgjerimin e Bashkimit European, bashkëpunimi është shtrirë gradualisht në vende të tjera, si: vendet e Afrikës, të Karaibeve dhe të Paqësorit, të cilat kanë një marrëdhënie të ngushtë dhe të gjatë me disa Shtete Anëtare. Marrëveshja Kotonu, e firmosur në qershor 2000 ka forcuar këtë partneritet që bazohet në Konventat Lomé, e para ndër të cilat u nënshkrua në vitin 1975.

Përveç këtyre marrëveshjeve fillestare, vende të tjera si vendet e Amerikës Latine dhe Azia përfitojnë gjithashtu nga politika e zhvillimit komunitar.

Qëllimi kryesor i politikës së zhvillimit të Komunitetit European është reduktimi i varfërisë. Kjo politikë zbatohet jo vetëm përmes marrëveshjeve dypalëshe dhe rajonale, por edhe përmes programeve specifike në disa sektorë, si shëndetësia, veçanërisht me synim luftimin e sëmundjeve të transmetueshme dhe arsimin. Politika e zhvillimit përfshin bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare dhe pjesëmarrjen e Komunitetit dhe të Shteteve Anëtare në nismat e zbatuara në nivel botëror si nisma për Vendet e Varfra të Mbytura në Borxhe të Mëdha.

Sot, Bashkimi Europian është partneri kryesor i vendeve në zhvillim. Komuniteti Europian dhe Shtetet Anëtare sigurojnë 55% të ndihmës për zhvillim ndërkombëtar.

Negociatat për aderim. Aplikimet e 10 Vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore u pritën mjaft mirë në Këshillin Europian të Luksemburgut (dhjetor 1997). Negociatat zyrtare për aderim vijuan në dy faza. Në 30 mars 1998, filluan negociatat me “valën e parë” të vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore (Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Polonia dhe Sllovenia). Vendet kandidatë (Bullgari, Letoni, Lituani, Maltë, Rumani, Sllovakia) të “valës së dytë” filluan negociatat në shkurt 2000, kur reformat në këto vende kishin ecur përpara.

Përpara se të fillonin negociatat, u krye vlerësimi i legjislacionit të secilit vend aplikant me qëllim që të hartohej një program pune dhe të përcaktoheshin qëndrimet negociuese.

Negociatat për aderim shyrtojnë kapacitetin e vendit aplikant për të plotësuar kërkesat e një Shteti Anëtar dhe për të zbatuar tërësinë e legjislacionit komunitar (“*acquis*”) kur aderon në Bashkimin Europian, sidomos masat që duhen zbatuar menjëherë për të pasur një treg të vetëm. Negociatat trajtojnë dhe çështjen e ndihmës që Bashkimi Europian siguron para aderimit të këtyre vendeve për të ndihmuar në përafrimin e *acquis*. Negociatat mund të mbyllën edhe nëse *acquis* nuk është përafruar plotësisht, pasi marrëveshjet kalimtare mund të zbatohen edhe pas aderimit.

Vetë negociatat bëhen në formën e një Konferencë Ndërqeveritare dypalëshe (KNQ) (Bashkim Europian/vendi aplikant), ku ministrat takohen çdo gjashtë muaj, ndërsa ambasadorët çdo muaj. Qëndrimet e përbashkëta negociuese përcaktohen nga Komisioni për secilin kre që lidhet me çështjet që janë kompetencë e Komunitetit dhe miratohen me unanimitet nga Këshilli. Rezultatet e negociatave përfshihen në një projekt marrëveshje aderimi. Kjo marrëveshje duhet të miratohet nga Bashkimi Europian, pastaj të ratifikohet nga Shtetet Anëtare dhe nga vendet që kërkojnë të anëtarësohen.

Në Këshillin Europian të Kopenhagenit (12 dhe 13 dhjetor 2002), Komisioni përfundoi negociatat me 10 vendet aplikante: Republika Çeke, Qipro, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovakia dhe Slloveni, duke mundur kështu më 1 maj 2004 anëtarësimin e tyre në Bashkimin Europian. Përsa i takon Bullgarisë dhe Rumanisë, synohet që negociatat të përfundojnë në kohë dhe që këto vende të anëtarësohen në vitin 2007. Mundësia për të hapur negociatat me Turqinë do të rishqyrtohet në dhjetor 2004.

Neni 36 i Traktatit të Bashkimit Europian. Me nenin 36 (ish neni K.4) të Traktatit të Bashkimit Europian u krijua një Komitet Bashkëndimi i përbërë nga zyrtarë të lartë për të përgatitur terrenin për diskutimet e Këshillit në lidhje me bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet civile. Praktikisht, Komiteti ka ekzistuar që në dhjetor 1988 në Këshillin Europian të Rodit.

Njësia e Planifikimit dhe Paralajmërimeve. Ideja e ngritjes së Njesisë së Planifikimit dhe Paralajmërimeve nën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë lind nga besimi që nëse kjo politikë është e frytshme, do të duhen analiza më të shpejta dhe më të suksesshme të zhvillimeve të jashtme në periudha afatgjata, afatmesme dhe afatshkurtra. Rrjedhimisht, vendimet e marra nën Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë duhet të mbështeten nga përmbledhje më të besueshme, të cilat u vihen në dispozicion të gjitha Shteteve Anëtare të Bashkimit.

Në një deklaratë për Aktin Final, Konferenca Ndërqeveritare ra dakort të ngrejë Njësitë e Planifikimit dhe të Paralajmërimeve në Sekretariatën e Përgjithshëm të Këshillit, nën përgjegjësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të tij. Stafi i Bashkimit merret nga Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit, Shtetet Anëtare, Komisioni dhe Bashkimi European Perëndimor (BEP).

Objektivat 1, 2 dhe 3. Reforma e fondeve strukturore në Axhendën 2000 e përqendron ndihmën e politikës rajonale të Komunitetit mbi problemet kryesore të zhvillimit. Rregullat e tanishme parashikojnë vendosjen e tre objektivave parësore krahasuar me gjashtë objektivat e mëparshme.

Objektivi 1 nxit përmirësimin e ekonomive të rajoneve të prapambetura. Ky objektivi "rajonalizohet", sepse gjen zbatim në rajonet e kufizuara nga ana statistikore. Të drejtën e gëzojnë vetëm ato vende në të cilat Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për frymë është më pak se 75% e mesatares së Komunitetit. Ndihmë u jepet edhe shtatë rajoneve "më të largëta", zonave në Suedi dhe Finlandë, me dendësi popullore shumë të ulët dhe Irlandës së Veriut. Gjithsej, Objektivi 1 mbulon rreth gjashtëdhjetë rajone në trembëdhjetë Shtete Anëtare. Mbështetje tranzitore jepet për një periudhë shtatë-vjeçare edhe për rajonet që e gëzonin këtë të drejtë më parë gjatë periudhës 1994 – 1999. Për rajonet më të denja është caktuar një rezervë performance. Objektivi 1 merr 70% nga buxheti i fondeve strukturore (d.m.th. 137 miliard për më shumë se shtatë vjet), që ndahen ndërmjet katër fondeve (Fondi European i Zhvillimit Rajonal, Fondi European Social, Fondi European i Udhëzimit dhe Garancisë Bujqësore dhe Instrumenti Financiar për Udhëzimet në Peshkim). Katër fushat kryesore prioritare janë: infrastruktura bazë, zhvillimi i burimeve njerëzore, investimet në kërkime e risi dhe shoqëria e informacionit.

Objektivi 2 kontribuon në shndërrimin ekonomik dhe social të rajoneve me vështirësi strukturore. Edhe ky objektivi është i rajonalizuar. Caktimi i zonave të pranueshme varet si nga kufiri tavan i popullsisë kombëtare dhe asaj europiane (18% e popullsisë së Bashkimit) ashtu edhe nga kriteret social-ekonomike. Katër kategori të kualifikueshme janë përcaktuar:

- 4- zona që po kalojnë ndryshime ekonomike në industri dhe në sektorin e shërbimit,
- 5- zona rurale në rënie,
- 6- zona urbane në vështirësi,
- 7- zona të varfra që varen nga industria e peshkimit.

Duke qenë se i gjithë territori përfshihet në Objektivin 1, Greqia, Irlanda dhe Portugalia nuk kualifikohen për ndihmë në Objektivin 2. Ndihmë tranzitore jepet gjithashtu edhe për rajonet e përfshira në Objektivin 2 dhe 5 (b) gjatë viteve 1994-1999. Buxheti i Objektivit 2 arrin në shumën 22.5 miliard për më shumë se 7 vjet (11.5% e buxhetit total) dhe financohet nga Fondi European i Zhvillimit Rajonal dhe Fondi European Social.

Objektivi 3 mbështet përshtatjen dhe modernizimin e politikave dhe sistemeve të arsimit, të trainimit dhe të punësimit. Ky objektivi shërben si një kuadër referues për të gjitha masat e marra mbi bazën e titullit të ri të punësimit në Traktatin e Amsterdimit dhe për strategjinë vijuese europiane. Ky objektivi nuk është i rajonalizuar. Të gjitha rajonet që nuk përfshihen në Objektivin 1 janë të

kualifikueshme. Buxheti i caktuar për këtë objektiv është 24.05 miliard për më shumë se shtatë vjet (12.3% e buxhetit total) dhe financohet ekskluzivisht nga Fondi European Social.

Zhvillimi i Objektivave 1, 2 dhe 3 pas vitit 2006 varet nga vlerësimet e ardhshme të ndikimit të tyre në kohezionin ekonomik dhe social si dhe nga rezultati i debatit mbi të ardhmen e politikës rajonale pas vitit 2006, dhe më vonë mbi zgjerimin e Bashkimit European me përfshirjen e vendeve të Europës qendrore dhe lindore.

Organizata të përbashkëta të tregjeve bujqësore. Organizatat e përbashkëta të tregut janë dispozita në nivel komunitar që rregullojnë prodhimin dhe tregtinë e prodhimeve bujqësore në të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit European. Me prezantimin e Politikës së Përbashkët Bujqësore, organizatat e përbashkëta të tregjeve i kanë zëvendësuar gradualisht organizatat e tregjeve kombëtare në sektorë ku kjo ishte e nevojshme. Organizatat e përbashkëta të tregut pikë së pari kërkojnë të arrijnë qëllimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore dhe në veçanti të stabilizojnë tregjet, të sigurojnë një nivel të drejtë jetese për fermerët dhe të rrisin prodhueshmërinë bujqësore.

Organizma gjenetikisht të modifikuara (OMGJ). OMGJ janë organizma me material gjenetik (ADN) të ndryshuar jo nga riprodhimi dhe/ose rikombinimi natyror, por nga prezantimi i një gjeni të modifikuar ose një gjeni nga një varietet ose lloj tjetër.

Legjislacioni komunitar për OMGJ-të ka ekzistuar që në 1990. Veprimi i Bashkimit European është përcaktuar për të mbrojtur shëndetin dhe mjedisin në vazhdimësi të rregullave të një tregu të vetëm. Bashkimi European ka përcaktuar me ligj përdorimin, shpërndarjen, tregtinë dhe prejardhjen e OMGJ-ve. Ka miratuar gjithashtu masa për zbatimin e dispozitave për transportin ndërkufitar të OMGJ-ve të parashikuara në Protokollin e Kartagenës për sigurinë biologjike.

Komisioni European vë në pikëpyetje krijimin *de facto* të tregtisë dhe të prodhimit të OMGJ-ve brenda Bashkimit European, të prezantuar në vitin 1999 nga Shtetet Anëtare. Po shqyrtohet edhe mundësia për të autorizuar përsëri OMGJ-të duke marrë parasysh parimin mbrojtës me qëllim që të mos ndëshkohet industria europiane, bujqësia dhe kërkimet.

Pakti i para aderimit mbi krimin e organizuar. Në përgatitje për zgjerimin e Bashkimit European, më 28 maj 1998 ministrat e drejtësisë dhe të punëve të brendshme të Shteteve Anëtare dhe dhjetë vendet candidate të Europës Qendore dhe Lindore së bashku me Qipron miratuan 'një pakt para-aderimi mbi krimin e organizuar' me qëllim:

- lidhjen e vendeve aplikante me veprimet parësore të Bashkimit European;
- dhënien e ndihmës ndaj vendeve candidate për të miratuar *acquis communautaire* në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme;
- hartimin e projekteve të përbashkëta kundër krimit, për të cilat do të ishte e vlefshme ndihmë teknike dhe financiare nga ana e Bashkimit.

Vendet candidate morën përsipër të miratonin shpejt një numër konventash ndërkombëtare, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me ekstradimin (Konventa Europiane e vitit 1957), trafikun e drogës (Konventa e Kombeve të Bashkuara) dhe terrorizmin (Konventa Europiane e vitit 1977). Janë planifikuar marrëveshje me Europolin me qëllim që të rritet shkëmbimi i informacionit dhe të përcaktohen përparësitë për veprime që duhen marrë nga Bashkimi European dhe partnerët e tij.

Pakti i para aderimit financohet nga programi Phare dhe programe të tjera si Grotius, Stop dhe Falcone.

Pakti i para-aderimit mbi krimin e organizuar është tashmë një mjet thelbësor për integrimin gradual të vendeve candidate në strategjinë e Komunitetit për monitorimin dhe parandalimin e krimit të organizuar.

Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike. Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike duhet parë nën këndvështrimin e fazës së tretë të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, i cili filloi më 1 janar 1999. Qëllimi i këtij Pakti është të sigurojë që Shtetet Anëtare të vazhdojnë përpjekjet e tyre të disiplinës buxhetore me hyrjen e monedhës së vetme.

Në terma praktikë, Pakti përfshin një rezolutë të Këshillit European (miratuar në Amsterdam më 17 qershor 1997) dhe dy Rregullore të Këshillit të datës 7 korrik 1997, duke vendosur rregulla të hollësishtme teknike (njëra mbi mbikqyrjen e pozicioneve buxhetore dhe bashkërendimin e politikave ekonomike, dhe tjetra mbi zbatimin e procedurës së deficitit të tepërt).

Në periudhën afatmesme, Shtetet Anëtare kanë nisur të ndjekin objektivin për një buxhet të balancuar ose afërsisht të balancuar, si edhe t'i paraqesin Këshillit dhe Komisionit një program stabiliteti brenda datës 1 mars 1999 (procedura do të përditësohet më tej çdo vit). Duke ndjekur të njëjtën rrugë, Shtetet që nuk marrin pjesë në fazën e tretë të Bashkimit European Monetar duhet të paraqesin një program konvergjence.

Pakti i Stabilitetit dhe Rritjes Ekonomike i hap rrugën Këshillit që të ndëshkojë çdo Shtet Anëtar i cili nuk arrin të marrë masat e duhura për mbylljen e një deficiti të tepërt. Fillimisht, ky ndëshkim do të kishte formën e një depozite pa interes me Komunitetin, por që mund të kthehet në gjobë, në qoftë se deficiti i tepërt nuk korrigjohet brenda dy viteve.

Parimi i mosdiskriminimit. Qëllimi i këtij parimi është të sigurojë barazi trajtimi për personat pavarësisht nga kombësia, gjinia, raca, apo origjina etnike, feja apo besimi, handikapi, mosha apo orientimi seksual.

Neni 12 i Traktatit të Komunitetit Europian (ish neni 6) ndalon çdo diskriminim në bazë kombësie. Në Traktatin e Amsterdimit është shkruar neni i ri 13 i Traktatit të Komunitetit Europian për të rforcuar mosdiskriminimin e parashtruar në Traktate dhe për ta shtrirë në raste të tjera të cituara më sipër.

Parimi parandalues. Më 12 Shkurt 2000, Komisioni Europian miratoi një komunikatë mbi parimin parandalues, ku përkufizohet ky koncept dhe shpjegohet mënyra se si Komisioni Europian do ta vinte në zbatim.

Ky tekst plotësonte Librin e Bardhë mbi Sigurinë Ushqimore (Janar 2000) dhe marrëveshjen e përfunduar në shkurt 2000 në Montreal për Protokollin e Kartagjenës për Sigurinë Biologjike.

Në këtë dokument, Komisioni përcaktoi rastet specifike ku gjen zbatim ky parim:

- Kur të dhënat shkencore janë të pamjaftueshme, të papërfunduara ose të pasigurta
- Kur një vlerësim paraprak shkencor tregon për kanosjen e rreziqeve të mundshme për mjedisin dhe shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve.

Në të dyja rastet, rreziqet nuk përputhen me nivelin e lartë të mbrojtjes së kërkuar nga Bashkimi Europian.

Komunikata paraqet gjithashtu tre rregullat që duhet të ndiqen në mënyrë që të respektohet parimi parandalues:

- Një vlerësim i plotë shkencor i kryer nga një autoritet i pavarur me qëllim përcaktimin e shkallës së pasigurisë shkencore
- Një vlerësim i rreziqeve të mundshme dhe pasojat e mosveprimit
- Pjesëmarrja në kushtet e një transparence maksimale të të gjitha palëve të interesuara në studimin e masave të mundshme.

Në fund, Komisioni do të donte të theksonte se masat që janë rezultat i përdorimit të parimit parandalues, mund të marrin formën e një vendimi për të vepruar ose jo, në varësi të nivelit të rrezikut të konsideruar si "i pranueshëm". Për shembull, Bashkimi vuri në zbatim parimin parandalues në fushën e OMGJ-ve, me hyrjen në fuqi të një moratoriumi në vitin 1999.

Parlamentet kombëtare. Konferenca e Komiteteve të Çështjeve të Komunitetit European duke nisur në vitin 1989 është mbledhur çdo gjashtë muaj. Kjo konferencë përbëhet nga përfaqësues të komisioneve përkatëse në parlamentet kombëtare dhe të anëtarëve të Parlamentit European.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Mastrohtit, Bashkimi European ka fituar kompetencë në fushat që më përpara i takonin nivelit kombëtar si drejtësia dhe çështjet e brendshme. Për këtë arsye, rëndësia e shkëmbimeve ndërmjet parlamenteve kombëtare dhe Parlamentit European u theksua në një deklaratë për rolin e parlamenteve kombëtare në Bashkimin European. Qeverive kombëtare ju kërkua të siguronin që parlamentet të merrnin në kohë propozimet e Komisionit për një shqyrtim të mundshëm. Informacioni për parlamentet kombëtare do t'i përfshinte më shumë në procesin e Komunitetit dhe do të ushtronin kontroll më të ngushtë demokratik në këtë proces.

Një protokoll në Traktatin e Amsterdamin mbi rolin e parlamenteve kombëtare i është shtuar Traktatit të Bashkimit European, duke specifikuar informacionin që duhet t'u dërgohet parlamenteve kombëtare (Libri i Bardhë, Libri i Gjelbër, komunikatat dhe propozimet për legjisllacioni). Parlamentet kombëtare kanë një periudhë 6-javore për të diskutuar një propozim ligjvënës, që pas datës që Komisioni e vë në dispozicion të Parlamentit European dhe Këshillit, deri kur të vihet në axhendën e Këshillit.

Konferenca e Komiteteve të Çështjeve të Komunitetit European ka dhe kompetencën t'u japë institucioneve të Bashkimit European kontribute dhe të shyrtojë çdo propozim për një akt legjisllativ që lidhet me krijimin e një zone lirie, sigurie dhe drejtësie (që mund të ketë peshë në të drejtat dhe liritë themelore të individëve).

Si pjesë e përgatitjes së vendeve aplikante për aderim në BE, përfaqësues të parlamenteve kombëtare të 6 vendeve të "valës së parë" (Qipro, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Polonia dhe Sllovenia), kanë marrë pjesë në punën e Konferencës së Komiteteve të Çështjeve të Komunitetit European, që kur filluan negociatat për aderim më 30 Mars 1988.

Parlamenti European. Parlamenti European është asamble e përfaqësuesve të 370 milion qytetarëve të Bashkimit European. Që nga viti 1979 zgjedhjet parlamentare janë bërë me votim të drejtpërdrejtë, të shpërndarë ndërmjet Shteteve Anëtare sipas popullsisë së tyre. Parlamenti European,

- merr në konsideratë propozimet e Komisionit dhe bashkë me Këshillin merr pjesë në procesin legjisllativ në disa raste si bashkëligjvënës me anë të procedurave të ndryshme (procedura e vendimmarrjes së përbashkët, e bashkëpunimit, e pëlqimit, etj)
- ka kompetencë të kontrollojë veprimtaritë e Bashkimit European me anë të konfirmimit të tij për emërimin e Komisionit (dhe të drejtën për të çensuar) dhe me anë të pyetjeve me shkrim dhe me gojë që mund t'i parashtrojë Komisionit dhe Këshillit

- ndan kompetenca buxhetore me Këshillin në votimin e buxhetit vjetor duke e bërë të detyrueshëm me anë të nënshkrimit të Presidentit të Parlamentit dhe mbikqyrjes së zbatimit.

Parlamenti emëron Avokatin e Popullit (Ombudsmanin) i cili është i autorizuar për të marrë ankesa nga qytetarët e Bashkimit European në lidhje me keqadministrimin në veprimtaritë e institucioneve dhe organeve komunitare. Së fundmi, mund të krijojë komisione të përkohshme hetimore, kompetencat e të cilave nuk kufizohen me shqyrtimin e veprimeve të institucioneve komunitare, por mund të kenë lidhje me masat e marra nga Shtetet Anëtare në zbatim të politikave të Komunitetit.

Traktati i Amsterdimit thjeshtoi disa procedura legjislativë duke i dhënë pothuajse fund procedurës së bashkëpunimit (zbatohet akoma për disa çështje në Titullin për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar) dhe duke e shtrirë mjaftueshëm procedurën e vendimmarrjes së përbashkët.

Traktati i Nisës, i cili hyri në fuqi në 1 shkurt 2003, rriti rolin e Parlamentit si ligjvënës duke e shtrirë procedurën e vendimmarrjes së përbashkët dhe i dha Parlamentit European të drejtën për të ngritur padi para Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit European me të njëjtat kushte si institucionet e tjera.

Me synim zgjerimin e Bashkimit European, Traktati i Nisës ka kufizuar numrin e deputetëve të Parlamentit European në 732 maksimumi. Ky numër hyri në fuqi pas zgjedhjeve të qershorit 2004 (numri i caktuar në Traktatin e Amsterdimit është 700). Gjithashtu, në Traktat ricaktohen vendet ndërmjet Shteteve Anëtare (që humbasin 91 vende) dhe vendeve candidate, me anë të një ekuilibri ndërmjet situatës aktuale demografike dhe barazisë ndërmjet Shteteve Anëtare në zbatim të parimit të “përfaqësimit të duhur të popujve”.

Partnerë socialë. Komisioni duhet të këshillohet me partnerë të ndryshëm socialë në rastet kur dëshiron të paraqesë propozime në këtë fushë. Dialogu social ndodh nëpërmjet tri organizatave kryesore që përfaqësojnë partnerët socialë në nivel european:

- Konfederata e Sindikatës Europiane
- Bashkimi i Industrive të Komunitetit European
- Qendra Europiane për Sipërmarrje Publike

Puna e Komisionit është të marrë të gjitha masat e nevojshme për inkurajimin dhe lehtësimin e konsultimeve me partnerët socialë mbi zhvillimin e ardhshëm të veprimit të Komunitetit, si dhe mbi përmbajtjen e çdo propozimi për politikën sociale të Bashkimit European, e cila është mjaft e lidhur me tregun e punës.

Në fillim të vitit 1957, me Traktatin e Romës u krijua një Asamble Konsultative e Partnerëve Ekonomikë dhe Socialë në Europë. Roli i asamblesë ishte të përfshinte të gjithë këto grupe me interesa të ndryshme në ngritjen e tregut të përbashkët. Anëtarët e asamblesë merren nga përfaqësues të tri kategorive: punëdhënësit, të punësuarit dhe profesionet e pavarura. Akti Unik European dhe Traktati i

Bashkimit European rriti numrin e fushave për të cilat Asambleja, Komiteti Ekonomik dhe Social, duhet të këshillohen me institucionet e tjera kur duan të paraqesin legjisllacionin në fushën sociale.

Partneritet për aderim. Partneritetet për aderim që u përfunduan në 1998 nga Këshilli me secilin nga vendet aplikante (me përjashtim të Qipros, Maltës dhe Turqisë) përmbledhin në një dokument të vetëm ndihmën që Komuniteti European i ofron secilit vend aplikant dhe përcaktojnë përparësitë për secilin sektor në transpozimin e të drejtës komunitare ("acquis").

Pas partneritetit për aderim, secili vend harton një program të detajuar për miratimin e *acquis communautaire* për të organizuar zbatimin e këtyre prioritetëve, duke iu përbajtur një afati kohor dhe duke angazhuar burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare. Programet dhe partneritetet për aderim herë pas here pësojnë ndryshime nga Komisioni dhe nga shteti i interesuar.

Partneritetet për aderim kanë shërbyer si mbështetje për instrumente të tjerë të para-aderimit, përfshirë këtu vlerësimin e përbashkët të prioritetëve afatmesme të politikës ekonomike, paktin për krimin e organizuar, planet kombëtare të zhvillimit dhe programe sektoriale që janë të nevojshme për pjesëmarrjen në Fondet Strukturore pas aderimit dhe për zbatimin e Instrumentit Strukturore para aderimit dhe të Programeve të Veçanta të Aderimit për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural. Këto kanë qenë gjithashtu edhe pikënisja për hartimin e plan-veprimeve me synim përmirësimin e kapaciteteve administrative dhe ligjore në vendet aplikante.

Personaliteti juridik i Bashkimit. Çështja e statusit ligjor të Bashkimit European është ngritur në lidhje me kapacitetin e Bashkimit European për të lidhur traktate, marrëveshje apo konventa pasi Bashkimi European i cili përfshin tre komunitete të veçanta, secili me personalitet juridik (Komuniteti European, KEQÇ dhe Euroatom) dhe dy fusha të bashkëpunimit ndërqeveritar, nuk ka "kompetenca për të lidhur marrëveshje", pra të drejtën ndërkombëtare për të lidhur marrëveshje me vendet e treta..

Traktati i Amsterdami nuk përmban dispozita të reja për këtë çështje pasi Shtetet Anëtare nuk arritën marrëveshje në KNQ. Disa vëzhgues diskutojnë se nuk ka asnjë problem dhe se asgjë nuk e pengon Bashkimin të arrijë marrëveshje dhe të fitojë pozicionin e vet në arenën ndërkombëtare.

Perspektiva financiare 2000-2006. Perspektiva financiare formon kuadrin për shpenzimet e Komunitetit për një periudhë disa-vjeçare. Kjo perspektivë është rezultati i një marrëveshjeje ndërinstitucionale ndërmjet Parlamentit European, Këshillit dhe Komisionit. Ajo tregon vëllimin maksimal dhe përbërjen e shpenzimeve të parashikueshme komunitare. Çdo vit perspektiva financiare rregullohet nga Komisioni për të marrë parasysh çmimet dhe zhvillimin e PBB të Komunitetit. Megjithatë, duhet pasur parasysh që perspektiva financiare nuk

është një buxhet shumëvjeçar, pasi procedura e përvitshme buxhetore është thelbësore për të përcaktuar shumën aktuale të shpenzimeve dhe ndarjen ndërmjet zërave të ndryshëm buxhetorë.

Janë përfunduar tri marrëveshje ndërinstitucionale të këtij lloji;

e para në 1988, e dyta në 1992 dhe e treta në 1999:

- perspektiva financiare 1988-1992 (paketa Delor I);
- perspektiva financiare 1993-1999 (paketa Delor II);
- perspektiva financiare 2000-2006

Perspektiva financiare 2000-2006 është pjesë e marrëveshjes së re ndërinstitucionale që është guri i qoshes së paketës fiskale Axhenda 2000. Kjo marrëveshje, që gjeti miratim politik në takimin e nivelit të lartë të Berlinit në mars 1999, duhet t'i mundësojë Bashkimit Europian pranimin e anëtarëve të rinj dhe në të njëjtën kohë do t'i forcojë politikat e tij, ndërsa i përmbahet një kuadri rigoroz.

Perspektiva financiare përcakton kuadrin referencë për periudhën 7 vjeçare (2000-2006). Edhe pse nuk mund të përfshijë shpenzimet e lidhura me aderimet e reja përpara se të hyjnë në fuqi, kjo perspektivë ka tri tipare që janë interesante në lidhje me zgjerimin:

- Financimet bujqësore përfshijnë një politikë të re rurale, masa veterinare, një instrument bujqësor para-aderimi dhe një kufi në dispozicion të zgjerimit.
- Akordimi i Fondeve Strukturore i përcaktuar për 15 shtetet anëtare gradualisht do të reduktohet nga 2002 dhe më vonë duke përqëndruar përparësitë në një numër më të kufizuar rajonesh. Veprimet strukturore përfshijnë gjithashtu një instrument të ri para-aderimi.
- shuma e akorduar për veprim të jashtëm është rritur me 2% në vit për të mbuluar rritjen për ndihmën e para-aderimit sipas programit *Phare*. Përveç kësaj, akordimet e parashikuara për ndihmën e para-aderimit (*Phare*, Instrumenti Strukturore për para-aderimin dhe Programe të Veçanta të Aderimit për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural) nuk do të ndryshojnë pavarësisht nga numri i vendeve aplikante që do të bëhen anëtare të Bashkimit Europian gjatë periudhës 2000-2006. Burimet mund të përqendrohen në vendet që kanë më shumë nevojë.

Së fundi, disiplina buxhetore do të ruajë tavanin aktual për shpenzimet, 1.27% e prodhimit kombëtar bruto të Komunitetit deri në 2006.

Peshimi i votave në Këshill. Kur Këshilli vendos me shumicë të cilësuar, peshimi i votave në Këshill është rezultat i një kompromisi ndërmjet Shteteve Anëtare të cilat pavarësisht që sipas ligjit janë të barabarta, ndryshojnë në anë të tjera. Një faktor që përcakton numrin e votave të një Shteti Anëtar është numri i popullsisë së tij, me një rregullim që çon në një mbi përfaqësim relativ të vendeve me popullsi të vogël. Ky sistem ka funksionuar më së miri deri tani, pasi vendimet e marra kanë qenë të legjitimuara. Me shpërndarjen e tanishme të votave është e

pamundur për vendet “e mëdha”, që të kombinohen për të vënë vendet “e vogla” në pakicë dhe anasjelltas. Kjo garanton që vendimet e marra me shumicë të cilësuar të kenë mbështetjen më të madhe të mundshme.

Në këndvështrimin e zgjerimit, Konferenca e fundit Ndërqeveritare (KNQ) zbatoi një rishikim të shkallës së peshimit për të siguruar se pesha e vogël e vendeve “të vogla” dhe “të mesme” të jetë në proporcion me popullsinë e tyre. Kështu, numri i votave të vendeve me popullsi më të madhe është rritur më shumë në lidhje me numrin e vendeve të tjerave, për të mundësuar ligjshmërinë e vendimeve të Këshillit për sa i takon përfaqësimit demografik. Sistemi i ri i peshimit të votave hyri në fuqi më 1 nëntor 2004. KNQ ka vendosur edhe numrin e votave që do t'i caktohen anëtarëve të rinj pas aderimit.

Përveç rregullimit të numrit të votave, Traktati i Nisës paraqiti gjithashtu sistemin e shumicës së dyfishtë.

Për sa i takon zgjerimit, çështja e peshimit të votave në Këshill është e lidhur ngushtë me atë të numrit dhe shtetësisë së komisionerëve, si dhe zgjerimit të votimit me shumicë të cilësuar. Sa më e madhe të jetë fusha e votimit me shumicë të cilësuar, aq më i drejtë do të jetë peshimi i votave për vendimmarrjen në Këshill, meqënëse ajo do të shmangë rrezikun e vetos. Për sa i takon çështjes së numrit dhe shtetësisë së komisionerëve, vendet “më të mëdha” kanë pranuar të humbasin komisionerin e tyre të dytë në këmbim të një zëri më të fortë në Këshill.

Peticionet. E drejta për peticion është një e drejtë që e gëzon çdo shtetas i Bashkimit Europian, në mënyrë individuale apo në bashkëpunim me qytetarë të tjerë, për të paraqitur një kërkesë pranë Parlamentit Europian, ose një ankesë para parlamentit apo çdo subjekti tjetër që është brenda sferës së veprimtarisë së Komunitetit dhe e prek atë në mënyrë të drejtpërdrejtë (nenet 21 dhe 194 të Traktatit të Komunitetit Europian, ish nenet 8d dhe 138d).

Komisioni Parlamentar për Peticionet merr në konsideratë nëse kërkesa të tilla janë të pranueshme. Kur e sheh të përshtatshme, ai mund t’ia shtrojë çështjen Avokatit të Popullit. Gjatë hartimit të një opinioni mbi një peticion të vlerësuar si të pranueshëm, ai mund t’i kërkojë Komisionit Europian t’i japë dokumenta ose informacion.

Traktati i Amsterdimit i shtoi një paragraf nenit 21, duke pohuar se çdo shtetas i Bashkimit mund t’i drejtohet me shkrim secilit prej institucioneve, përfshirë Komitetin e Rajoneve dhe Komitetin Ekonomik dhe Social, si edhe Avokatin e Popullit në njërën prej gjuhëve zyrtare të Bashkimit (përfshirë gjuhën irlandeze) dhe të marrë një përgjigje me shkrim në të njëjtën gjuhë.

Përbërja e Komisionit Europian. Aktualisht, Komisioni përfshin të paktën një anëtar nga çdo Shtet Anëtar (dy për shtetet e mëdha: Francë, Gjermani, Itali, Spanjë dhe Britani e Madhe).

Përbërja e Komisionit në perspektivën e zgjerimit është çështje thelbësore për të gjitha debatet e tanishme. Kjo përbërje mbetet çështje parësore pasi vendoset për numrin optimal të komisionerëve të nevojshëm për të garantuar ligjshmërinë, përgjegjësinë kolektive dhe efikasitetin e një institucioni, qëllimi i të cilit është të prezantojë interesin e përgjithshëm me pavarësi të plotë. Koncepti i përgjegjësisë kolektive është shumë i rëndësishëm. Ky koncept është përcaktuar specifikisht për strukturën e Komisionit dhe do të thotë që pozicionet e miratuara nga Komisioni të pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit si një i tërë dhe jo të anëtarëve të veçantë. Me perspektivën e zgjerimit të ardhshëm, ekziston frika që një rritje në numrin e Komisionerëve do të çojë në nacionalizimin e funksionit të tyre në dëm të përgjegjësisë kolektive. Në të kundërt, nëse numri do të kushhtëzohet, ekziston frika që disa shtete nuk do të përfaqësohen brenda Komisionit si të tilla.

Traktati i Nisës, një rezultat i Konferencës Ndërqeveritare 2000, ofron një zgjidhje të përkohshme për këtë çështje duke parashikuar për:

- një kufizim në numrin e anëtarëve nga data në të cilën Komisioni i radhës merr detyrat e veta (1 nëntor 2004) në 1 anëtar për shtet anëtar;
- një numër kufi për numrin e anëtarëve sapo anëtarësia e Bashkimit European arrin në 27 vende. Në këtë pikë, Këshilli duhet të vendosë me unanimitet numrin e saktë të anëtarëve që do të ketë Komisioni (gjithmonë më pak se 27). Shtetësia e tyre do të varet nga sistemi me rotacion ndërmjet shteteve anëtare.

Shtetet Anëtare që deri tani kanë pasur dy komisionerë, në vitin 2005 humbin të drejtën e një komisioneri të dytë, por fitojnë një ripeshim të votave në favor të tyre kur vendimet miratohen brenda Këshillit.

- Këshilli European i Kopenhagenit (12-13 dhjetor 2002) vendosi që komisionerët nga Shtetet e reja Anëtare të fillojnë punën në Komisionin aktual në ditën e aderimit të vendit të tyre më 1 maj 2004.

Përfaqësues i lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Me Traktatin e Amsterdimit u krijua një post i ri i përfaqësuesit të lartë të Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ky post mbahet nga sekretari i përgjithshëm i Këshillit detyra e të cilit është të ndihmojë presidencën e Bashkimit në çështjet që lidhen me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë. Ai/Ajo që mban këtë post njihet edhe si "Z/ZNJ CFSP" (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë). Përfaqësuesi i lartë i lejon Bashkimit European të shprehet me koherencë dhe transparencë në skenën ndërkombëtare duke i dhënë atij një fytyrë dhe zë të dallueshëm.

Përfaqësuesi i lartë ndihmon edhe në formulimin, përgatitjen dhe zbatimin e vendimeve të politikës nga Këshilli. Ai ose ajo mund të krijojnë dialog politik me palë të treta në emër të Këshillit me kërkesën e Presidencës.

Përgjegjësia për drejtimin e sekretariatit të përgjithshëm të Këshillit bie mbi zëvendës/sekretarin e përgjithshëm.

Përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit Europian. Përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit Europian përcaktohen në përputhje me faktin nëse këto bien mbi Komunitetin apo mbi Shtetet Anëtare. Përshkruhen si “ekskluzive” nëse ushtrohen vetëm nga Komuniteti (psh. Politika e Përbashkët Bujqësore) dhe “të përziera” nëse ndahen me Shtetet Anëtare (psh. politika e transportit)

Dallimi është përcaktuar në praktikat gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian bazuar në parimin e përgjegjësisë së nënkuptuar, ku përgjegjësia e jashtme rrjedh nga ekzistenca e përgjegjësisë së brendshme. Traktati i kësaj gjykatë jep përgjegjësi të jashtme vetëm në dy raste: në politikën tregtare (neni 133, ish neni 113) dhe në marrëveshjet e asociimit (neni 310, ish neni 238).

Duhet të theksohet që Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë ndodhet nën kapitullin e marrëdhënieve të jashtme të Bashkimit Europian që drejtohen nga procedura ndërqeveritare (shtylla e dytë) dhe jo nga përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit Europian.

Rritja e veprimtarive të Komunitetit (psh. përfundimi i tregut të njësuar), zhvillimet në tregun botëror dhe çështje më të paqarta e kanë bërë më problematik ushtrimin e kompetencave të jashtme, ndërsa në të njëjtën kohë përfshijnë një detyrë të rëndësishme të bashkëpunimit dhe të bashkërendimit në emër të një fronti të bashkuar për përfaqësim ndërkombëtar.

Me qëllim që Komuniteti të përshtatet me ndryshimet rrënjësore në strukturat e ekonomisë botërore dhe që të pasqyrojë përgjegjësitë që i janë dhënë OBT-së, Traktati i Amsterdimit ka ndryshuar nenin 133 të Traktatit të Komunitetit Europian, kështu që Këshilli vendos me unanimitet për të shtrirë qëllimin e politikës së përbashkët tregtare deri në negociatat ndërkombëtare dhe marrëveshjet për shërbimet dhe pronësinë intelektuale.

Përqendrimi. Përqendrimi është rezultati i një shkrirjeje të dy ose më shumë ndërmarrjeve të pavarura, por mund të jetë dhe rezultat i “zaptimit” të një ndërmarrjeje nga një ndërmarrje tjetër, që vepron vetëm (kontroll të vetëm), ose nga dy apo më shumë ndërmarrje, që veprojnë së bashku (kontroll i përbashkët).

Sipas të drejtës europiane për konkurrencën, përqendrimet me dimension komunitar (që tejkalojnë kufirin e “zaptimit” të parashikuar në Rregulloren e Kontrollit të Shkrirjes) i nënshtrohen procedurës së kontrollit e cila i jep Komisionit kompetencën për të vlerësuar pajtueshmërinë e tyre me tregun e përbashkët dhe për t’i ndaluar kur kjo është e nevojshme. Sipas kësaj rregulloreje, një përqendrim me dimension Komunitar “që krijon ose përforcon një pozicion dominues si rezultat i të cilit konkurrenca efektive do të pengohej në tregun e përbashkët, ose do të shpallej i pajtueshëm me tregun e përbashkët në një pjesë të rëndësishme të saj”.

Me synim që një përqendrim të jetë në pajtueshmëri me tregun e përbashkët, Komisioni merr parasysh disa faktorë, si konceptin e “dimensionit komunitar”, “pozicionit dominues”, “konkurrencës efektive” dhe “tregut përkatës”.

Politika ekonomike. Bashkimi Ekonomik dhe Monetar nënkupton bashkërendim të ngushtë të politikave ekonomike kombëtare, të cilat janë bërë çështje problematike. Praktikisht, Këshilli me rekomandim të Komisionit vendos me shumicë të cilësuar dhe harton udhëzime që i dërgohen Këshillit European. Sipas përfundimeve të fundit, Këshilli përsëri me shumicë të cilësuar, miraton një rekomandim që përcakton Udhëzimet e Përgjithshme të Politikës Ekonomike të Shteteve Anëtare dhe të Komunitetit dhe informon Parlamentin European (neni 99 i Traktatit të Bashkimit European). Këto udhëzime të përvitshme janë elementi qendror i bashkërendimit të politikave ekonomike të Bashkimit.

Përveç këtyre udhëzimeve të përgjithshme, Traktati i Bashkimit European parashtron dispozita të politikës ekonomike në Kreun VII, neni 98-104 që përfshijnë:

- **mbikqyrjen shumëpalëshe** - Shtete Anëtare të mbledhura në Këshill, monitorojnë zhvillimet ekonomike dhe zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme të politikës ekonomike; ato mund të nxjerrin rekomandime për qeverinë e një Shteti Anëtar që nuk përputhet me këto udhëzime
- **procedurën e deficitit të tepërt** - Shtetet Anëtare duhet të shmangin deficitet e tepërta të qeverive dhe i takon Komisionit të sigurohet që ky parim përputhet me këtë procedurë. Neni 104 parashtron procedurën përkatëse, kushtet, përjashtimet dhe pasojat ku mund të përfshihen edhe gjობat
- **ndihmën financiare** - Nëse një shtet anëtar është në vështirësi të mëdha, Këshilli sipas disa kushteve mund të japë ndihmë financiare
- **ndalimin kundër marrjes së angazhimeve të Shteteve të tjera Anëtare** - Komuniteti ose Shtete të tjera Anëtare nuk mund të marrin angazhimet e Shteteve të tjera Anëtare
- **ndalimin e hyrjes së privilegjuar** - Është e ndaluar t'u lejohet autoriteteve apo ndërmarrjeve të privilegjuara hyrja e privilegjuar në institucionet financiare.

Kreu VII i Traktatit të Komunitetit European parashikon gjithashtu dispozitat institucionale të zbatueshme për Bankën Qendrore Europiane (BQE) (neni 112-115) dhe dispozitat kalimtare të nevojshme për zbatimin e fazave të ndryshme të Bashkimit Ekonomik dhe Monetar.

Politika e Përbashkët Bujqësore. Politika e Përbashkët Bujqësore është një çështje ekskluzive e Komunitetit. Sipas nenit 33 të Traktatit të Komunitetit European (ish neni 39), qëllimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore janë sigurimi i çmimeve të arsyeshme për konsumatorët europianë dhe të ardhura të ndershme për fermerët, duke krijuar në veçanti organizatën e përbashkët të tregjeve bujqësore dhe duke zbatuar parimet e çmimeve të njëjta, solidaritetit financiar dhe preferencave të Komunitetit.

Politika e Përbashkët Bujqësore është një nga politikat më të rëndësishme të Bashkimit (shpenzimet bujqësore llogaritin 45% të buxhetit të komunitetit). Politika vendoset me shumicë të cilësuar në Këshill pasi është këshilluar me Parlamentin European.

Në fillim Politika e Përbashkët Bujqësore e ndihmoi Komunitetin që të ishte i vetëmjaftueshëm për një kohë shumë të shkurtër. Megjithatë kjo filloi të kushtonte shumë, sepse çmimet në Europë ishin shumë të larta krahasuar me çmimet e tregut botëror. Një sërë reformash në vitin 1992 e rregulluan situatën nëpërmjet uljes së çmimeve të fermave me shpërblime kompensuese për inputet dhe prezantimit të masave mbrojtëse.

Në kuadër të zgjerimit, në vitin 1999, u miratua një paketë e re reformash për periudhën 2000-2006. Orientimi i propozuar nga Komisioni në Axhendën 2000 në korrik 1997, i përforcon ndryshimet e vitit 1992 dhe vë theksin në sigurinë ushqimore, qëllimet mjedisore dhe bujqësi të qëndrueshme. Gjithashtu, kjo paketë përfshin përpjekjet për rritjen e konkurrencës në prodhimet bujqësore të Komunitetit, thjeshtimin e legjislacionit bujqësor dhe mënyrën se si zbatohet, si edhe forcimin e pozitës së Bashkimit Europian në negociatat me OBT (Raundi i Mijëvjeçarit) dhe në fund në stabilizimin e shpenzimeve në bujqësi.

Në këtë frymë, janë bërë tashmë ndryshime në organizimin e përbashkët të tregtisë së verërave, drithërave, mishit të lopës dhe mishit të viçit, qumështit. Propozimi për ulje në çmimet e ndërhyrjes është ekuilibruar nga rritja e ndihmës për fermerët e shoqëruar me një politikë të integruar për zhvillimin rural.

Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë. Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë u krijua dhe rregullohet në Titullin V të Traktatit të Bashkimit Europian. Kjo politikë zëvendësoi Bashkëpunimin Politik Europian dhe parashikoi kuadrin aktual të një politike të përbashkët mbrojtjeje e cila në kohën e duhur do të çonte në një mbrojtje të përbashkët.

Qëllimet e shtyllës së dytë të Bashkimit Europian janë përcaktuar në Nenin 11 të Traktatit të Bashkimit Europian dhe do të arrihen përmes instrumentave specifikë ligjorë (veprime të përbashkëta, qëndrime të përbashkëta) të cilat duhet të miratohen nga Këshilli me unanimitet. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, Bashkimi Europian ka dhe një instrument të ri në dispozicion - **strategjia e përbashkët** - të përmendur në nenin 12 të Traktatit të Bashkimit Europian. Traktati i Amsterdimit parashikon votim me shumicë të cilësuar sipas disa kushteve dhe, që kur u nënshkrua PPJS, ka pësuar ndryshime në çdo Këshill Europian.

Traktati i Nisës prezantoi mundësinë që sipas kushteve të caktuara të vendosej bashkëpunim më i ngushtë në Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë për zbatimin e veprimeve dhe qëndrimeve të përbashkëta. Ky bashkëpunim më i ngushtë nuk mund të përdoret për implikime ushtarake apo mbrojtjeje.

Politika e Përbashkët e Transportit. Qëllimi i Politikës së Përbashkët të Transportit është të parashtojë rregulla të përbashkëta të zbatueshme në lidhje me transportin ndërkombëtar në drejtim të një Shteti Anëtar apo nga territori i tij, ose që kalon nëpër territorin e një ose më shumë Shteteve Anëtare (neni 70-80 i Traktatit të Komunitetit Europian). Gjithashtu, parashtron kushtet sipas të cilave transportues jo rezidentë mund të pranohen të ushtrojnë shërbime transporti në një Shtet Anëtar; si edhe masat që do të përmirësonin sigurinë në transport.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, tani vendimet merren me procedurën e vendimmarrjes së përbashkët (neni 251 i Traktatit të Komunitetit Europian) pas këshillimit me Komitetin Ekonomik e Social dhe Komitetin e Rajoneve. Megjithatë mbeten akoma disa raste të veçanta:

- masat të cilat do të kishin një ndikim të madh në nivelin e jetesës, në punësim dhe në shfrytëzimin e mjeteve të transportit miratohen me unanimitet nga Këshilli pas këshillimit me Parlamentin Europian dhe me Komitetin Ekonomik dhe Social
- masat e veçanta në lidhje me transportin ajror dhe detar, Këshilli me shumicë të cilësuar vendos për procedurën që do të zbatohet në secilin rast.

Politika e Përbashkët Tregtare. Komuniteti ka përgjegjësi të veçantë për Politikën e Përbashkët Tregtare (neni 133 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 113). Sipas kësaj politike është vendosur bashkimi doganor ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit, ku ndryshimet në tarifa rregullohen nga parime standarde. Gjithashtu janë përfunduar marrëveshjet tregtare dhe tarifore me vendet jo anëtare, politika e import-eksportit etj. Vendimet merren me shumicë të cilësuar në Këshill.

Traktati i Amsterdimit ndryshoi nenin 113 për të lejuar që Këshilli me votë unanime të shtrinte qëllimin e Politikës së Përbashkët Tregtare në negociata ndërkombëtare dhe marrëveshje për shërbimet dhe pronësinë intelektuale. Traktati i Nisës ndryshoi gjithashtu Nenin 113 për të mundësuar që marrëveshje të tilla të përfundonin me shumicë të cilësuar votash. Megjithatë ka disa përjashtime në lidhje me marrëveshjet në sektorët për të cilët përgjegjësia ndahet ndërmjet Shteteve Anëtare dhe Komunitetit të cilat kërkojnë unanimitet. Përjashtime të tilla përfshijnë tregtinë në shërbime audiovizive dhe në shërbime arsimore.

Politika Europiane e Mbrojtjes dhe Sigurisë. Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë përfshin kuadrin aktual të politikës së përbashkët të mbrojtjes që mund të çojë në një mbrojtje të përbashkët. Kjo politikë e krijuar në Këshillin Europian të Këlnit në 1999, lejon që Bashkimi Europian të zhvillojë kapacitetet e veta qytetare dhe ushtarake për menaxhimin e krizës dhe të parandalojë konfliktin në nivel ndërkombëtar duke ndihmuar në këtë mënyrë për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare në përputhje me Kartën e OKB-së. Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë nuk përfshin krijimin e një ushtrie europiane, por po zhvillohet në pajtueshmëri dhe bashkërendim me NATO-n.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, në Traktatin e Bashkimit Europian (Titulli V) janë përfshirë detyra të reja. Kjo risi lidhet me misionet humanitare dhe të shpëtimit, të ruajtjes së paqes dhe përdorimit të forcave të luftimit në menaxhimin e krizës, duke përfshirë misionin për vendosjen e paqes (të njohura si "detyrat e Petersbergut"). Përveç këtyre operacioneve qytetare dhe ushtarake për menaxhimin e krizës, Politika Europiane e Mbrojtjes dhe e Sigurisë përfshin mundësinë e parandalimit të konfliktit.

Komiteti Politik dhe i Sigurisë, Komiteti Ushtarak i Bashkimit Europian dhe Stafi Ushtarak i Bashkimit Europian janë struktura të përhershme ushtarake dhe politike, përgjegjëse për një politikë autonome dhe operacionale mbrojtëse të Bashkimit Europian. Këshilli Europian i Helsinkit përcaktoi "objektivin global", me fjalë të tjera Bashkimi Europian duhet të dislokojë deri në 60 mijë trupa brenda 60 ditësh dhe për të paktën 1 vit.

Politika monetare. Politika monetare mbulohet nga nenet 105-111 (ish-nenet 105-109) e Traktatit të Komunitetit Europian dhe është themelore për Bashkimin Ekonomik dhe Monetar. Procedurat e vendimmarrjes së përbashkët variojnë sipas çështjeve në fjalë:

- për çështjen e monedhave nga Shtetet Anëtare (neni 106(2)) zbatohet procedura e bashkëpunimit pas këshillimit me Bankën Qendrore Europiane ;
- për formulimin e udhëzuesve të politikës së kursit të këmbimit (neni 111(2)) Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas rekomandimit nga Banka Qendrore Europiane ose nga Komisioni dhe pas këshillimit me Bankën Qendrore Europiane;
- për masat zbatuese të referuara në Statutin e Sistemit Europian të Bankave Qendrore (neni 107(6)), kufijtë dhe kushtet sipas së cilave Banka Qendrore Europiane ka të drejtën të vërë gjoba (neni (3)) Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas rekomandimit nga Banka Qendrore Europiane ose pas këshillimit me Parlamentin Europian dhe me Komisionin;
- për rregullime teknike të statutit të Sistemit Europian të Bankave Qendrore (neni 107(5)) Këshilli vendos me shumicë të cilësuar pas rekomandimit nga Banka Qendrore Europiane ose pas këshillimit me Komisionin dhe pas pëlqimit të Parlamentit Europian;
- Për kursin e këmbimit të Euros ndaj valutave jokomunitare (neni 111(1)) Këshilli vendos me unanimitet pas rekomandimit nga Banka Qendrore Europiane ose nga Komisioni, si dhe pas këshillimit me Parlamentin Europian;

Dispozitat institucionale (neni 112-115) dhe kalimtare (neni 116-124) të Titullit VII të Traktatit të Komunitetit Europian (politika ekonomike dhe monetare-ish kreu VI) kanë procedurat e tyre të veçanta të vendimmarrjes, të cilat janë të ndara nga procedurat e identifikuara këtu.

Politika për ndërmarrjet. Qëllimi i politikës për ndërmarrjet është lehtësimi i krijimit dhe zhvillimit të ndërmarrjeve ose industrive brenda Bashkimit Europian.

Komisioni Europian bashkërendon iniciativat e Shteteve Anëtare në këtë fushë, ndërsa Këshilli, pas propozimeve të Komisionit dhe këshillimit me Parlamentin Europian, vendos me unanimitet për masat e përcaktuara për të përkrahur iniciativat e Shteteve Anëtare.

Politika për ndërmarrjet i lejon ndërmarrjet t'u përshtaten ndryshimeve strukturore dhe të shtrihen veçanërisht në ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Kjo politikë ka

gjithashtu për qëllim të nxisë bashkëpunimin ndërmjet ndërmarrjeve dhe t'i inkurajojë ato që të shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e kërkimeve, zhvillimeve teknologjike dhe risive.

Në Këshillin Europian në Lizbonë më 23-24 mars 2000, krerët e shteteve dhe të qeverisë deklaruan se qëllimi i Bashkimit Europian ishte që të bëhej ekonomia më dinamike e konkurruese në botë deri në 2010. Politika për ndërmarrjet po ndihmon për të arritur këtë qëllim duke nxitur frymën e sipërmarrjes dhe risive përmes përdorimit më të mirë të përfitimeve të sugjeruara nga tregu i brendshëm, me anë të bashkërendimit të politikave në Shtetet Anëtare duke standardizuar ose shkëmbyer përvojat më të mira dhe me anë të tregtisë elektronike.

Politika Sociale. Traktati i Amsterdimit përfshin Marrëveshjen e Politikës Sociale të nënshkruar nga katërmbëdhjetë Shtetet Anëtare në Traktatin e Komunitetit Europian, duke i dhënë fund një shteteve të ndërlikuar. Nga viti 1993 deri në vitin 1999 kanë ekzistuar dy baza ligjore të veçanta për masat e politikës sociale: vetë Traktati i Komunitetit Europian dhe një marrëveshje e veçantë, për të cilën Mbretëria e Bashkuar përdori klauzolën e mospjesëmarrjes. Tani të gjitha masat e politikës sociale mund të miratohen mbi bazën e Titullit të ri XI të Traktatit të Komunitetit Europian.

Objektivat e përcaktuara nga Traktati mbështeten në Kartën Europiane Sociale të vitit 1961 dhe Kartën e të Drejtave Themelore Sociale të Punëtorëve të vitit 1999. Objektivat e përfshira më parë në Marrëveshjen e Politikës Sociale mbulojnë: ngritjen në pozitë, mbrojtjen e duhur sociale, dialogun ndërmjet strukturave drejtuese dhe punëtorëve, zhvillimin e burimeve njerëzore dhe luftën kundër përjashtimit social (neni 136).

Në varësi të çështjes, Këshilli vendos:

- ose me anë të procedurës së vendimmarrjes së përbashkët pas këshillimit me Komitetin Ekonomik e Social dhe me Komitetin e Rajoneve;
- ose me unanimitet mbi një propozim të Komisionit pas këshillimit me Parlamentin Europian, Komitetin Ekonomik e Social dhe Komitetin e Rajoneve.

Presidenca e Bashkimit Europian (rotacioni i Presidencës). Presidenca e Bashkimit mbahet për një periudhë 6-mujore nga çdo Shtet Anëtar. Koha e mbajtjes së presidencës është një detyrë dhe kontribut i çdo Shteti Anëtar për funksionimin e duhur të institucioneve të Komunitetit. Shtetet Anëtare e mbajnë presidencën një herë në shtatë vjet e gjysëm.

Në kontekstin e aspektit institucional të negociatave për aderim, është përcaktuar se rregulli i rotacionit ndërmjet 15 Shteteve Anëtare të tanishme do të mbahet deri në vitin 2006, në mënyrë që anëtarëve të rinj t'u jepet një periudhë e shkurtër gjatë së cilës të përshtaten dhe të përgatiten për të marrë presidencën në Këshill.

Në çdo rast, në zgjerimin e vazhdueshëm ky sistem rotacioni po tregon kufizimet e tij dhe Konferenca Ndërqeveritare 2004 do të propozojë një alternativë: një mandat presidencial me rotacion, por më të qendrueshëm, një "President afatgjatë të Europës", ose formula të ndryshme në varësi të formacioneve të ndryshme (Samit, Këshill i Ministrave, Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm).

Presidenti i Komisionit European. Traktati i Amsterdimit forcoi rolin dhe pozitën e Presidentit të Komisionit European. Qeveritë e Shteteve Anëtare caktojnë personin që ata mendojnë të emërojnë President me pëlqim të përbashkët, një zgjedhje kjo që më pas duhet të miratohet nga Parlamenti European.

Më pas qeveritë caktojnë kandidatët për Anëtarë të Komisionit, në marrëveshje me Presidentin e ri. Presidenti përcakton linjat kryesore të politikës për t'u ndjekur nga Komisioni në punën e tij. Ai gjithashtu vendos për shpërndarjen e portofoleve ndërmjet komisionerëve dhe për çdo rishpërndarje të portofoleve gjatë mandatit të Komisionit.

Traktati i Nisës, i cili hyri në fuqi më 1 shkurt 2003, ka ndryshuar procedurat për emërimin e Presidentit. Tani e në vazhdim, takimi i Këshillit European në nivel kryetarësh shtetesh dhe qeverish do të caktojë kandidatin me shumicë të cilësuar. Më pas, Parlamenti European bën miratimin e këtij emërimi.

Neni i ri 217 i Traktatit të Komunitetit European gjithashtu zgjeron kompetencat e Presidentit si një mjet thelbësor për sigurimin e rrjedhës së vazhdueshme logjike dhe efektivitetit të një trupi të zgjeruar të komisionerëve. Kjo do të thotë se Presidenti vendos për organizimin e brendshëm të Komisionit, shpërndarjen e portofoleve, si dhe çdo rishpërndarje të portofoleve gjatë mandatit të Komisionit. Gjithashtu, në varësi të miratimit të përbashkët të Komisionit, ai emëron zëvendës presidentët, numri i të cilëve nuk përcaktohet në Traktat. Presidenti mund të kërkojë dorëheqjen e një anëtari të Komisionit, sërish në varësi të miratimit të Kolegjit.

Konventa Europiane që u krijua nga Deklarata e Laeken-it në dhjetor 2001, merret me çështjet e reformës institucionale dhe me të ardhmen e Presidentit të Komisionit. A duhet ndryshuar sërish metoda e emërimit të Presidentit? (një e drejtë më e madhe për Parlamentin, zgjedhjet e drejtpërdrejta). A duhet zëvendësuar roli i tij nga një President i Europës pranë Këshillit dhe/ose Komisionit? A duhet përzgjedhur ndërmjet kryetarëve të shteteve?

Procedura e bashkëpunimit. Procedura e bashkëpunimit (neni 252 i Traktatit të Komunitetit European, ish neni 189c) u prezantua me Aktin Unik European. Kjo procedurë i ka lejuar Parlamentit European dy "lexime" duke rritur kështu ndikimin në procesin legjislativ. Fillimisht, qëllimi i kësaj procedure u zgjerua me Traktatin e Mاستrihit. Traktati i Amsterdimit e ndryshoi më pas këtë tendencë duke nxitur procedurën e vendimmarrjes së përbashkët (neni 251 i Traktatit të Komunitetit European). Procedura e bashkëpunimit tani do të zbatohet vetëm në fushën e Bashkimit Ekonomik dhe Monetar (nenet 99(5) dhe 106(2) të Traktatit të Komunitetit European).

Procedura e bashkëpunimit fillon gjithmonë me një propozim nga Komisioni i cili i dërgohet Këshillit dhe Parlamentit Europian. Pas leximit të parë, Parlamenti jep një mendim për propozimin e Komisionit. Këshilli me shumicë të cilësuar harton një qëndrim të përbashkët, i cili i dërgohet Parlamentit së bashku me të gjithë informacionin e nevojshëm dhe arsyet që e çuan Këshillin në miratimin e këtij qëndrimi të përbashkët. Parlamenti analizon këtë qëndrim të përbashkët gjatë leximit të dytë dhe brenda tri muajsh mund ta miratojë, ta ndryshojë ose ta refuzojë atë. Në dy rastet e fundit, duhet të veprohet me shumicë absolute nga anëtarët. Nëse propozimi refuzohet, Këshilli duhet të vendosë me unanimitet për një lexim të dytë.

Më pas, brenda një muaji Komisioni rishqyrton propozimin mbi të cilin Këshilli u mbështet për qëndrimin e përbashkët dhe i dërgon propozimet e tij Këshillit, i cili me dëshirën e tij mund të përfshijë ose të përjashtojë ndryshimet e propozuara nga Parlamenti. Brenda tri muajsh, Këshilli me shumicë të cilësuar mund të miratojë propozimin e ri të shqyrtuar, ta ndryshojë me unanimitet, ose të miratojë gjithashtu me unanimitet ndryshimet që nuk janë marrë parasysh nga Komisioni.

Në procedurën e bashkëpunimit, Këshilli mund të ushtrojë të drejtën e vetos duke refuzuar të shprehë mendimin e tij për ndryshimet e propozuara nga Parlamenti Europian, ose për propozimet e ndryshuara nga Komisioni, duke e bllokuar kështu procedurën legjislativë.

Konventa Europiane e krijuar nga Deklarata e Laeken-it në dhjetor 2001 ka për detyrë të hartojë propozime që synojnë lehtësimin e procedurave për miratimin e akteve të ndryshme të Komunitetit, prandaj e ardhmja e bashkëpunimit merret në konsideratë.

Procedura e vendimmarrjes së përbashkët. Procedura e vendimmarrjes së përbashkët (neni 251 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 189b) u prezantua në Traktatin e Mاستrihit. Kjo procedurë i jep Parlamentit Europian kompetenca për të miratuar akte së bashku me Këshillin. Procedura përfshin një, dy ose tre nivele. Efekti i saj është rritja e kontakteve ndërmjet Parlamentit dhe Këshillit, ligjvënësve dhe Komisionit Europian. Praktikisht, ka forcuar kompetencat legjislativë të Parlamentit në fushat e mëposhtme: lëvizjen e lirë të punëtorëve, të drejtën e vendosjes, shërbimeve, tregun e brendshëm, arsimin, shëndetësinë, politikën e konsumatorit, rrjetet trans-europiane, mjedisin (program i përgjithshëm masash), kulturën dhe kërkimet shkencore (program kuadër).

Traktati i Amsterdami ka thjeshtuar procedurën e vendimmarrjes së përbashkët duke e bërë më të shpejtë, më efektive dhe duke forcuar rolin e Parlamentit Europian. Përveç kësaj ky rol është rritur në fusha të reja si përjashtimi social, shëndeti publik dhe lufta kundër mashtrimit që ndikon në interesat financiare të Komunitetit Europian.

Natyra demokratike e Komunitetit kërkon që Parlamenti të marrë pjesë në ushtrimin e kompetencave ligjvënëse. Kështu që, çdo instrument ligjvënës i miratuar me shumicë të cilësuar, bëhet pjesë e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët. Në shumicën e rasteve, vendimmarrja e përbashkët në Parlament shkon paralel me votimin me shumicë të cilësuar në Këshill. Megjithatë për disa

dispozita të Traktatit, vendimmarrja e përbashkët dhe unanimiteti ekzistojnë akoma.

Traktati i Nisës i vë pjesërisht kapak kësaj situatë. KNQ e shkurtit 2000 kërkon një shtrirje të qëllimit të vendimmarrjes së përbashkët, paralelisht edhe si rritje të përdorimit të votimit me shumicë të cilësuar në Këshill. Gjashtë dispozita për të cilat KNQ planifikoi të zbatonte votim me shumicë të cilësuar, i nënshtohen procedurës së vendimmarrjes së përbashkët. Ato janë: iniciativa për të luftuar diskriminimin, bashkëpunimin gjyqësor në çështjet civile, masat e veçanta të përkrahjes industriale, masat e kohezionit ekonomik dhe social (jashtë Fondeve Strukturore), statuti për partitë politike europiane dhe masat në lidhje me vizat, azilin dhe emigracionin.

Në anën tjetër, KNQ nuk e shtriu procedurën e vendimmarrjes së përbashkët në masat legjislative që kërkojnë votim me shumicë të cilësuar (si politika bujqësore dhe tregtare). Prandaj për të gjitha vendimet legjislative nuk ka lidhje përcaktimi i votimit me shumicë të cilësuar apo procedurës së vendimmarrjes së përbashkët.

Procedura e këshillimit. Sipas procedurës së këshillimit, Parlamenti Europian jep mendimin e vet për propozimet e Komisionit. Në rastet e parashikuara në Traktat, Këshilli duhet të këshillohet me Parlamentin Europian përpara se të votohet për propozimin e Komisionit dhe merr parasysh pikëpamjet e tij. Megjithatë, Këshilli është i detyruar të këshillohet me Parlamentin, pavarësisht nga pozita e tij. Nëse Këshilli i shmaget shumë propozimit fillestar, mendimi i Parlamentit duhet të merret sërish. Kompetencat e Parlamentit janë të kufizuara sipas kësaj procedure aq sa mund të shpresohet që Komisioni të marrë parasysh ndryshimet në një propozim të ndryshuar.

Përveç rasteve të parashikuara në Traktate, Këshilli duhet të këshillohet me Parlamentin Europian edhe për çështjet më të rëndësishme. Këshillimi është me dëshirë. Përveç kësaj, kjo procedurë këshillimi përdoret për miratimin e instrumenteve jo të detyrueshme, veçanërisht, rekomandimeve dhe mendimeve që nxirren nga Këshilli dhe Komisioni.

Konventa Europiane, e krijuar me Deklaratën e Laeken-it në dhjetor 2001, ka për detyrë hartimin e propozimeve që synojnë thjeshtimin e procedurave për miratimin e akteve të ndryshme të Komunitetit. Prandaj, kjo Konventë rishqyrton mundësinë për këshillim në të ardhmen.

Procedura e pëlqimit. Procedura e pëlqimit u prezantua me Aktin Unik Europian.

Kjo procedurë kërkon që Këshilli të marrë pëlqimin e Parlamentit përpara se të merren vendime të rëndësishme. Parlamenti Europian mund të pranojë të refuzojë një propozim, por nuk mund ta ndryshojë atë. Nëse Parlamenti Europian nuk e jep pëlqimin e tij, akti në fjalë nuk mund të miratohet.

Procedura e pëlqimit zbatohet më shumë për aderimin e Shteteve të reja Anëtare (neni 49 i Traktatit të Bashkimit Europian), për marrëveshjet e asociimit dhe për marrëveshje të tjera themelore me vendet e treta (neni 300 i Traktatit të Komunitetit Europian), si edhe për emërimin e Presidentit të Komisionit.

Procedura e pëlqimit përdoret gjithashtu për çështjet e qytetarisë, për detyrat specifike të Bankës Qendrore Europiane, për ndryshimet e Statutit të Sistemit Europian të Bankave Qendrore dhe Bankës Qendrore Europiane, për Fondin e Kohesionit dhe Fondin Strukturor, si edhe për procedurën standarte për zgjedhjet e Parlamentit Europian.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, kërkohet pëlqimi i Parlamentit për sanksione që i vihen një Shteti Anëtar për shkelje të rënda ose të vazhdueshme të të drejtave themelore sipas nenit të ri 7-të i Traktatit të Bashkimit Europian. Traktati i Nisës e ka bërë të detyrueshëm pëlqimin e Parlamentit, ku parashikohet bashkëpunimi i përforcuar ndërmjet disa Shteteve Anëtare në një fushë që kërkon procedurën e vendimmarrjes së përbashkët.

Konventës Europiane pas Deklaratës në Laeken në dhjetor 2001 iu kërkua thjeshtimi i procedurave për miratimin e akteve të ndryshme komunitare, prandaj merret parasysh procedura e pëlqimit.

Procedura standarde zgjedhore, Statuti për deputetët e Parlamentit Europian dhe partitë politike europiane. Sipas nenit 190 të Traktatit të Komunitetit Europian (ish-neni 138), Parlamenti Europian duhet të hartojë propozime për zgjedhjet me votim të drejtpërdrejtë sipas një procedure standarde në të gjitha Shtetet Anëtare, gjë e cila nuk zbatohet tani (ekzistojnë lista rajonale dhe në të njëjtën kohë ato kombëtare). Kjo do të sigurojë paraqitje më të besueshme të prirjeve të ndryshme politike europiane në Parlamentin Europian. Megjithatë, të gjitha propozimet konkrete në të shkuarën bazoheshin në traditat kombëtare zgjedhore.

Një statut i përbashkët për të gjithë deputetët e Parlamentit Europian, i përfshirë në Traktatin e Amsterdimit me kërkesë të Parlamentit Europian, që ka për qëllim eliminimin e ndryshimeve në trajtimin që iu bëhet kombësive dhe sigurimin e një transparence më të madhe, është ende duke u negociuar ndërmjet Parlamentit dhe Këshillit. Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Nisës, Statuti duhet t'i paraqitet Këshillit për miratim me shumicë të cilësuar, me përjashtim të dispozitave fiskale që duhet të japin një vizion të besueshëm për marrëveshje mbi një çështje që është në pritje që nga viti 1998.

Traktati i Nisës i ka shtuar nenit 191 të Traktatit të Komunitetit Europian një bazë ligjore që lejon miratimin nëpërmjet procedurës së vendimmarrjes së përbashkët, të një statuti për partitë politike të nivelit europian në veçanti, kriteret për njohjen e tyre dhe rregullat që drejtojnë financimet e tyre. Një propozim i është paraqitur tashmë Parlamentit Europian.

Programi i ndihmës komunitare për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore (Phare). Programi Phare u paraqit në vitin 1989 pas rënies së regjimeve komuniste në Europën Qendrore dhe Lindore. Ky program synonte të ndihmonte këto vende të rindërtonin ekonomitë e tyre. Fillimisht, programi Phare prekte vetëm Poloninë dhe Hungarinë, por u zgjerua gradualisht duke përfshirë dhjetë vende të Europës Qendrore dhe Lindore (Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë, Sllovakinë dhe Slloveninë).

Në të njëjtën kohë, programi Phare është instrumenti kryesor financiar për strategjinë e para-aderimit të dhjetë vendeve të Europës Lindore dhe Qendrore të cilat kanë aplikuar për anëtarësimi në Bashkimin European. Që nga viti 1994 detyrat e programit Phare u janë përshtatur përparësive dhe nevojave të secilit prej këtyre vendeve.

Programi i hartuar Phare, me një buxhet prej 10 miliard Euro për periudhën 2000-2006, ka tashmë dy përparësi të veçanta, konkretisht:

- ngritjen e institucioneve
- financimin e investimeve.

Në vijim të propozimeve të parashtruara nga Komisioni në komunikatën e tij Axhenda 2000 në korrik 1997, forma të reja të ndihmës së para-aderimit i janë shtuar ndihmës të parashkuar në programin Phare. Këto janë:

- Masa strukturore për të afruar nivelin e mbrojtjes mjedisore dhe të zhvillimit të infrastrukturës së transportit të vendeve kandidate me nivelin e Bashkimit European (Instrumenti Strukturor Para Aderimit);
- Ndihmë për bujqësinë (Programe të veçanta të aderimit për zhvillimin bujqësor dhe rural). Buxheti i programit Phare për vitin 2002 ishte 1.664 miliard Euro.

Pronësi intelektuale. Ashtu si mallrat e prekshme, krijimet intelektuale mund të përbëjnë pronësi që përcaktohet si "pronësi intelektuale". Pronësia intelektuale mbulon dy fusha:

- Pronësinë industriale, që përfshin patentat, modelet e skicat, prodhuesit dhe firmat e shërbimit dhe skicimet e mbrojtura të origjinës,
- Të drejtën e autorit dhe të drejtat e lidhura me të, që zbatohen për të gjitha veprat letrare dhe artistike.

Kjo fushë mbulon çështjet kulturore, sociale dhe teknologjike me rëndësi të veçantë që duhet të merren parasysh kur hartohen politika koherente. Kështu, për çështjen e pronësisë industriale, rregulloret e Komunitetit janë përpjekur të harmonizojnë kushtet për regjistrimin e markave dhe t'ju japin përdoruesve mbrojtjen e siguruar nga disa rregulla. Në dhjetor 2001, u miratua një rregullore që prezantoi një projekt të Komunitetit. Bashkimi European për të inkurajuar risitë po punon edhe për krijimin e një patente komunitare.

Në lidhje me çështjen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të, legjislacioni i harmonizuar i Komunitetit u hartua në fusha ku pasiguria ligjore mund të pengonte shfrytëzimin e të drejtave në disa territore (programe kompjuteri dhe baza të dhënash, transmetim satelitor dhe ritransmetimi kabllor, e drejta për huadhënie dhe huamarrje dhe disa të drejta të tjera). Legjislacioni European u përshtat për të marrë parasysh sfidat e reja që solli progresi teknologjik dhe shoqëria e informacionit. Masat për të luftuar falsifikimin dhe piraterinë janë trajtuar në nivel european.

Protokolli i Kiotos. I miratuar në dhjetor 1997, protokollin e Konventës Kuadër të OKB-së për ndryshimin e klimës identifikon qëndrimin e ri ndërkombëtar të Komunitetit në lidhje me fenomenin e ndryshimit klimatik. Sipas këtij protokollin, vendet e industrializuara kanë marrë përsipër të ulin prodhimin e gjashtë gazeve të efektit serë me 5% gjatë periudhës 2008-2012 krahasuar me nivelet në 1990.

Shtetet Anëtare nga ana e tyre kanë marrë përsipër të ulin prodhimin e këtyre gazeve në të njëjtën periudhë me 8%.

Në vitin 2000, prodhimet globale të gjashtë gazeve të efektit serë në vendet e Bashkimit Europian ishin 3.5% nën nivelet e 1990.

Në 31 maj 2002, Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare ratifikuan protokollin e Kiotos. Megjithatë, ky protokoll nuk është akoma në fuqi.

Punësimi. Punësimi është një nga shqetësimet kryesore të Shteteve Anëtare pasi ka shifra të larta në Bashkimin Europian (reth 7.7%). Pas Librit të Bardhë për rritjen, konkurrueshmërinë dhe punësimin, Këshilli Europian i Ezenit (9 dhe 10 dhjetor 1994) identifikoi 5 fusha parësore për nxitjen e punësimit:

- përmirësimi i mundësive të punësimit me nxitjen e investimeve në formimin profesional
- rritja e përqendrimit të punësimit në zhvillim
- ulja e kostove të punës së papaguar
- rritja e efektshmërisë së politikave të tregut të punës
- përmirësimi i ndihmës për grupet që janë të prekura nga papunësimi

Këshilli dhe Komisioni paraqitën një raport të përbashkët për masat e marra për këto pesë përparësi në Këshillin Europian të Dublinit (13 dhe 14 dhjetor 1996).

Po kështu, Pakti i Konfidencës për Punësimin i paraqitur në qershor 1996 kërkon të mobilizojë të gjithë aktorët e lidhur me strategjinë e punësimit, për ta bërë atë një çështje të interesit të përbashkët në nivel europian dhe për të përfshirë luftën kundër papunësisë në vizionin afatmesëm dhe afatgjatë të shoqërisë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, punësimi tani konsiderohet si një nga objektivat e Komunitetit Europian. Komuniteti ka përgjegjësi të punojë për një strategji punësimi së bashku me Shtetet Anëtare. Për këtë qëllim, në Traktatin e Komunitetit Europian është shtuar një kapitull i ri për punësimin (Titulli VIII). Sipas tij:

- punësimi të konsiderohet në politika të tjera komunitare
- mekanizma të bashkërendimit të përcaktohen në nivel komunitar (miratim i udhëzimeve për punësimin në përputhje me udhëzimet e përgjithshme të politikës ekonomike çdo vit nga këshilli, mbikqyrje e zbatimit të tyre në Shtetet Anëtare, krijimi i një komiteti punësimi)
- Këshilli me shumicë të cilësuar të miratojë masa nxitëse, duke përfshirë projektet pilot dhe rekomandimet për Shtetet Anëtare, në dritë të rishqyrtimit të përvitshëm të politikave të tyre të punësimit.

Në një samit të jashtëzakonshëm për punësimin të mbajtur në 21 nëntor në Luksemburg 1997, u ra dakord që Strategjia Europiane për Punësimin të përqendrohet në 4 çështje: punëzënia, sipërmarrja, përshtatshmëria dhe mundësitë e barabarta. Më pas, Shtetet Anëtare vendosën të paraqesin aplikimin e vitit 1998 të dispozitave për bashkërendimin e politikave të punësimit.

Në samitin europian në Lisbonë në mars 2000, krerët e shteteve dhe qeverisë arritën marrëveshjen për një qëllim të ri strategjik për Bashkimin: të bëhet ekonomia më konkurruese, më dinamike në botë dhe e bazuar në njohuri si edhe të jetë e aftë për rritje të qëndrueshme ekonomike, punë më të mira dhe kohezion më të madh social.

Për arritjen e punësimit të plotë në Bashkimin Europian deri në vitin 2010, komunikata e re për të ardhmen e Strategjisë europiane të punësimit e publikuar në janar 2003, përcaktoi disa përparësi:

- 1- uljen e nivelit të papunësisë,
- 2- inkurajimin e grave për të hyrë në tregun e punës,
- 3- inkurajimin e njerëzve në moshën e pensionit të vazhdojnë të punojnë,
- 4- nxitjen e të mësuarit gjatë gjithë jetës,
- 5- luftën kundër punës së zezë.

Qartësia e Traktateve (thjeshtimi i Traktateve). Bashkimi Europian është krijuar gradualisht dhe struktura e tij është rezultat i një sërë ndryshimesh në traktate të ndryshme. Kjo ka çuar në një situatë ku mungesa e qartësisë dhe lexueshmërisë së teksteve themeluese të Bashkimit Europian ka krijuar një boshllëk ndërmjet Bashkimit Europian dhe publikut.

Traktati i Romës u pasua nga Akti Unik Europian dhe Traktati i Bashkimit Europian (Traktati i Mastrohitit). Ky traktat krijoi një strukturë të re, Bashkimin Europian, përveç Komunitetit Europian, i cili përbëhet nga tri shtylla (Komunitetet Europiane, Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë dhe bashkëpunimi në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme). Traktati i Nisës dhe ai i Amsterdambit përmbajnë ndryshime të traktateve të mëparshme dhe një sistem të ri të numërimit të neneve. Traktateve i janë shtuar disa anekse dhe protokolle.

Deklarata në Laeken në dhjetor 2001 mbledhi Konventën Europiane për të përgatitur reformën e institucioneve europiane dhe për të konsoliduar traktatet me qëllim që të ishin më shumë në dorë të publikut.

Përsa i takon thjeshtimit të traktateve, Deklarata shtron pyetjet e mëposhtme:

- Riorganizim të traktateve: a duhet të bëhet dallim ndërmjet një traktati bazë dhe dispozitave të tjera të traktatit?
- Thjeshtëzim: A duhet të rishqyrtohet dallimi ndërmjet Bashkimit dhe Komuniteteve? Po ndarja në tri shtylla?
- Kushtetuta: A duhet të hartohet një tekst kushtetute?
- Çfarë statusi duhet të ketë Karta e të Drejtave Themelore?

Në Tetor 2002, Presidenti i Konventës propozoi paraprakisht një projekt traktat kushtetues në tri pjesë:

Pjesa 1 trajton arkitekturën institucionale,

Pjesa 2 trajton politikat dhe masat e Bashkimit Europian

Pjesa 3 trajton dispozitat përfundimtare dhe kalimtare, si dhe dispozitat për vazhdimësinë ligjore tipike për këtë akt kushtetues.

Konventa paraqiti rezultatet e diskutimit në qershor 2003.

Qeverisja. Debati për qeverisjen europiane i nisur nga Komisioni në Librin e Bardhë në Korrik 2001 ka të bëjë me të gjitha rregullat, procedurat dhe praktikat që ndikojnë në ushtrimin e kompetencave brenda Bashkimit Europian. Qëllimi është që të miratohen forma të reja qeverisjeje të cilat e afrojnë Bashkimin Europian me qytetarët europianë, e bëjnë më efektive dhe përforcojnë demokracinë në Europë, si edhe konsolidojnë ligjshmërinë e institucioneve. Kjo qeverisje duhet të qëndrojë në kuadër dhe në zbatim të politikave më të mira

dhe më të qëndrueshme që lidhin organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet europiane. Qeverisja përfshin gjithashtu përmirësimin e legjislacionit European duke e bërë atë më të qartë dhe më efektiv. Për më tej, Bashkimi European duhet të kontribuojë në debatin për qeverisjen botërore dhe të luajë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e veprimeve të institucioneve ndërkombëtare.

Qëndrim i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European). Qëndrimi i përbashkët u prezantua me Traktatin e Mاستrihtit nën drejtimin e bashkëpunimit në fushat e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Traktati i Amsterdimit e përmban këtë instrument në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (bashkëpunim policor dhe gjyqësor në çështjet penale).

Qëndrimi i përbashkët është një instrument ligjor i cili bën të mundur që Këshilli të përcaktojë orientimin e Bashkimit European për disa çështje specifike. Shtetet Anëtare duhet të fuqizojnë, si në politikën e brendshme, ashtu dhe në politikën e jashtme, vendimet e miratuara me unanimitet në takimet e Këshillit.

Qëndrim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë).

Qëndrimi i përbashkët në kontekstin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë bën më sistematik bashkëpunimin dhe përmirëson bashkërendimin e tij. Shtetet Anëtare duhet të bien dakord dhe të mbajnë ato qëndrime, të cilat janë miratuar me unanimitet në takimet e Këshillit.

Qytetaria e Bashkimit European. Qytetaria e Bashkimit është në varësi të shtetësisë së njërit nga Shtetet Anëtare. Me fjalë të tjera, kushdo që ka shtetësinë e një Shteti Anëtar është qytetar i Bashkimit European. Përveç të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në Traktatin Themelues të Komunitetit European, qytetaria e Bashkimit parashikon katër të drejta të veçanta:

- Liria për të qarkulluar dhe për të banuar në Bashkimin European
- E drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur në zgjedhjet vendore dhe në Parlamentin European në Shtetin Anëtar ku banon
- Mbrojtje diplomatike dhe konsullore në një vend të tretë nga autoritetet e çdo shteti anëtar, kur Shteti Anëtar shtetësinë e të cilit ai ka, nuk është i përfaqësuar
- E drejta e peticionit dhe ankimit tek Ombudsmani (Avokati i Popullit) european.

Sigurisht që nocioni i qytetarisë së Bashkimit nuk e zëvendëson shtetësinë e Shteteve Anëtare, por i shtohet asaj. Kjo i jep qytetarit të thjeshtë një ndjenjë më të thellë dhe më konkrete përkatësie në Bashkimin European.

Rajonet më të largëta. Ekzistojnë shtatë "rajone më të largëta": Guadalupe, Guajana franceze, Martinik, Reunion (katër departamente të huaja franceze të referuara në nenin 299(2) të Traktatit të Komunitetit European, ishujt e Azoreve, Kanareve dhe Madeira. Ato i nënshtrohen një deklaratë që i është shtuar Traktatit.

Deklarata pranon se këto rajone vuajnë nga një prapambetje e madhe strukturore dhe thekson se, ndonëse dispozitat e Traktatit të Komunitetit European dhe legjislacioni dytësor gjejnë automatikisht zbatim, është i mundshëm miratimi i masave specifike për t'i ndihmuar këto vende për aq kohë sa ekziston një nevojë reale, objektive, në mënyrë që këto masa të nxisin zhvillimin ekonomik dhe social të tyre.

Neni 299 (2) është ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit për të bërë të mundur që Këshilli, i cili vepron me shumicë të cilësuar, të miratojë vendime të veçanta që krijojnë kushtet për zbatimin e Traktatit, përfshirë këtu edhe politika të përgjithshme në rajonet më të largëta. Në këtë mënyrë, Këshilli duhet të sigurojë që integriteti dhe vijueshmëria logjike e rendit ligjor të Komunitetit të mos rezikohen.

Riformulimi i legjislacionit. Riformulimi i legjislacionit do të thotë miratim i një akti të ri ligjor që përfshin ndryshimin që i bëhet aktit bazë, por që anulon dhe zëvendëson këtë të fundit. Ndryshe nga kodifikimi zyrtar, përfshihen edhe ndryshime thelbësore. Riformulimi i legjislacionit bën gjithashtu një përmbledhje të përgjithshme të një fushe të legjislacionit. Akti i ri ligjor botohet në Fletoren Zyrtare (seritë L).

Rishikimi i Traktateve. Neni 48 (ish-neni N) i Traktatit të Komunitetit European përbën bazën ligjore që mundëson mbledhjen e një konferencë me përfaqësues të qeverive të Shteteve Anëtare (Konferencë Ndërqeveritare) me qëllim ndryshimin e traktateve. Sipas këtij neni, për ndryshime të tilla çdo Shtet Anëtar, apo Komisioni, mund t'i paraqesë Këshillit propozime. Në rast se Këshilli, pasi është këshilluar me Parlamentin dhe me Komisionin, është në favor të mbledhjes së një konference, kjo e fundit mbledhet nga Presidenti i Këshillit. Çdo ndryshim vijues hyn në fuqi dy muaj pasi është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat e tyre përkatëse kushtetuese.

- RR -

Rrathë bashkëqendrorë. Ky koncept përfshin një Europë të strukturuar nga nënndarjet e shteteve që kanë fituar nivele të ndryshme integrimi. Ai nuk kufizohet vetëm me strukturën e integritit të Bashkimit European dhe kjo ide është përforcuar nga një numër figurash të shquara. Disa prej tyre flasin për "rrethin e të drejtës së ndarë" (Shtetet Anëtare të Bashkimit European), "rrethin fqinj" (vendet jashtë Bashkimit European në pritje për t'u anëtarësuar) dhe "rrathët më të zgjedhur" për qëllim të bashkëpunimit më të madh (rrethi i monedhës, i mbrojtjes e kështu me radhë).

Rrjetet Trans-Europiane. Me Aktin Unik European (1986) funksionimi i mirë i një tregu të vetëm është i lidhur në mënyrë të pakthyeshme me objektivin e kohezionit ekonomik dhe social. Megjithatë, lëvizja e lirë e njerzëve, mallrave dhe kapitalit nuk ka zbutur mospërputhjet rajonale dhe kombëtare brenda Bashkimit European. Për pasojë, ndërlihdja dhe ndërveprimi i rrjeteve kombëtare të infrastrukturës janë kthyer në faktor kyç për planifikimin e saktë të territorit të Komunitetit.

Titulli XV i Traktatit të Amsterdimit parashikon bazat ligjore për Rrjetet Trans-Europiane. Për periudhën 2000-2006, për Rrjetet Trans-Europiane është rezervuar në buxhet një shumë totale prej 4.6 miliard euro, të cilës i duhen shtuar kontributet nga Fondi European i Zhvillimit Rajonal, Fondi i Kohezionit, Banka Europiane e Investimeve dhe Fondi European i Investimeve.

Rrjetet Trans-Europiane ekzistojnë në tre sektorë të veprimtarisë:

- Rrjetet Trans-Europiane të Transportit me projekte të përparësive të mëdha që mbulojnë transportin rrugor dhe atë të kombinuar, rrugët detare e portet detare, si dhe rrjetin hekurudhor të shpejtë. Sistemet e menaxhimit të transportit janë gjithashtu në këtë kategori si për shembull projekti "Galileo" i vendosjes gjeografike me bazë satelitore.
- Rrjetet Trans-Europiane të Energjisë kanë të bëjnë me sektorët e energjisë dhe gazit natyror. Objektivat e tyre janë vendosja e një tregu të vetëm energjie dhe arritja e sigurisë së furnizimit.
- Rrjetet Trans-Europiane të Telekomunikacionit kërkojnë të vënë në veprim shërbimet elektronike bazuar në rrjetet e telekomunikacionit. Të përqendruar kryesisht në shërbimet publike, ato janë në qendër të iniciativës eEurope "Shoqëri informacioni për të gjithë".

Zgjerimi i ardhshëm drejt vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore ka përforcuar më tej rëndësinë e RRITE-ve duke zgjeruar qëllimin e tyre në përfshirjen e të gjithë kontinentit. Duke vazhduar më tej, lidhja e tyre efikase me rrjetet e vendeve të treta drejt lindjes (Rusia dhe vendet e Komonuelthit të shteteve të pavarura) ose drejt jugut (vendet mesdhetare) do të ishin pozitive ndaj zhvillimit dhe ekuilibrit ekonomik.

Rrjeti gjyqësor european për çështjet penale. Qëllimi i rrjetit gjyqësor european për çështjet penale lehtëson ndihmën reciproke ligjore në luftën kundër krimit ndërkombëtar. Ky rrjet fillon me një veprim të përbashkët të miratuar nga Këshilli më 29 qershor 1998.

Rrjeti gjyqësor përbëhet nga pika kontakti të krijuara për të bërë të mundur që autoritet gjyqësore lokale dhe autoritet gjyqësore në shtete të tjera anëtare të vendosin kontakte të drejtpërdrejta ndërmjet tyre. Këto pika kontakti sigurojnë informacionin e duhur ligjor ose praktik për të ndihmuar autoritetet që të përgatitin një kërkesë për bashkëpunim gjyqësor.

Ekziston gjithashtu një rrjet gjyqësor european për çështjet civile dhe tregtare i krijuar me Vendimin e Këshillit më 28 maj 2001 dhe i bazuar në rrjetin për çështjet penale.

Siguria ushqimore. Bashkimi European e ka bërë sigurinë ushqimore një nga prioritetet kryesore të axhendës politike europiane. Siguria ushqimore është një objektivi horizontal që merret parasysh në disa fusha të kompetencës së Komunitetit: në Politikën e Përbashkët Bujqësore dhe shtyllën e zhvillimit rural, mjedisin, shëndetin publik, mbrojtjen e konsumatorëve dhe tregun e brendshëm.

Në janar të vitit 2000 debati publik që filloi me Librin e Gjelbër për parimet e përgjithshme të sigurisë ushqimore, çoi në publikimin e Librit të Bardhë, i cili shënon një hap të rëndësishëm në miratimin e një ligji të ri për ushqimin. Në këtë dokument Komisioni njoftoi zhvillimin e një kuadri ligjor që mbulon gjithë zinxhirin ushqimor "nga ferma tek piruni" në përputhje me një orientim të integruar global. Sipas kësaj logjike, siguria ushqimore lidhet me ushqimin, shëndetin, mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve, kontrollet veterinarë, masat për shëndetin e kafshëve, kontrollet e bimëve, përgatitjen dhe higjienën e ushqimeve. Gjithashtu Libri i Bardhë thekson nevojën për të filluar dialog të vazhdueshëm me konsumatorët për t'i informuar, për t'i arsimuar dhe për t'i dëgjuar.

Rregullorja e miratuar në shkurt 2002, që formon bazat për legjislacionin e ri për sigurinë ushqimore, përcakton pesë parime të përgjithshme themelore:

- miratimin e natyrës së integruar të zinxhirit ushqimor
- analizën e riskut si element bazë i kësaj politike
- përgjegjësinë e operatorëve në këtë sektor
- përcaktimin e origjinës së prodhimeve në çdo fazë të zinxhirit ushqimor
- të drejtat e qytetarëve për informacion të qartë dhe të saktë.

Është krijuar gjithashtu Autoriteti European për Sigurinë Ushqimore, detyrat kryesore të të cilit janë të sigurojë opinione të pavarura specifike për çështjet e sigurisë ushqimore, të mbledhë dhe të analizojë të dhënat për ndonjë rrezik të mundshëm dhe të mbajë një dialog të vazhdueshëm me publikun.

Strategji para-aderimi. Në vitin 1993 në bazë të Marrëveshjeve të Europës (marrëveshjet e asociimit me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore), Komisioni propozoi një 'dialog strukturor' ndërmjet vendeve të asociuara dhe institucioneve të Bashkimit në formën e takimeve, ku partnerët mund të konsultohen me njëri-tjetrin.

Në dhjetor të vitit 1994, Këshilli European i Esenit miratoi një strategji para-aderimi bazuar në:

- thellimin e marrëdhënieve ndërmjet vendeve të asociuara, Shteteve Anëtare dhe institucioneve të Bashkimit (përforcimi i dialogut të strukturuar);
- zbatimin e Marrëveshjeve të Europës;
- përshtatjen e ndihmës financiare të dhënë nga programi Phare.

Në dhjetor 1997 në Këshillin Europian të Luksemburgut u paraqit një strategji para-aderimi e përforcuar për dhjetë vendet aplikante të Europës Qendrore dhe Lindore. Ajo bazohet në:

- Marrëveshjet Europiane
- Partneritetin për aderim dhe programet kombëtare për miratimin e *acquis*;
- Pjesëmarrjen në programe, agjenci dhe komitete të caktuara të Komunitetit.

Në të njëjtin vit u vendos edhe një strategji e veçantë para-aderimi për Qipron. Në vitin 1998 u miratua një strategji për Maltën, dhe strategjia e fundit është duke marrë formë edhe për Turqinë. Strategjitë e para-aderimit për Turqinë dhe Maltën bazohen në:

- Marrëveshjet e asociimit;
- Partneritetet për aderim dhe programet kombëtare për miratimin e *acquis*;
- Pjesëmarrjen në programet, agjensitë dhe komitetet e Komunitetit;
- Ndihmën e veçantë para-aderimit;
- Në rastin e Turqisë, një dialog politik të përforcuar.

Ndihma e para aderimit për Bullgarinë dhe Rumaninë u rrit ndjeshëm në Këshillin Europian të Kopenhagenit më 12 dhe 13 dhjetor 2002.

Strategji e Përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë).

Strategjia e Përbashkët është një instrument i ri i prezantuar me Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë në Traktatin e Amsterdimit.

Sipas nenit të ri 13 të Traktatit të Bashkimit Europian, Këshilli Europian përcakton parimet dhe udhëzimet e përgjithshme për Politikën e Përbashkët të Jashtme e të Sigurisë dhe vendos për strategjitë e përbashkëta që duhen zbatuar nga Bashkimi Europian në fusha ku Shtetet Anëtare kanë interesa të përbashkëta të rëndësishme.

Me një fjalë, një strategji e përbashkët përcakton qëllimet dhe periudhën kohore që mbulohet si edhe mjetet që duhet të vihen në dispozicion nga Bashkimi Europian dhe Shtetet Anëtare. Strategjitë e përbashkëta zbatohen nga Këshilli duke miratuar në veçanti qëndrime dhe veprime të përbashkëta.

Strategjia Europiane për Punësimin. Traktati i Amsterdimit prezantoi konceptin e një Strategjie Europiane për Punësimin e cila vijon nga një strategji e integruar për punësim e paraqitur në Këshillin Europian të Esanit në dhjetor 1994.

Në Esen Këshilli Europian u kërkoi Shteteve Anëtare të hartojnë programe shumëvjeçare për punësimin dhe t'i dërgojnë Komisionit raporte për zbatimin e tyre. Këto raporte përshkruajnë masat kryesore të marra nga qeveritë për zbatimin e programeve të tyre shumëvjeçare gjatë 12 muajve të kaluar, në disa raste, ato përshkruajnë ndikimin e masave në punësim dhe për njoftimin e ndryshimeve e mëdha ose nismave të reja në këtë fushë.

Strategjia Europiane për Punësimin është ndërtuar rreth temave prioritare nën katër shtyllat e punësimit, sipërmarrjes, përshtatshmërisë, dhe mundësive të barabarta. Çdo vit, Shtetet Anëtare hartojnë Plane Kombëtare Veprimi për Punësimin në zbatim të udhëzimeve të përgjithshme të politikës. Planet Kombëtare të Veprimit për Punësimin analizohen nga Komisioni dhe nga Këshilli. Rezultatet e paraqitura në një Raport të Përbashkët për Punësimin shërbejnë si bazë për të caktuar prioritetet dhe për t'i dërguar rekomandime Shteteve Anëtare në lidhje me politikat e tyre të punësimit.

Pesë vjet pas prezantimit të këtij raporti, strategjia europiane hyn në fazën e shqyrtimit.

Në janar 2003, Komisioni miratoi një komunikatë, e cila paraqet një drejtim të ri me anë të Strategjisë Europiane për Punësimin, që i përshtatet më mirë nevojave të një popullsie duke rritur pjesëmarrjen e gruas në tregun e punës, zgjerimin dhe përshtetësinë e ritmit të ndryshimit ekonomik. Prioritetet kryesore të strategjisë së re janë punësimi i plotë dhe kushte më të mira pune.

Statuti i shërbimit publik. Statuti i shërbimit publik shtron idenë e një instrumenti i cili parashtron të drejtat dhe parimet bazë që drejtojnë sigurimin e shërbimeve për përdoruesit. Parime të tilla do të përfshinin:

- Vazhdimësinë e shërbimeve
- Cilësinë
- Sigurinë e ofrimit të shërbimeve
- Të drejtë të barabartë përdorimi
- Çmime të përballueshme
- Pranueshmëri sociale, kulturore dhe mjedisore.

Subsidiariteti. Parimi i subsidiaritetit ka për qëllim të sigurojë që vendimet të merren sa më afër të jetë e mundur me qytetarët dhe që të kryhen kontrole të vazhdueshme mbi faktin nëse veprimet në nivelin e Komunitetit justifikohen nën dritën e mundësive të mundshme në nivel kombëtar, rajonal apo vendor. Në mënyrë më të qartë, ky është një parim me anë të të cilit Bashkimi Europian nuk ndërmer asnjë veprim (me përjashtim të fushave që janë nën kompetencat e tij ekskluzive) në qoftë se ai nuk është më efikas në nivel kombëtar, rajonal apo vendor. Ky parim është i lidhur mjaft ngushtë me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë, të cilët kërkojnë që çdo veprim i Bashkimit Europian të mos shkojë përtej asaj që është e nevojshme për arritjen e objektivave të Traktatit.

Këshilli Europian i Edinburgut i mbajtur në dhjetor 1992 përcaktoi parimet bazë të subsidiaritetit dhe vendosi udhëzimet për interpretimin e nenit 5 (ish neni 3b), i cili ngushton parimin subsidiaritetin në Traktatin e Bashkimit Europian. Përfundimet e tij u paraqitën në një deklaratë që shërben ende si themeli i parimit të subsidiaritetit.

Në Traktatin e Amsterdamin përçasje e përgjithshme që ishte vijim i kësaj deklaratë, u përfshi në një Protokoll për zbatimin e parimeve të subsidiaritetit dhe proporcionalitetit, të shtuara në Traktatin e Këshillit Europian. Analiza sistematike e ndikimit të propozimeve legjislativë mbi parimin e subsidiaritetit dhe përdorimi, në ato raste ku është e mundur, i masave më pak detyruese të Komunitetit paraqiten në këtë Protokoll.

Çdo vit Komisioni Europian nxjerr një raport ("Ligje më të mira") për Këshillin Europian dhe Parlamentin Europian, që i përkushtohet më shumë zbatimit të parimit të subsidiaritetit.

Konventa mbi reformën institucionale e krijuar me Deklaratën e Laekenit në dhjetor 2001 përgatiti me anë të Grupit të Punës mbi "Subsidiaritetin" propozime për të marrë parasysh këtë parim pa lënë mënjanë thjeshtësimin e legjislativës. Konventa sugjeron ngritjen e një sistemi politik monitorues (me anë të një sistemi të paralajmërimit për parlamentet kombëtare, që të japin një mendim të arsyetuar mbi një propozim të Komisionit) ose një sistemi kontrolli gjyqësor (krijimi i dhomave të subsidiaritetit brenda Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian, me qëllim përforcimin e monitorimit ex post). Gjithashtu u trajtua edhe mundësia e shfuqizimit të Protokollit mbi subsidiaritetin dhe zëvendësimit të tij me një numër nënesh në traktatin e ri.

- SH -

Shengen (Marrëveshja dhe Konventa). Nëpërmjet Marrëveshjes së nënshkruar në Shengen më 14 qershor 1985, Belgjika, Franca, Gjermania, Luksenburgu dhe Holanda ranë dakort të hiqnin në mënyrë graduale kontrollet e tyre të përgjithshme kufitare, dhe të lejonin kalimin e lirë të gjithë personave që ishin shtetas të Shteteve Anëtare që kishin nënshkruar marrëveshjen, të Shteteve të tjera Anëtare ose të vendeve të treta.

Konventa e Shengenit u nënshkrua nga po këto pesë shtete më 19 qershor 1990, por hyri në fuqi vetëm në vitin 1995. Ajo përcakton rregullat dhe garancitë për zbatimin e lirisë së lëvizjes.

Marrëveshja dhe Konventa, rregullat e miratuara mbi atë bazë dhe marrëveshjet e lidhura me to formojnë të ashtuquajturën “*acquis* për Shengenin”. Përfshirja e *acquis* për Shengenin në Traktate drejtohet nga një protokoll i Traktatit të Amsterdimit. Më qëllim për të formuar një bazë ligjore, ishte e domosdoshme ndarja e *acquis* për Shengenin nën shtyllën e parë (Titulli i ri IV – Vizat, azili, emigracioni dhe politikat e tjera, të lidhura me qarkullimin e lirë të personave) të Traktatit themelues të Komunitetit Europian ose nën shtyllën e tretë (Titulli VI – Dispozitat mbi bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale) të Traktatit të Bashkimit Europian. Përfshirja ligjore e Shengenit në Bashkim u shoqërua me integrimin e institucioneve. Këshilli mori përsipër Komitetin Ekzekutiv të Shengenit, ndërsa Sekretariati i Përgjithshëm i Këshillit mori përsipër Sekretariatit e Shengenit.

Protokollit i shtuar në shtojcën e Traktatit të Amsterdimit pohon se *acquis* për Shengenin dhe rregullat e miratuara nga institucionet mbi bazën e *acquis* duhet të miratohen në tërësinë e tyre nga të gjitha vendet aplikante.

Zona e Shengenit u zgjerua gradualisht: Italia nënshkroi në vitin 1990, Spanja dhe Portugalia në 1991, Greqia në 1992, Austria në 1995 dhe Danimarka, Finlanda e Suedia në 1996. Gjithashtu palë të Konventës janë edhe Islanda dhe Norvegjia.

Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar nuk janë palë e marrëveshjeve, por sipas protokollit të Traktatit të Amsterdimit, ato mund të marrin pjesë në disa ose në të gjitha marrëveshjet e kësaj *acquis* në rast se të 13 Shtetet Anëtare, të cilat janë palë e marrëveshjeve dhe përfaqësuesit e qeverive të vendeve në fjalë, votojnë me unanimitet brenda Këshillit. Kështu, në mars 1999 Mbretëria e Bashkuar kërkoi të merrte pjesë në disa fusha të caktuara të bashkëpunimit sipas marrëveshjes Shengen, përfshirë bashkëpunimin policor dhe gjyqësor në çështjet penale, luftën kundër drogës dhe Sistemin Shengen të Informimit. Këshilli miratoi vendimin për pranimin e kërkesës në maj 2000. Në qershor 2000 dhe në nëntor 2001, Irlanda kërkoi të merrte pjesë në disa fusha të veprimtarisë së Shengenit, duke përfshirë të gjitha dispozitat për zbatimin dhe funksionimin e Sistemit Shengen të Informimit. Këshilli miratoi vendimin për pranimin e kërkesës së Irlandës në shkurt 2002.

Gjithashtu, megjithëse Danimarka është një nga palët nënshkruese të Konventës së Shengenit, ajo ka të drejtë të zgjedhë në kontekstin e Bashkimit Europian në se do zbatohet ose jo çdo vendim të ri, të marrë mbi bazën e *acquis* për Shengenin.

Shëndeti publik. Shëndeti publik mbulohet në nenin 152 të Traktatit të Komunitetit Europian (ish neni 129), i cili u prezantua me Traktatin e Mاستritit. Në këtë nen thuhet se veprimi i Komunitetit duhet të përqendrohet në parandalimin e sëmundjeve, përfshirë edhe përdorimin e drogës, duke nxitur kërkimet për zbulimin e shkaqeve dhe transmetimin e tyre, si edhe në informimin shëndetësor dhe arsimimin. Traktati i Amsterdimit i përforcon këto objektiva me kusht që përcaktimi dhe zbatimi i të gjitha politikave dhe veprimtarive të Komunitetit të sigurojë një nivel më të lartë të mbrojtjes shëndetsore.

Sipas nenit 15, veprimet për të arritur këto qëllime mund të përfshijnë masat e Komunitetit, veprime plotësuese nga Shtetet Anëtare. Megjithatë, përfaqja kryesore duhet të jetë nxitja e bashkëpunimit ndërmjet Shteteve Anëtare në një linjë me parimin e subsidiaritetit.

Sipas rregullave institucionale, Këshilli miraton iniciativa mbi bazën e procedurës së vendimmarrjes së përbashkët, ndërsa rekomandimet miratohen me shumicë të cilësuar në bazë të propozimit të Komisionit. Traktati i Amsterdimit zgjeron qëllimin e veprimeve në procedurën e vendimmarrjes së përbashkët për përfshirjen e masave që përcaktojnë standarde të larta të cilësisë dhe sigurisë së organeve dhe substancave me origjinë humane, si edhe masa veterinare dhe fitosanitare.

Shërbimet audiovizive. Politika e Komunitetit për shërbimet audiovizive duhet të respektojë interesa dhe prioritete të ndryshme dhe disa herë kontradiktore, si: rregullat e konkurrencës (sidomos në lidhje me Ndhmën Shtetërore), rregullat mbi pronësinë intelektuale dhe parimet e shërbimit publik. Tregu evropian audioviziv po përballlet edhe me një sërë problemesh që përfshijnë:

- Pengesat gjuhësore që parandalojnë qarkullimin e lirë të programeve;
- Procesin e vështirë të vendimmarrjes, i cili në përgjithësi kërkon unanimitet;
- Nevojën për investime të konsiderueshme që kërkojnë aleanca ndërkombëtare dhe/ose shkrirje për të paraprirë zhvillimet teknologjike

Veprimtaria e Komunitetit në fushën audiovizive është zhvilluar në dy drejtime:

- Në frontin industrial, në vitin 1986 u miratua direktiva për të siguruar standartizimin e sistemeve të përdorura në Shtetet Anëtare për transmetimin e programeve satelitore dhe kabllore. Në vitin 1989 u përcaktuan objektiva për zhvillimin e televizionit me qartësi të lartë. Pastaj në vitin 1991, u prezantua një standart i vetëm për prodhimin e televizionit me qartësi të lartë dhe mbështjetja financiare për një program bashkëpunimi ndërmjet bizneseve të interesuara. Në vitin 1993 u miratua një plan veprimi për të promovuar formatin 16/9;
- Në frontin ligjor, Direktiva për Televizionin Pa Kufi, u miratua në vitin 1989 dhe u ndryshua në vitin 1997, duke siguruar një kuadër të harmonizuar për nxitjen e lëvizjes së lirë, prodhimin dhe shpërndarjen e programeve televizive europiane. U prezantuan rregulla të përbashkëta për reklamimin, sponsorizimin, mbrojtjen e të miturve (masa kundra programeve me natyrë të

dhunshme apo pornografike) dhe e drejta e përgjigjes. Direktiva prezantoi dhe kuota të shpërndarjes, duke u kërkuar operatorëve televizivë të caktojnë, kur është e mundur, më shumë se gjysmën e kohës së tyre të transmetimit për çështjet europiane.

Për më tepër, në vitin 2001, programi komunitar MEDIA (masa për të nxitur zhvillimin e industrisë audiovizive) mbështeti industrinë audiovizive europiane duke inkurajuar zhvillimin dhe shpërndarjen e prodhimeve europiane. Ky program financon gjithashtu skema për përmirësimin e trainimit të profesionistëve në sektor.

Programi MEDIA Plus (2000-2005), që vijon nga MEDIA II (1996-2000), ka një buxhet prej 4 milion euro.

Traktati i Amsterdimit, i miratuar në qershor 1997, shtoi një protokoll mbi sistemin e transmetimit publik. Roli i Shteteve Anëtare përta i përket stacioneve shtetërore është i qartë: Shtetet Anëtare mund të vazhdojnë të financojnë shërbimin publik, me kusht që financimi të mos ndikojë as në treg, as në konkurrencën në sektor.

Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm. Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm quhen shërbimet tregtare të interesit së përgjithshëm ekonomik, mbi të cilën autoritetet publike vënë detyrime të veçanta të shërbimit publik (neni 86 i Traktatit të Komunitetit Europian, ish neni 90-të). Shembujt e parë janë shërbimet e transportit, energjisë dhe komunikacionit.

Neni i ri 16-të iu shtua Traktatit të Komunitetit Europian nga Traktati i Amsterdimit, duke pranuar vendin e zënë nga shërbimet me interes ekonomik të përgjithshëm në vlerat e përbashkëta të Bashkimit Europian dhe rolin e tyre në nxitjen e kohezionit social dhe territorial. Gjithashtu Neni 16-të përcakton se shërbime të tilla duhet të veprojnë mbi bazën e parimeve dhe kushteve që mundësojnë përmbushjen e funksioneve të tyre.

Shërbime me interes të përgjithshëm. Shërbime me interes të përgjithshëm janë shërbime që konsiderohen të tilla nga autoritetet publike dhe i nënshtrohen detyrimeve specifike të shërbimeve publike. Ato përfshijnë shërbime jo tregtare (p.sh. arsim i detyrueshëm, mbrojtje sociale), detyrime të shtetit (p.sh. siguria dhe drejtësia) dhe shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm (p.sh. energjia dhe komunikimet). Neni 86 i Traktatit (ish neni 90) nuk zbatohet për dy kategoritë e para (shërbime jo tregtare dhe detyrime shtetërore).

Shërbimi publik. Koncepti i shërbimit publik është një koncept i dyanshëm. Ai përfshin të dy organet që sigurojnë shërbime, si edhe shërbimet me interes të përgjithshëm që ato ofrojnë. Detyrimet e shërbimit publik mund të imponohen nga autoritetet publike mbi organin që siguron shërbimin (shoqëritë e linjave ajrore, transporti rrugor apo hekurudhor, prodhues energjie e kështu me radhë) në nivel kombëtar ose rajonal. Koncepti i shërbimeve publike dhe koncepti i

sektorit publik (përfshirë edhe shërbimin civil) shpesh ngatërrohen gabimisht. Ato ndryshojnë përsa i përket funksionit, statusit, pronësisë dhe "klientelës".

Shërbimi universal. Shërbimi universal është një koncept i trajtuar nga institucionet e Komunitetit. Ai i referohet grupit të kërkesave me interes të përgjithshëm. Shërbime të tilla si telekomunikacioni dhe posta duhet të sigurohen në të gjithë Komunitetin në përgjigje të këtyre kërkesave. Qëllimi është që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të përfitojnë shërbime cilësore me një çmim të arsyeshëm.

Shoqëria e informacionit. Shoqëria e informacionit është term sinonim me "teknologji të reja informacioni dhe komunikimi" (ICT). Që në fillim të viteve 90', ICT të reja kanë filluar të zhvillohen. Përdorimi universal i shkëmbimit elektronik të informacionit, kthimi drejt teknologjive dixhitale, rritja eksponenciale e përdorimit të internetit dhe hapja e tregjeve të telekomunikacionit janë shenja të këtij ndryshimi.

Shoqëria e informacionit po bën revolucion në shumë fusha të jetës së përditshme, veçanërisht në trajnim dhe njohuri (mësimi në distancë, shërbimet e lidhura me *e-learning*), në organizimin e punës dhe mobilizimin e aftësive (puna nëpërmjet televizionit, kompanitë virtuale), në jetën praktike (shërbimet *e-health*) dhe argëtimin. Gjithashtu sigurohen mundësi të reja në lidhje me pjesëmarrjen e qytetarëve për ta bërë më të lehtë shprehjen e mendimit dhe pikëpamjeve.

Megjithatë, këto ecuri pozitive shkojnë paralel me problemet e reja. Përdorimi në masë i internetit do të thotë që janë bërë hapa kundër krimit, piraterisë, dhe çështjes së mbrojtjes të të dhënave personale dhe pronësisë intelektuale. Gjithashtu shoqëria e informacionit mund të kontribuojë në kufizimin e disa sektorëve të shoqërisë duke theksuar pabarazi sociale.

Në dritë të këtyre përfitimeve dhe kërcënimeve të mundshme, Bashkimi Europian e ka vënë shoqërinë e informacionit në zemër të strategjisë së saj për shekullin XXI. Mes të tjerave, janë hedhur hapa për përkrahjen dhe promovimin (plani i veprimit *e-Europe*), si dhe janë miratuar masa të cilat synojnë kontrollin dhe kufizimin e rrezikut që lidhet me zhvillimin e shoqërisë së informacionit, si një plan veprim që synon të nxisë përdorimin e sigurt të internetit dhe luftën kundër mesazheve të paligjshme dhe të dëmshme.

Shtyllat e Bashkimit Europian. Në të folurën e Komunitetit, njerëzit u referohen shpesh tri shtyllave të Traktatit të Bashkimit Europian. Këto janë:

- dimensionet e Komunitetit, duke përfshirë rregullat e përcaktuara në Traktatet e Komunitetit Europian, Komunitetit Europian të Qymyrit dhe Çelikut dhe Euratom, d.m.th., qytetaria e Bashkimit Europian, politikat e Komunitetit, Bashkimi Ekonomik dhe Monetar, etj. (shtylla e parë);
- Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë, përcaktuar në Titullin V të Traktatit të Bashkimit Europian (shtylla e dytë);

- bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet penale, përcaktuar në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European (shtylla e tretë).

Traktati i Amsterdimit ka transferuar disa nga fushat e përfshira në shtyllën e tretë tek shtylla e parë (lëvizja e lirë e personave).

Shumica e cilësuar. Shumica e cilësuar nënkupton numrin e votave të nevojshme në Këshill për miratimin e një vendimi, kur diskutohen çështje mbi bazën e nenit 205 (2) të Traktatit të Komunitetit European (ish-neni 148 (2)). Deri më 1 nëntor 2004, data e hyrjes në fuqi të dispozitave të Traktatit të Nisës mbi vendimmarrjen e Këshillit, kufiri minimal për shumicën e cilësuar është përcaktuar numri 62 nga 87 vota (71%). Votat e Shteteve Anëtare ndahen mbi bazën e popullsisë së tyre dhe rregullohen në favor të vendeve me popullsi më të vogël, si vijon: Franca, Gjermania, Italia dhe Mbretëria e Bashkuar nga 10 vota secila; Spanja 8 vota, Belgjika, Greqia, Holanda dhe Portugalia 5 vota; Austria dhe Suedia 4 vota; Danimarka, Irlanda dhe Finlanda 3 vota; Luksenburgu 2 vota.

Me Konferencën Ndërqeveritare 2000 dhe Traktatin e Nisës, numri i votave të shpërndara secilit Shtet Anëtar është ripeshuar, veçanërisht, për ato Shtete me popullsi më të madhe, në mënyrë që legjitimiteti i vendimeve të Këshillit të mund të mbrohet për sa i përket aspektit të përfaqësimit të tyre demografik.

Traktati i Nisës ndryshoi edhe sistemin e vendimmarrjes me shumicë të cilësuar. Shumica e cilësuar plotësohet atëherë kur plotësohen dy kushte:

- 1- vendimi merr një numër të caktuar votash (që do të ndryshojë me hyrjen e vendeve të reja)
- 2- kur shumica e Shteteve Anëtare kanë rënë dakort.

Gjithashtu, një Shtet Anëtar mund të kërkojë që të verifikohet fakti se shumica e cilësuar përfaqëson të paktën 62% të popullsisë totale të Bashkimit. Në rast se kjo nuk përmbushet, vendimi nuk miratohet.

Meqë reformat institucionale kanë hyrë në fuqi, votimi me shumicë të cilësuar ka zëvendësuar votimin unanimitet, i cili është më pak i frytshëm për zhvillimin e një politike operacionale të Komunitetit (reziku i votës).

Rezultatet e Konferencës të fundit Ndërqeveritare janë në përputhje me këtë pasi 27 dispozita të reja po kalojnë në tërësi ose pjesërisht nga unanimiteti në shumicën e cilësuar, duke përfshirë fusha, si: bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile, kontrata tregtare mbi shërbimet ose pronësinë intelektuale, politika e kohezionit (nga viti 2007 e në vazhdim), politika industriale, masa për lehtësimin e lëvizjes së lirë të shtetasve, bashkëpunimi ekonomik, financiar dhe teknik me vendet e treta, si edhe emërimi i anëtarëve të disa institucioneve të caktuara. Kalimi në votim me shumicë të cilësuar nuk u pranua për politikën sociale dhe atë të tatimeve.

Gjithashtu, shumica e masave legjislative që sipas Traktatit të Nisës, kërkojnë një shumicë të cilësuar, do të vendosen nga procedura e vendimmarrjes së përbashkët. Megjithatë, Konferenca Ndërqeveritare nuk e zgjeroi procedurën e

e vendimmarrjes së përbashkët në masat legjislative që sot janë nën sistemin e shumicës së cilësuar (si për shembull: politika e përbashkët bujqësore dhe tregtare). Kështu, lidhja ndërmjet shumicës së cilësuar dhe procedurës së e vendimmarrjes së përbashkët nuk është e detyrueshme për të gjitha vendimet legjislative.

Shumica e cilësuar e përforcuar. Në Konferencën Ndërqeveritare të vitit 1996, e cila çoi në miratimin e Traktatit të Amsterdimit, ideja e shumicës së cilësuar të përforcuar u hodh si nga një numër i madh i delegacioneve kombëtare, ashtu edhe nga Komisioni Europian. Ky propozim lindi nga bindja se, në rast se unanimiteti ruhet në një Bashkim të zgjeruar, në shumicën e rasteve do të përfundojë në një bllokim të plotë. Rrjedhimisht, në raste të caktuara unanimiteti mund të zëvendësohet nga një shumicë e cilësuar e përforcuar e cila është më e lartë se përfaqësimi normal i votave të kërkuara zakonisht për votimin e shumicës.

Në dhjetor 2001, në kuadrin e Konventës Europiane të ngritur nga Deklarata e Laekenit, u sugjerua që shumica e cilësuar të përdorej për miratimin e atij paragrafi të Traktatit Kushtetues të Bashkimit Europian i cili përfshin parimet bazë. Kjo do të mundësonte gjetjen e një rregulli të ndërmjetëm midis unanimitetit (burim për bllokim pune) dhe shumicës së cilësuar, që është e pamjaftueshme për sa i takon përfaqësimit për miratimin e teksteve bazë.

Shumicë e dyfishtë. Në dritën e zgjerimit, janë paraqitur zgjidhje për të ruajtur ekuilibrin ndërmjet vendeve "të vogla" dhe të "mëdha" në vendimmarrje në Këshillin e Ministrave. Pas zgjerimit ruajtja e sistemit të tanishëm të peshimit të votave në Këshill, mund të rezultojë në shumicë të cilësuar që përfaqëson vetëm një pakicë të popullsisë së Bashkimit Europian. Për këtë arsye, Shtetet Anëtare me popullsi më të madhe kërkuar një sistem ripeshimi/ose shumicë të dyfishtë e cila do të sigurojë që shumica në Këshill të përfaqësojë jo vetëm Shtetet Anëtare, por edhe popullsinë e Bashkimit Europian.

Të dyja zgjidhjet u diskutuan me hollësi në Konferencën Ndërqeveritare në 1996-1997 që çoi në Traktatin e Amsterdimit.

Sistemi i shumicës së dyfishtë i dha një votë secilit Shtet Anëtar, por për marrjen e një vendimi kërkohet prania e shumicës së Shteteve Anëtare që përfaqësojnë shumicën e popullsisë. Meqë nuk u arrit asnjë marrëveshje për propozimin në Konferencë Ndërqeveritare, Traktatit iu shtua një protokoll mbi institucionet.

Në këtë protokoll, Shtete të mëdha Anëtare (Gjermania, Spanja, Franca, Italia, BM) bien dakord të humbasin komisionierin e dytë pas zgjerimit, me kusht që ripeshimi i votave në Këshill të jetë në favor të tyre. Këto shtete shohin një lidhje të ngushtë ndërmjet çështjes së pakësimit të numrit të komisionerëve dhe të vendimmarrjes në Këshill.

Protokolli parashikon që të mbledhet një Konferencë Ndërqeveritare përpara se anëtarësia e Bashkimit Europian të kalojë numrin 20, me qëllim që të shqyrtohen

rregullat për funksionimin e institucioneve të Bashkimit European dhe, mbi të gjitha, të merret një vendim përfundimtar për vendimmarrjen në Këshill.

KNQ e shkurtit 2000 vendosi të miratojë një sistem të ripeshimit të votave brenda Këshillit, të kombinuar me një shumicë të dyfishtë apo të trefishtë, si kërkesë për miratimin e një instrumenti brenda Këshillit. Ndërsa ky ripeshim i votave funksionon në favor të Shteteve Anëtare, shumica e cilësuar duhet të jetë dhe shumicë e Shteteve Anëtare. Kjo kombinohet me një sistem që njihet si "rrjeti i sigurisë demografike", i cili do të thotë që secili Shtet Anëtar mund të kërkojë verifikim, në se shumica e cilësuar përfaqëson të paktën 62% të popullsisë së Bashkimit. Në se kushti nuk plotësohet, vendimi nuk mund të miratohet. Këto rregulla të reja do të hyjnë në fuqi më 1 nëntor 2004.

Telekomunikacioni. Me qëllim plotësimin e tregut të brendshëm, liberalizimi i telekomunikacionit u bë përparësi e Komunitetit European në vitin 1987 (Libër i Gjelbër mbi zhvillimin e tregut të përbashkët për shërbimet dhe pajisjet e telekomunikacionit). Në vitin 1988, me anë të një direktive, tregjet e terminaleve të telekomunikacionit u hapën ndaj konkurrencës.

Në fazën e dytë të këtij zhvillimi, një direktivë e miratuar në vitin 1990 liberalizoi shërbimet e telekomunikacionit por jo ato të telefonisë së zëshme (dëgjimore). Në vitin 1994 ajo u zgjerua për komunikimet satelitore dhe, më pas në vitin 1996 për rrjetet e televizionit kabllor dhe për telefoninë celulare. Në të njëjtën kohë, një infrastrukturë e telekomunikacionit të hapur dhe rrjeti i shërbimeve u vu në veprim nga viti 1990. Miratimi i rregullave të përbashkëta lejoi harmonizimin e kushteve për të drejtë hyrjeje në treg të operatorëve të rinj. Në vitin 1993, Këshilli i Ministrave vendosi të liberalizojë plotësisht shërbimet e telefonisë së zëshme (dëgjimore) nga data 1 janar 1998.

Në vitin 1994, në kontekstin e një "Shoqërie Informacioni" në zhvillim, struktura të përgjithshme të liberalizimit të telekomunikacioneve u paraqitën si mënyra për zhvillimin e multimedias. Iniciativa të ndryshme u miratuan për harmonizimin e standardeve të komunikimeve me celular (standardi european i vetëm GSM) dhe atyre satelitore, si dhe për rrjetin e shërbimeve dixhitale të integruara.

Në vitin 1999, Komisioni European nisi detyrën e riformulimit të kuadrit rregullator european për telekomunikacionet. Qëllimi i përgjithshëm ishte përmirësimi i të drejtës për përdorim në shoqërinë e informacionit duke vendosur një ekuilibër ndërmjet rregullores së sektorit dhe rregullave të Europës për konkurrencën. Kuadri i ri rregullator, referuar edhe si "paketa telekoms", përbëhet nga pesë direktiva harmonizimi:

- 1- Direktiva kuadër
- 2- Direktiva mbi të drejtën e përdorimit dhe ndërlihdjen
- 3- Direktiva mbi autorizimin
- 4- Direktiva mbi shërbimin universal dhe të drejtat e përdoruesve
- 5- Direktiva mbi privacinë.

Këto u shoqëruan nga Vendimi i vitit 2002 mbi politikën e spektrit të radios dhe nga Rregullorja, e miratuar gjithashtu në vitin 2002, mbi të drejtën e përdorimit të çarkut lokal. Komuniteti European po nxit dhe mbështet në mënyrë aktive vënien në përdorim të komunikimit celular të brezit të tretë (3G).

Televizioni pa kufij. Direktiva "Televizioni Pa Kufij" është themeli i politikës audiovizive në Komunitetin European. I miratuar në vitin 1989 dhe i ndryshuar në vitin 1997, direktiva ka dy parime bazë:

- Lëvizja e lirë e programeve televizive europiane brenda tregut të përbashkët
- Kërkesa për rezervim nga ana e kanaleve televizive, sa herë që është e mundur, për më shumë se gjysmën e kohës së transmetimit për çështjet europiane ("kuotat e transmetimit").

Paralelisht me këto parime bazë, direktiva "Televizioni Pa Kufij" synon të mbrojë objektiva të caktuara, të rëndësishme dhe me interes publik, të tilla, si: larmia kulturore, mbrojtja e të miturve (masa kundër programeve me natyrë të dhunshme apo pornografike) dhe e drejta e përgjigjes. Gjithashtu u prezantuan rregulla të detajuara mbi përmbajtjen dhe frekuencën e reklamave televizive.

Që nga qershori 2001, Direktiva Televizioni Pa Kufij ka qenë në proces rishikimi. Në këtë kontekst, Komisioni European duhet të publikojë një plan pune duke përcaktuar temat për diskutim dhe afatet kohore përkatëse.

Të drejtat e njeriut. Praktika gjyqësore e Gjykatës së Drejtësisë e Bashkimit European pranon parimin e parashikuar në Konventën e të Drejtave të Njeriut. Respektimi i të drejtave të njeriut u konfirmua nga Shtetet Anëtare në parathënien e Aktit Unik 1986 dhe më vonë u përfshi në nenin 6-të (ish neni F) të Traktatit të Bashkimit European, i cili bazohet në Konventën e mësipërme dhe ndan traditat kushtetuese të Shteteve Anëtare.

Garancia e respektimit të të drejtave themelore është përforcuar më tej nga Traktati i Amsterdimit, i cili ka shtrirë juridiksionin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit European për të përfshirë respektin për të drejtat që rrjedhin nga neni 6-të në lidhje me veprimin e institucioneve të Bashkimit European. Në të njëjtën kohë, një klauzolë e re pezullimi parashtron cilat veprime të ndërmerren në rastet kur një Shtet Anëtar shkel seriozisht dhe vazhdimisht parimet mbi të cilat është ngritur Bashkimi European.

Titulli V i Traktatit të Bashkimit European (PPJS). Titulli V i Traktatit të Bashkimit European, i njohur gjithashtu si "shtylla e dytë", përmban dispozitat që përcaktojnë një politikë të përbashkët të jashtme dhe të sigurisë. Ky titull përfshin nenet 11-28.

Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European. I shtuar nga Traktati i Mاستrihtit, Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European ("shtylla e tretë") përmban dispozita që vendosin bashkëpunim në fushën e drejtësisë dhe të punëve të brendshme.

Traktati i Amsterdimit ka transferuar një numër të madh fushash nga Titulli VI në Titullin e ri IV të Traktatit të Komunitetit European ("Vizat, azili, imigrimi dhe politika të tjera të lidhura me lëvizjen e lirë të njerzëve"). Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet kriminale mbetet në Titullin VI të Bashkimit European, i cili përmbledh katërmbëdhjetë nene (nenet 29 – 42).

Titulli IV i Traktatit të Komunitetit European dhe Titulli VI i Traktatit të Bashkimit European përbëjnë tashmë bazat ligjore për një zonë lirie, sigurie dhe drejtësie.

Trajtimi i barabartë i burrave dhe grave. Në vitin 1957 neni 141 (ish neni 119) i Traktatit të Komunitetit Europian parashtroi parimin që burrat dhe gratë duhet të shpërblehen njësoj për punë të njëjtë. Po në vitin 1975, një sërë direktivash e kanë zgjeruar parimin për të mbuluar të drejtën e punësimit, kualifikimit dhe karrierës, me qëllim eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit në punë. Trajtimi i barabartë përfshiu më vonë sigurimet shoqërore, skemat statutoare dhe skemat e punësimit. Në vitin 1980, pranimi i këtij parimi çoi në nxitjen e mundësive të barabarta përmes programeve shumëvjeçare.

Traktati i Amsterdimit i shtohet nenit 141 (që është i kufizuar në qëllim dhe mbulon vetëm shpërblimin e njëjtë) duke përfshirë nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave si një nga detyrat e Komunitetit përcaktuar në nenin e 2-të të Traktatit të Komunitetit Europian.

Karta e të Drejtave Themelore, e miratuar në dhjetor 2000, përfshin kapitullin "Barazia" dhe përcakton parimet e barazisë ndërmjet burrit dhe gruas, ku "Barazia ndërmjet burrit dhe gruas duhet të sigurohet në të gjitha fushat, duke përfshirë punësimin, punën dhe shpërblimin".

Në qershor 2000, Komisioni miratoi një Komunikatë "Drejt një Strategjie Kuadër të Komunitetit për Barazinë Gjinore" (2001-2005). Qëllimi i kësaj komunikate është krijimi i një kuadri veprimi brenda të cilit të gjitha veprimtaritë e Komunitetit mund të kontribuojnë për të arritur qëllimin e eliminimit të mosbarazisë dhe nxitjen e barazisë ndërmjet burrave dhe grave.

Traktati i Amsterdimit. Traktati i Amsterdimit është rezultat i Konferencës Ndërqeveritare të paraqitur në Këshillin Europian të Torinos, më 29 mars 1996. Ai u miratua në Këshillin Europian të Amsterdimit më 16 dhe 17 qershor 1997 dhe u nënshkrua më 2 tetor 1997 nga Ministrat e Jashtëm të pesëmbëdhjetë Shteteve Anëtare. Traktati hyri në fuqi më 1 maj 1999 (dita e parë e muajit të dytë mbas ratifikimit nga Shteti Anëtar i fundit), pas ratifikimit nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me kërkesat përkatëse kushtetuese.

Në aspektin ligjor, Traktati ndryshon dispozita të caktuara të Traktatit të Bashkimit Europian, Traktatet themeluese të Komuniteteve Europiane dhe akte të tjera të lidhura me to. Ai nuk zëvendëson Traktatet e tjera, por i bashkëngjitet akteve të lidhura me të.

Traktati i Nisës. I miratuar në dhjetor 2000, në mbyllje të Këshillit Europian të Nisës, dhe i nënshkruar më 26 shkurt 2001, Traktati i Nisës përfundoi Konferencën Ndërqeveritare (KNQ), e cila filloi në shkurt 2000. Objektivi i Traktatit ishte të vinte në lëvizje institucionet europiane për të pranuar Shtete të reja Anëtare.

Ky traktat i hapi rrugën reformës institucionale të nevojshme për zgjerimin e ardhshëm të Bashkimit Europian me aderimin e vendeve candidate nga Europa Lindore dhe Qendrore.

Ndryshimet më të mëdha që solli, kanë të bëjnë me kufizimin e madhësisë dhe përbërjes së Komisionit duke zgjeruar votimin me shumicë të cilësuar, një peshim

të ri të votave brenda Këshillit dhe duke bërë më fleksibël rregullat e përforcuara të bashkëpunimit. Përveç diskutimeve mbi këto katër çështje kyçe, u prekën gjithashtu edhe çështje të tjera institucionale, si: thjeshtimi i traktateve, përcaktimi i kompetencave, integrimi i Deklaratës së të Drejtave Themelore dhe roli i parlamenteve kombëtare. Deklarata mbi të Ardhmen e Bashkimit, e shtuar në Traktat, përcaktoi hapat e ardhshëm për të thelluar reformat institucionale dhe për të siguruar që Traktati i Nisës është vetëm njëra nga fazat në këtë proces.

Traktati i Nisës është ratifikuar nga të gjitha Shtetet Anëtare në përputhje me rregullat përkatëse kushtetuese, dhe hyri në fuqi më 1 shkurt 2003.

Transparenca (e drejta për përdorim të dokumentave). Termi “transparencë” përdoret shpesh në gjuhën e Komunitetit për të nënkuptuar që punimet e institucioneve të Komunitetit janë të hapura për publikun. Ky term është i lidhur me një varg kërkesash për përdorim publik më të gjerë të informacionit dhe dokumentave të Bashkimit Europian, për përfshirje më të gjerë në procesin e vendimmarrjes dhe tekste më të thjeshta për t’u lexuar (thjeshtimi i Traktateve, konsolidimi dhe hartimi më i mirë i legjislacionit).

Ankesa që kanë të bëjnë me mungesën e transparencës, reflektojnë një ndjenjë të përgjithshme që institucionet europiane janë të largëta dhe të fshehta dhe që procedurat e vendimmarrjes janë të vështira për t’u kuptuar nga qytetarët e thjeshtë europianë.

Duke ju referuar në mënyrë të veçantë përdorimit të dokumentave, Këshilli dhe Komisioni miratuan një kod etike, i cili cakton parime të përgjithshme për të dy institucionet, në vijim të vendimit të Këshillit më datë 20 dhjetor 1993. Në bazë të këtij kodi, të dy institucionet përfshijnë në rregullat e tyre të procedurave dispozita të veçanta mbi përdorimin e dokumenteve

Traktati i Amsterdimit ka përfshirë një nen të ri, nenin 255, mbi transparencën në Traktatin e Komunitetit Europian. Ky nen i jep të gjithë shtetasve të Bashkimit, si edhe të gjithë personave fizikë dhe juridikë me banim ose të regjistruar në zyrat e një Shteti Anëtar, të drejtën për përdorim të dokumentave të Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

Ky nen u vu në zbatim me Rregulloren e datës 30 maj 2001. Kjo rregullore e cila nuk është dhe aq e ndryshme nga tekstet e mëparshme, se parashikon përjashtime në dy raste: kur përdorimi nuk pranohet automatikisht (për arsye të sigurisë publike, mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare) dhe raste në të cilat përdorimi nuk lejohet me përjashtim të rasteve kur ka një interes publik të jashtëzakonshëm për të bërë publik informacionin (për shembull, mbrojtja e interesave tregtare të një personi fizik ose juridik).

Transparenca e seancave të Këshillit. Në debatin mbi transparencën e seancave të Këshillit, vëmendja përqendrohet në dy pika kryesore:

- Të drejtën e publikut për dëgjim të seancave të Këshillit;

- Të drejtën e publikut për përdorim të përmbledhjeve të takimeve të Këshillit dhe të deklaratave të bashkëngjitura me hollësi mbi votimin.

Me ndryshimin e Rregullave të Procedurës në dhjetor 1993, Këshilli ka ndjekur politikën e mëposhtme: si rregull i përgjithshëm, diskutimet më delikate mbahen të fshehta, por gjithashtu Këshilli zhvillon disa debate të hapura (p.sh. mbi programin gjashtëmuor të punës së Presidencës). Për sa i takon çështjes së të drejtës së publikut mbi hollësitë e votave të Shteteve Anëtare, Këshilli miratoi (në tetor 1995) një Kod Etike, sipas të cilit publiku ka të drejtë të ndjekë Këshillin në rolin e tij legjislativ. Rregullat praktike për një të drejtë të fillë u vendosën nga Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm më 8 Nëntor, në një raport mbi procedurën e brendshme.

Sipas Traktatit të Amsterdimit, u shtua një nen i ri në Traktatin e Komunitetit Europian (neni 255), i cili përcakton se çdo qytetar i Bashkimit Europian dhe çdo person fizik apo ligjor me banim apo i regjistruar në një zyrë të një Shteti Anëtar, ka të drejtën të njihet me dokumentat e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

Për rrjedhojë të nenit 255, i cili u vu në zbatim me Rregulloren e datës 30 maj 2001, Këshilli ndryshoi sërish Rregullat e Procedurës. Publiku mund të vëzhgojë rezultatet dhe shpjegimet e votave të Këshillit, si edhe të gjitha deklaratat e Këshillit për zbatimin apo interpretimin e legjislacionit në përgatitje.

Troika. “Troika” përbëhet nga Shteti Anëtar që mban aktualisht Presidencën e Këshillit, nga Shteti Anëtar i Presidencës gjashtëmuore paraardhëse dhe Shteti Anëtar që do ta mbajë Presidencën për gjashtë muajt e ardhshëm. Troika ndihmohet nga Komisioni dhe përfaqëson Bashkimin Europian në marrëdhëniet e jashtme të përcaktuara në politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë.

Troika në formën e saj të tanishme është ndryshuar nga Traktati i Amsterdimit dhe është zëvendësuar nga një sistem sipas të cilit Presidencia ndihmohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit në rolin e tij si Përfaqësues i Lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë dhe nga Komisioni.

Thellimi. Thellimi ka të bëjë me dinamikën e integritit që ka ekzistuar që në fillim të sipërmarrjes europiane. Komunitetet Europiane janë zhvilluar nga një bashkim doganor, treg i përbashkët dhe pastaj zonë e euros deri në një "bashkim gjithnjë e më të ngushtë" midis popujve të Europës (neni 1 i Traktatit të Bashkimit Europian). Thellimi është një proces që shkon dorë për dorë me zgjerimin dhe shpesh, shikohet si një hap i nevojshëm përpara zgjerimit.

Në këtë frymë është vendosur reforma për politikat kryesore të Komunitetit (PPB dhe Politika Strukturore) dhe për punën e institucioneve për të krijuar një kontekst të favorshëm që Shtetet e reja Anëtare të bashkohen me Bashkimin Europian.

Thjeshtimi i legjislacionit. Thjeshtim i legjislacionit do të thotë përjashtimi i materialit të tepërt duke provuar në mënyrë rigorozë në se është i nevojshëm dhe proporcional. Ky veprim përfshin kryesisht riformullimin dhe kodifikimin ose konsolidimin e legjislacionit.

Ky koncept mori një rëndësi më të madhe me Librin e Bardhë mbi Plotësimin e Tregut të Vetëm dhe u paraqit nga Këshilli Europian i Edinburgut në vitin 1992. Përgjatë dekadës së fundit është bërë një përpjekje e madhe për të krijuar një treg që garanton të katër liritë, por kjo ka çuar në pasurimin e legjislacionit Europian. Thjeshtimi i kësaj mase ligjore është kthyer tashmë në një përparësi, me qëllim që veprimi i Komunitetit të jetë transparent dhe i frytshëm. Në maj 1996 filloi një program pilot (Thjeshtimi i Legjislacionit për Tregun e Brendshëm) i cili mbulonte katër fusha të veçanta. Ky program do të zgjerohet edhe në fusha të tjera.

Aktit Final të Konferencës Ndërqeveritare (1997) iu bashkangjit një deklaratë mbi cilësinë e hartimit të legjislacionit komunitar. Deklarata rekomandon dhënien e udhëzimeve për përmirësimin e formës së legjislacionit nga ana e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit.

Në 5 qershor 2002, Komisioni publikoi planin e veprimit "Ligje më të mira" dhe mori përsipër "më pak ligje dhe më shumë cilësi". Këshilli i Ministrave është duke ngritur një grup të ri pune për zbatimin e këtij plani. Paralelisht me këtë, Konventa Europiane mbi reformat institucionale, e krijuar pas Deklaratës së Laekenit, përbëhet nga një grup pune mbi thjeshtimin e instrumentave dhe procedurave. Anëtarë të këtij grupi e kanë vënë në dijeni Konventën për nevojën për të dyfishuar përpjekjet për riformullimin dhe kodifikimin zyrtar të legjislacionit komunitar dhe për përmirësimin e hartimit ligjor, me qëllim që tekstet të jenë të qarta dhe në vijueshmëri me legjislacionin ekzistues.

Unanimiteti. Termi "unanimitet" i referohet kërkesës që të gjitha Shtetet Anëtare që mblihdhen në Këshill, të bien dakort përpara se një propozim të miratohet. Me Aktin Unik European kërkesa për unanimitet është zbatuar në një fushë shumë më të kufizuar se më parë. Në kontekstin e shtyllës së parë, votimi me shumicë të cilësuar tashmë është bërë rregull. Megjithatë, shtylla e dytë dhe e tretë, vendosin ende me metodën ndërqeveritare dhe me unanimitet.

Meqë shumë vendime merren me unanimitet dhe meqë kjo praktikë do të jetë më e vështirë në një Europë të zgjeruar, Traktati i Nisës e ka zgjeruar fushën e votimit me shumicë të cilësuar edhe për fusha e dispozita të tjera të politikave të Komunitetit, si edhe për një numër politikash të përfshira në shtyllën e dytë dhe të tretë.

"Ura" komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian). Traktati i Mastroihtit prezantoi mundësinë që disa fusha të mbulohen, sipas Titullit VI të Traktatit të Bashkimit Europian, nga kuadri komunitar (votim me shumicë të cilësuar, ashtu siç parashikohet në ish nenin 100c). Kjo procedurë e njohur si "ura" kërkon unanimitet në Këshill dhe ratifikim nga çdo Shtet Anëtar në përputhje me kërkesat e veta kushtetuese kombëtare.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdami, fushat që mbulohen nga neni i ri 29 i Titullit VI mund të kalojnë në Titullin e ri IV të Traktatit të Komunitetit Europian. Ashtu si në të kaluarën, çdo vendim për kalimin e çështjeve të tilla brenda kuadrit komunitar duhet të merret me unanimitet nga Këshilli dhe të ratifikohet nga çdo Shtet Anëtar.

Urdhër arresti europian. Urdhër arresti europian është një vendim gjyqësor i Shteteve Anëtare për arrestimin dhe dorëzimin e një personi të kërkuar për ndjekje penale ose për dënim me burg nga një Shtet tjetër Anëtar.

Urdhër arresti europian shërben për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve gjyqësore të Shteteve Anëtare duke eliminuar ekstradimin. Ky urdhër bazohet në parimin e njohjes reciproke të vendimeve në lidhje me çështjet penale.

Urdhër arresti europian bazohet në një Vendim Kuadër të miratuar në 13 qershor nga Këshilli. Ky vendim duhet të zbatohet nga 1 janari 2004, por disa Shtete kanë vendosur ta afrojnë datën e hyrjes në fuqi në 2003.

Vendet aplikante. Stabiliteti ekonomik dhe politik i Europës është magnet për shumë vende europiane, të cilat kanë të drejtën të aplikojnë për anëtarësi në Bashkimin Europian (neni 49).

Vendet që kanë aplikuar janë:

- Turqia: aplikimi u pranua në 14 prill 1987
- Qipro: 3 korrik 1990
- Malta: 16 korrik 1990
- Hungaria: 31 mars 1994
- Polonia: 5 prill 1994
- Rumania: 22 qershor 1995
- Sllovakia: 27 qershor 1995
- Letonia: 13 tetor 1995
- Estonia: 24 nëntor 1995
- Lituania: 8 dhjetor 1995
- Bullgaria: 14 dhjetor 1995
- Republika Çeke: 17 janar 1996
- Sllovenia: 10 qershor 1996

Në Këshillin Europian të Kopenhagenit (12 dhe 13 dhjetor 2002), Komisioni mbylli negociatat me 10 vendet aplikante: Republikë Çeke, Qipron, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Maltën, Poloninë, Sllovakinë dhe Slloveninë duke mundësuar kështu më 1 maj 2004 anëtarësimin e tyre në Bashkimin Europian. Përsa i takon Bullgarisë dhe Rumanisë, synohet që negociatat të përfundojnë në kohë dhe këto vende të anëtarësohen në vitin 2007. Negociatat me Turqinë mund të hapen në dhjetor 2004, nëse Turqia i plotëson kriteret e Kopenhagenit.

Gjithashtu Zvicra, Lihtenshtein dhe Norvegjia kanë aplikuar disa herë për anëtarësi në Bashkimin Europian. Megjithatë, Norvegjia e refuzoi aderimin dy herë pas një referendumi në vitin 1972 dhe një tjetri në vitin 1994, ndërsa aplikimet e Zvicrës dhe Lihtenshteinit u shtynë pasi në vitin 1992 Zvicra vendosi me referendum të mos bashkohet me Zonën Ekonomike Europiane.

Vendimi dhe vendimi kuadër (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian). Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, këto instrumenta të reja sipas Titullit VI të Traktatit të Bashkimit Europian (Bashkëpunimi gjyqësor dhe policor në çështje penale) kanë zëvendësuar veprime të përbashkëta. Duke qenë më të detyrueshme dhe autoritare, ato duhet të bëjnë më të efektshëm veprimin nën shtyllën e tretë të riorganizuar.

Vendimet kuadër përdoren për të përafuar ligjet dhe rregulloret e Shteteve Anëtare. Propozimet bëhen me iniciativën e Komisionit ose të një Shteti Anëtar dhe duhet të miratohen me unanimitet. Këto vendime janë të detyrueshme për rezultatin që duhet arritur nga Shtetet Anëtare, por zgjedhja e formës dhe mjeteve u lihet në dorë autoriteteve kombëtare.

Vendimet përdoren për çdo qëllim, përveç përafimit të ligjeve dhe rregulloreve të Shteteve Anëtare. Ato janë të detyrueshme dhe masat për zbatimin e tyre në nivel të Bashkimit European miratohen nga Këshilli me shumicë të cilësuar.

Veprim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe Sigurisë). Ky term, i cili ka të bëjë me një instrument ligjor në Titullin V të Traktatit të Bashkimit European, do të thotë veprim i bashkërenduar nga Shtetet Anëtare me anë të të cilit mobilizohen të gjitha burimet, (njerëzore, financiare, pajisjet etj) për të arritur objektiva specifike të përcaktuara nga Këshilli në bazë të udhëzimeve të përgjithshme të Këshillit European.

Veprim i përbashkët (drejtësia dhe punët e brendshme). Veprim i përbashkët, një instrument ligjor në ish Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European që u përdor në 1993-1999, do të thotë veprim i bashkërenduar nga Shtetet Anëtare në emër të Bashkimit European ose brenda kuadrit të Bashkimit European në ato raste ku për hir të shkallës ose efekteve të veprimit të parashikuar, objektivat e Bashkimit European mund të arrihen më me rezultat nëpërmjet veprimit të përbashkët, sesa nga Shtetet Anëtare në mënyrë individuale. Traktati i Amsterdimit është shfuqizuar dhe është zëvendësuar nga "vendime" dhe "vendime kuadër".

Zgjerimi. Fjala “zgjerim” u përdor në fillim për katër valët e para të njëpasnjëshme të anëtarëve të rinj që u bashkuan me Komunitetin Europian. 9 vende të tjera u bashkuan me 6 vendet themeluese: Belgjika, Franca, Gjermania, Italia, Luksemburgu dhe Holanda, sipas këtyre viteve:

- 1973: Danimarka, Irlanda dhe Britani e Madhe
- 1981: Greqia
- 1986: Portugalia dhe Spanja
- 1995: Austria, Finlanda dhe Suedia

Vala aktuale e aderimeve e ka kthyer zgjerimin në një mundësi të vetme për të sjellë paqe, stabilitet dhe begati në të gjithë kontinentin Europian. Një zgjerim i paparë, përsa i përket dimensionit dhe larmisë, përfshiu 10 vendet aplikante nga Europa Qendrore dhe Lindore (Bullgari, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Poloni, Rumani, Sllovakia dhe Slloveni), si edhe dy vende mesdhetare (Malta dhe Qipro).

Në Këshillin Europian të Kopenhagenit, Komisioni përfundoi negociatat me këto 10 vende. përkatësisht Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Slloveni dhe Sllovakia, duke bërë kështu të mundur më 1 maj 2004 bashkimin e tyre me Bashkimin Europian. Për sa i përket Bullgarisë dhe Rumanisë, synohet që negociatat të përfundojnë në kohë për t’u bashkuar në 2007. Mundësia për të hapur negociatat me Turqinë do të shqyrtohet në dhjetor 2004.

Zona Europiane e Kërkimeve. Zona Europiane e Kërkimeve bashkon të gjitha burimet e Komunitetit për të bashkërenduar më mirë kërkimet dhe veprimtaritë e reja në nivel të Shteteve Anëtare dhe Bashkimit Europian. Ky koncept filloi nga Komisioni në vitin 2000 për të tërhequr kërkuesit.

Më përpara, kërkimi në nivel europian kishte mangësi të tilla, si: fragmentarizmi i veprimtarive, izolimi i sistemeve kombëtare të kërkimit, mospërputhje të kuadrove administrative, si dhe rregullatore dhe nivele të ulta të investimit në njohuri.

Me anë të burimeve të disponueshme, Zona Europiane e Kërkimeve duhet të mundësojë ndarjen e të dhënave, krahasimin e rezultateve, kryerjen e studimeve shumë disiplinore, transferimin dhe mbrojtjen e njohurive të reja shkencore dhe të drejtën për pajisje të përsosura dhe teknologjisë së lartë.

Zona Europiane e Kërkimeve duhet të përmbushë një ambicje të rëndësishë së veçantë për Bashkimin Europian, kryesisht për të zhvilluar një politikë të përbashkët për kërkimin.

Zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë. Progresi i arritur që në vitin 1993 si rezultat i bashkëpunimit në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme çoi në qëllime më ambicioze të pasqyruara në Traktatin e Amsterdimit. U vendos krijimi i një zone lirie, sigurie dhe drejtësie për të siguruar lirinë e lëvizjes së personave në territorin e Bashkimit European dhe masa më efektive kundër krimit të organizuar dhe mashtrimit.

Çështjet e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme trajtoheshin vetëm sipas rregullave ndërqeveritare të përcaktuara në Titullin VI të Traktatit të Bashkimit European ("shtylla e tretë"). Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit, këto fusha janë ndarë ndërmjet shtyllës së parë dhe të tretë.

Nën shtyllën e parë është shtuar Titulli i ri IV në Traktatin e Komunitetit European ("Vizat, azili, emigracioni dhe politika të tjera që lidhen me lëvizjen e lirë të personave"). Ndërsa Titulli IV i Traktatit të Bashkimit European tani mbulon më pak fusha, por objektivat e tij janë përcaktuar më qartë, kryesisht për të forcuar bashkëpunimin e ngushtë ndërmjet shërbimeve policore, doganave dhe autoriteteve ligjore.

Dispozitat e shtyllës së tretë përfshijnë një "urë" që i lejon Shtetet Anëtare të transferojnë fushat e kompetencës nga Titulli VI në Titullin IV. Procedura e transferimit është shumë komplekse dhe nuk është zbatuar kurrë, por ekzistenca e saj sugjeron që me kalimin e kohës të gjitha fushat në lidhje me drejtësinë dhe punët e brendshme të kalojnë brenda kuadrit të Komunitetit.

Nëse disa Shtete Anëtare dëshirojnë të bëjnë progres më të madh dhe të forcojnë bashkëpunimin në disa fusha mund të veprojnë kështu brenda Bashkimit European, ashtu siç parashikohet në nenin e ri 40-të të Titullit VI, pa krijuar një sistem ligjor të ndarë ashtu si ndodhi me Shengenin.

Zyra Europiane Kundër Mashtrimit (OLAF). Që nga data 1 qershor 1999, Zyra Europiane Kundër Mashtrimit ka qënë përgjegjëse për luftën kundër mashtrimit në buxhetin e Bashkimit European.

Zyra, e cila u ngrit me vendim të Komisionit European të datës 28 prill 1999, zëvendëson Njësinë e Bashkërendimit të Parandalimit të Mashtrimit në Komision, e krijuar në vitin 1998 dhe e kufizuar vetëm në këtë institucion. Më datë 6 tetor 1998, Zhak Santer, duke ju drejtuar Parlamentit European, propozoi që ky departament të bëhej një organ i pavarur me kompetenca të zgjeruara.

Zyra e re mbikqyr menaxhimin dhe financimin e të gjitha institucioneve të Bashkimit me një pavarësi të plotë vepruese të garantuara nga:

- Drejtori i OLAF-it - i emëruar me marrëveshje ndërmjet Parlamentit, Komisionit dhe Këshillit. Ai ka të drejtë të çojë çështje në Gjykatë me qëllim mbrojtjen e pavarësisë së tij. Gjithashtu, ai mund të nisë një hetim jo vetëm me kërkesë të institucionit, të organit apo Shtetit Anëtar në fjalë, por edhe me iniciativën e tij.
- Këshilli Mbikëqyrës i OLAF-it - është përgjegjës për monitorimin e hetimeve dhe përbëhet nga pesë figura të jashtme të mirënjohura dhe të pavarura, të emëruara bashkarisht nga Parlamenti, Komisioni dhe Këshilli.

Rregullat që drejtojnë kërkime të brendshme të kryera nga OLAF me qëllim luftimin e mashtrimit, korrupsionit dhe veprimtarive të tjera të paligjshme të zhvilluara në dëm të interesave financiare të Komuniteteve Europiane, janë paraqitur në Marrëveshjen Ndërinstitucionale të datës 25 maj 1999 ndërmjet Parlamentit, Komisionit dhe Këshillit. Kjo marrëveshje shtrin kompetencat e Zyrës në veprime serioze që mund të çonin në sjellje joprofesionale të zyrtarëve dhe anëtarëve të tjerë të stafit. Për rrjedhojë ajo mund të çojë në masa disiplinore apo persekutime kriminale.

Zyra e Shkëmbimit të Informacionit për Ndhmën Teknike (TAIEX). TAIEX u krijua në përgjigje të një propozimi në Librin e Bardhë mbi përgatitjen e vendeve të asociuara të Europës Qendrore dhe Lindore për integrimin në tregun e brendshëm të Bashkimit Europian (maj 1995). Ky shërbim, i menaxhuar nga Komisioni Europian, ishte menduar fillimisht për të ndihmuar dhe informuar vendet e Europës Qendrore dhe Lindore mbi legjislacionin e tregut të vetëm, duke lehtësuar kështu zbatimin e tij. Që nga viti 1997 kjo zyrë ka mbuluar të gjitha vendet aplikante si dhe *acquis communautaire*.

TAIEX merret me administrimin publik në vendet aplikante dhe në Shtetet Anëtare dhe me shoqëritë e sektorit privat. Kjo zyrë siguron tekstet ligjore të *acquis communautaire* dhe organizon seminare trajnimi dhe vizita nga ekspertë në vendet e interesuara. TAIEX luan një rol kyç në procesin e vlerësimit të faktit nëse legjislacioni i vendeve aplikante përputhet me legjislacionin e Komunitetit (kontrolli paraprak). Gjithashtu, zyra ndihmon në transpozimin dhe zbatimin e *acquis* në vendet aplikante.

TAIEX shërben si shtesë e programeve Phare dhe programeve të tjera të ndihmës, duke qenë se i përgjigjet kërkesave individuale në fushat e *acquis*, që nuk mbulohen nga ato programe.

Zhvillim i qëndrueshëm. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm i referohet një forme të rritjes ekonomike që përmbush nevojat e shoqërisë për sa i takon mirëqenies në periudha afatshkurtra, afatmesme dhe mbi të gjitha afatgjata. Ky zhvillim duhet të plotësojë nevojat e së tashmes, pa vënë në rrezik mundësitë e zhvillimit ekonomik për brezat e së ardhmes.

Parimi i integritimit të problemeve të mjedisit në formulimin dhe zbatimin e politikave të tjera, gjë që është thelbësore për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm, u konfirmua në Traktatin e Mاستrihtit.

Në vitin 1998, Samiti i Kardifit hodhi themelet për veprime të bashkërenduara në planin e Komunitetit për integrimin e këtyre problemeve mjedisore. Rrjedhimisht, Komisioni paraqiti disa komunikata për integrimin e mjedisit, ndër të tjera, në fushën e energjisë, transportit, bujqësisë, tregut të brendshëm, zhvillimit, industrisë, peshkimit dhe politikave ekonomike. Disa konfigurime të Këshillit paraqitën edhe strategji për integrimin e mjedisit në politikat e tyre.

Në maj të vitit 2001 u miratua një strategji e Bashkimit Europian për zhvillimin e qëndrueshëm. Gjithashtu, kësaj strategjie iu dha një dimension i jashtëm nga partneriteti global për një zhvillim të qëndrueshëm të miratuar nga Komisioni në vitin 2002.

Në Samitin Botëror mbi Zhvillimin e Qëndrueshëm të mbajtur në Johannesburg në gusht-shtator 2002, u miratuan objektiva të reja, programe pune dhe afate kohore në fushën e ujrave, burimeve të peshkimit, oqeaneve, kimikateve, larmisë biologjike, energjisë, prodhimit të qëndrueshëm dhe konsumit, si dhe strategjive të qëndrueshme të zhvillimit. Bashkimi Europian u angazhua në arritjen e objektivave që shkojnë përtej atyre të caktuara në Johannesburg nga pjesëmarrës të tjerë.

Zhvillim Rural. Zhvillimi rural është i lidhur ngushtë me Politikën e Përbashkët Bujqësore dhe me masat për mbështetjen e punësimit, por historikisht, në mënyrë jo të bashkërenduar, masat e zhvillimit rural dhe aktet ligjore kanë vuajtur nga mungesa e ndërlihdjes midis tyre.

Në mënyrë që të jetë plotësisht në të njëjtën linjë logjike, Axhenda 2000 vuri në lëvizje reformën e Politikës së Përbashkët Bujqësore. Duke nxjerrë jashtë loje qëllimin e produktivitetit për t'u përqendruar tërësisht mbi cilësinë dhe sigurinë, reforma ka mundësuar përmirësimin e masave të zhvillimit rural, duke i bashkuar në një kuadër të vetëm rregullator. Rrjedhimisht, zhvillimi rural është tashmë shtylla e dytë e Politikës së Përbashkët Bujqësore.

Kuadri financiar për Axhendën 2000, i përcaktuar në Berlin në vitin 1999, i caktoi kësaj shtylle një shumë prej 45 miliard euro-sh në vit për masat e zhvillimit rural për periudhën 2000-2006, të cilat duheshin plotësuar nga Fondi Europian i Udhëzimit dhe Garancisë Bujqësore, në varësi të kontekstit rajonal.

Një parashikim i tillë i jep jetë politikës së integruar të zhvillimit të qëndrueshëm rural, duke siguruar lidhje më të ngushta ndërmjet zhvillimit rural dhe çmimeve të politikës së përgjithshme të bujqësisë dhe politikës së tregjeve. Gjithashtu, mundësohet bashkimi i të interesuarve vendas të një zonë të caktuar rurale në një strategji të integruar dhe vendase zhvillimi.

Qëllimet që ndjek zhvillimi rural përfshijnë:

- Modernizimin e fermave
- Prodhimin e produkteve të sigurta dhe cilësore
- Sigurimin e të ardhurave të barabarta dhe të qëndrueshme për fermerët
- Arritjen e sfidave të mjedisit
- Mbrojtjen e veprimtarive shtesë ose atyre që mundësojnë hapjen e vendeve të reja të punës, në përpjekje për të ndaluar largimin nga zonat rurale dhe për të forcuar anën ekonomike dhe sociale në zonat rurale
- Përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të punës dhe mundësive të barabarta.

Masat e zhvillimit rural të hartuara për përmbushjen e këtyre qëllimeve ndahen në dy kategori:

- Masa anësore të reformës në Politikën e Përbashkët Bujqësore 1992: pensioni para kohe, masa agro-mjedisore, pyllëzimi dhe skema për zona më pak të favorshme
- Masa për modernizimin dhe diversifikimin e fermave: investime në ferma, skema për fermerët e rinj, trajnime, mbështetje për investime në përpunimin dhe tregtimin e të mbjellurave, ndihmë shtesë për pyjet, nxitja dhe ristrukturimi i bujqësisë.

SHTOJCË

TERMAT E GLOSARIT SIPAS RENDIT ALFABETIK NE ANGLISHT

Abstention, constructive (positive abstention)	Abstenim konstruktiv (abstenim pozitiv)
Accession criteria	Kriteret e pranimit
Accession negotiations	Negociatat për aderim
Accession of new Member States to the European Union	Aderimi i Shteteve të reja Anëtare në Bashkimin European
Accession partnership	Partneritet për aderim
Agenda 2000	Axhenda 2000
Animal welfare	Mirëqenia e kafshëve
Applicant countries	Vendet aplikante
Architecture of Europe	Arkitektura e Europës
Area of freedom, security and justice	Zona e lirisë, sigurisë dhe drejtësisë
Article 36 Committee of the EU Treaty	Neni 36 i Traktatit të Bashkimit European
Assent procedure	Procedura e pëlqimit
Audiovisual	Shërbimet audiovizive
Bilateral Intergovernmental Conference (EU-Applicant Countries)	Konferenca Ndërqeveritare dypalëshe (BE-Vendet Aplikante)
Budget	Buxheti
Charter of Fundamental Rights	Karta e të Drejtave Themelore
Citizenship of the Union	Qytetaria e Bashkimit
Clarity of the Treaties (simplification of the Treaties)	Qartësia e Traktateve (thjeshtimi i Traktateve)
Classification of expenditure	Klasifikim i shpenzimeve
Closer cooperation	Bashkëpunim më i ngushtë
Codecision procedure	Procedura e bashkëvendimmarrjes
Collective defence	Mbrojtja kolektive

Comitology	Komitologji
Committee of the Regions (CoR)	Komiteti i Rajoneve (KR)
Committees and working parties	Komitetet dhe grupet e punës
Common Agricultural Policy (CAP)	Politika e Përbashkët Bujqësore (PPB)
Common Commercial Policy	Politika e Përbashkët Tregtare
Common Foreign and Security Policy (CFSP)	Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë
Common organisations of the agricultural markets (COM)	Organizatat e përbashkëta të tregjeve bujqësore
Common position (CFSP)	Qëndrim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Common strategy (CFSP)	Strategji e përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Common transport policy	Politika e Përbashkët e Transportit
Communitisation	Komunitarizëm
Community acquis	Acquis communautaire
Community and intergovernmental methods	Metoda komunitare dhe ndërqeveritare
Community 'bridge' (Title VI of the EU Treaty)	'Ura' komunitare (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)
Community law	E drejta komunitare
Community legal instruments	Instrumentet ligjore komunitare
Community powers	Kompetencat e Komunitetit
Competition	Konkurrenca
Competitiveness	Konkurrueshmëria
Composition of the European Commission	Përbërja e Komisionit Europian
Concentration	Përqendrim
Concentric circles	Rathë bashkëqendrorë
Conciliation Committee	Komiteti i Pajtimit

Confirmation of the European Commission	Konfirmimi i Komisionit Europian
Consolidation of legislation (informal)	Konsolidim i legjislacionit (jozyrtar)
Consolidation of legislation (formal)	Kodifikim i legjislacionit (zyrtar)
Consultation procedure	Procedura e këshillimit
Consumer protection	Mbrojtja e konsumatorit
Convention (Title VI of the EU Treaty)	Konventa (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)
Convergence criteria	Kriteret e konvergjencës
Cooperation procedure	Procedura e bashkëpunimit
Coreper	Coreper (Komiteti i Përfaqësuesve të Përhershëm)
COREU (CORespondance Europeenne)	COREU (Korrespondenca Europiane)
Council of the European Union	Këshilli i Bashkimit Europian
Court of First Instance of the European Communities (CFI)	Gjykata e Shkallës së Parë e Komuniteteve Europiane
Court of Justice of the European Union	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Europian
Culture	Kultura
Customs Union	Bashkimi Doganor
Debate on the future of the European Union	Debat mbi të ardhmen e Bashkimit Europian
Decision and framework decision (Title VI of the EU Treaty)	Vendimi dhe vendimi kuadër (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)
Declaration (CFSP)	Deklarata (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Deepening	Thellimi
Delimitation of competences	Kufizim i kompetencave
Democratic deficit	Deficit demokratik
Development aid	Ndihmë për zhvillim
Double majority	Shumicë e dyfishtë

Economic and Monetary Union	Bashkimi Ekonomik dhe Monetar
Economic and social cohesion	Kohezioni ekonomik dhe social
Economic policy	Politika ekonomike
Education, vocational training and youth	Arsimi, formimi profesional dhe rinia
eEurope	eEurope
Employment	Punësimi
Employment Committee	Komiteti i Punësimit
Energy	Energjia
Enlargement	Zgjerimi
Enterprise policy	Politika për ndërmarrjet
Environment	Mjedisi
Equal opportunities	Mundësi të barabarta
Equal treatment for men and women	Trajtim i barabartë i burrave dhe grave
Eurocorps	Eurocorps (Grupat europiane)
EUROFOR/EUOMARFOR	EUROFOR/EUOMARFOR
Europe 'a la carte'	Europa 'a la carte'
Europe agreement	Marrëveshja e Europës
European arrest warrant	Urdhër arresti europian
European Central Bank	Banka Qendrore Europiane
European Commission	Komisioni Europian
European Conference	Konferenca Europiane
European Convention	Konventa Europiane
European Convention on Human Rights	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
European Council	Këshilli Europian
European Court of Auditors	Gjykata Europiane e Llogarive

European Economic and Social Committee (EESC)	Komiteti European Ekonomik dhe Social
European Employment Strategy (EES)	Strategjia Europiane për Punësimin
European Investment Bank (EIB)	Banka Europiane e Investimeve
European Judicial Network in criminal matters (EJN)	Rrjeti Gjyqësor European për çështjet penale
European Parliament	Parlamenti European
European political cooperation (EPC)	Bashkëpunim politik europian
European Research Area (ERA)	Zona Europiane e Kërkimeve
European security and defence identity	Identiteti europian i mbrojtjes dhe sigurisë
European security and defence policy (ESDP)	Politika europiane e mbrojtjes dhe sigurisë
European Union agencies	Agjencitë e Bashkimit European
Europol (European Police Office)	Europol (Zyra Europiane e Policisë)
External responsibilities of the European Community	Përgjegjësitë e jashtme të Komunitetit European
Fight against drugs	Lufta kundër drogave
Fight against fraud	Lufta kundër mashtrimit
Fight against international organised crime	Lufta kundër krimit ndërkombëtar të organizuar
Fight against racism and xenophobia	Lufta kundër racizmit dhe ksenofobisë
Fight against terrorism	Lufta kundër terrorizmit
Financial perspective 2000-2006	Perspektiva financiare 2000-2006
Food safety	Siguria ushqimore
Free movement of persons (visas, asylum, immigration and other policies)	Lëvizja e lirë e personave (politika e vizave, azilit, emigracionit dhe politika të tjera)
General interest services	Shërbime me interes të përgjithshëm
Genetically modified organisms (GMOs)	Organizma gjenetikisht të modifikuara (OMGJ)

Globalisation of the economy	Globalizim i ekonomisë
Governance	Qeverisje
Green Paper	Libri i Gjellbër
Hard core	Bërthama (Kocka e fortë)
Hierarchy of Community acts (hierarchy of norms)	Hierarkia e akteve komunitare (hierarkia e normave)
High Representative for the CFSP (Mr/MS CFSP)	Përfaqësues i lartë i Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë
Human rights	Të drejtat e njeriut
Humanitarian aid	Ndihma humanitare
Incorporation of the community acquis	Adoptimi i acquis communautaire
Information society	Shoqëri informacioni
Institutional balance	Ekulibër institucional
Intellectual property	Pronësi intelektuale
Intergovernmental Conference (IGC)	Konferencë Ndërqeveritare (KNQ)
Ioannina compromise	Kompromisi i Janinës
Joint action (CFSP)	Veprim i përbashkët (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Joint action (Justice and home affairs)	Veprim i përbashkët (Drejhtësia dhe punët e jashtme)
Joint position (Title VI of the EU Treaty)	Qëndrim i përbashkët (Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian)
Justice and home affairs	Drejhtësia dhe punët e brendshme
Kyoto Protocol	Protokolli i Kiotos
Laeken Declaration	Deklarata e Laeken-it
Legal personality of the Union	Personaliteti juridik i Bashkimit
Luxembourg compromise	Kompromisi i Luksemburgut
Measures to combat money laundering	Masa për të luftuar pastrimin e parave
Monetary policy	Politika monetare

Monitoring the application of Community law	Moniforimi i zbatimit të së drejtës komunitare
'Multi speed' Europe	Europa 'me ritëm të shpejtë'
National parliaments	Parlamente kombëtare
NATO (North Atlantic Treaty Organisation)	NATO (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)
'New-look" NATO	NATO 'e rinovuar'
Non-discrimination principle	Parimi i mosdiskriminimit
Objectives 1, 2 and 3	Objektivat 1, 2 dhe 3
OLAF (European anti-fraud office)	(Zyra europiane kundër mashtrimit) OLAF
Ombudsman	Avokati i Popullit
Opting out	Klauzola e mospjesëmarrjes
Outermost regions	Rajonet më të largëta
Own resources	Burime vetjake
Parliamentary committees	Komisione parlamentare
Petersberg tasks	Detyrat e Petersbergut
Petitions	Peticione
Pillars of the European Union	Shtyllat e Bashkimit European
Planning and Early Warning Unit	Njësia e Planifikimit dhe Paralajmërimit
Police and judicial cooperation in criminal matters	Bashkëpunimi policor dhe gjyqësor në çështjet penale
Political agenda of the European Union	Axhenda politike e Bashkimit European
Political and Security Committee (PSC)	Komiteti Politik dhe i Sigurisë
Pre-accession aid	Ndihma para-aderimi
Pre-accession pact on organised crime	Pakt para-aderimi mbi krimin e organizuar
Pre-accession strategy	Strategji para-aderimi
Precautionary principle	Parimi parandalues
Presidency of the Union (rotation of the Presidency)	Presidenca e Bashkimit (rotacioni i Presidencës)

President of the European Commission	President i Komisionit Europian
Programme of Community aid to the countries of Central and Eastern Europe (Phare)	Program i ndihmës komunitare për vendet e Europës Qendrore dhe Lindore
Public health	Shëndeti publik
Public service	Shërbimi publik
Public service charter	Statuti i shërbimit publik
Qualified majority	Shumica e cilësuar
Recasting of legislation	Riformulim i legjislacionit
Reinforced qualified majority	Shumica e cilësuar e përforcuar
Research and development	Kërkim dhe zhvillim
Revision of the Treaties	Rishikim i Traktateve
Right of initiative	E drejta e iniciativës
Rural development	Zhvillimi rural
Schengen (Agreement and Convention)	Shengen (Marrëveshje dhe Konventë)
Screening	Kontroll paraprak
Services of general economic interest	Shërbime me interes ekonomik të përgjithshëm
Simplification of legislation	Thjeshtim i legjislacionit
Single institutional framework	Kuadër i vetëm institucional
Social Charter	Karta sociale
Social dialogue	Dialogu social
Social partners	Partnerë socialë
Social policy	Politikë sociale
Social Policy Agreement	Marrëveshja e Politikës Sociale
Stability and Growth Pact	Pakti i Stabilitetit dhe i Rritjes
State aid	Ndihma shtetërore
Structural Funds and Cohesion Fund	Fonde strukturore dhe Fondi i Kohezionit

Subsidiarity	Subsidiaritet
Subsidiary powers	Kompetenca dytësore
Suspension clause	Klauzola e pezullimit
Sustainable development	Zhvillimi i qendrueshëm
TAIEX (Technical Assistance Information Exchange Office)	(Zyra e Shkëmbimit të Informacionit për Ndihmën Teknike (TAIEX)
Taxation	Dispozita fiskale
Telecommunications	Telekomunikacioni
Television without frontiers	Televizioni pa kufij
Title V of the EU Treaty (CFSP)	Titulli V i Traktatit të Bashkimit Europian (Politika e Përbashkët e Jashtme dhe e Sigurisë)
Title VI of the EU Treaty	Titulli VI i Traktatit të Bashkimit Europian
Trans-european networks (TEN)	Rrjetet trans-europiane
Transparency (access to documents)	Transparenca (e drejta e përdorimit të dokumentave)
Transparency of Council proceedings	Transparenca e seancave të Këshillit
Treaty of Amsterdam	Traktati i Amsterdimit
Treaty of Nice	Traktati i Nisës
Troika	Troika
Unanimity	Unanimitet
Uniform Electoral Procedure, Statute for Members of the European Parliament and for European Political parties	Procedura Standarde Zgjedhore, Statuti për deputetët e Parlamentit Europian dhe partitë politike europiane
Universal service	Shërbimi universal
'Variable-geometry' Europe	Europa me gjeometri të ndryshueshme
Weighting of votes in the Council	Peshimi i votave në Këshill
Western European Union (WEU)	Bashkimi Europian Perëndimor
White Paper	Libri i Bardhë